


Halim Hyseni



E VËRTETA
PËR HELMIMET

Halim Hyseni
E VËRTETA PËR HELMIMET

Botues

REDAKSIA E BOTIMEVE E PARTISË SHQIPTARE
DEMOKRISTIANE E KOSOVËS

Redaktor

FRROK KRISTAJ

Recensues

Prof.dr. SKËNDER SKËNDERAJ, toksikolog në Universitetin
e Tiranës, shef i Katedrës së Toksikologjisë dhe Mbrojtjes nga
Helmimet në punë
Dr. UKË BERISHA, mjek

Lektor

RIZA BICAJ

Korrektor

SABIT JAHA

Realizimi kompjuterik

ARDIANË R. MEHMETI

HALIM HYSENI

**E VËRTETA
PËR HELMIMET
NË KOSOVË
(1987 - 1990)**

Prishtinë
1996



Motra e nderit ndihmon të riun e helmuar

P È R K U S H T I M

Këtë libër ua kushtoj: *Liridonës, Ljamies, Kushtrimit, Artindes, Kreshnikut, Shqipes, Albanës, Dritonit, Bekimit, Shpresës, Valbonës, Igorit, Leonorës, Sulejmanit, Jasminës, Maries, Diles, Avniut, Luanit, Xhavitit, Dushanit, Blerimit, Ismetit, Sebahates, Mimosës, Artës, Njomzës, Arbenit, Marës, Bislimit, Ragipit, Enverit, Arbnorës, Artanit, Sadies, Jalldyzes, Ekremi, Astritit, Arietës, Vjollcës, Vildanes, Selvetes, Shahes, Samiut, Antigonës, Besës, Afërditës, Naimit, Vesnës, Arbenitës, Zyrafetës, Lumnies, Veselii, Fatmirit, Afrimit, Vehbiut, Mentorit, Miranit, Jusufit, Mirsimi, Xhabirit, Petritit, Bajramit, Lavdimi, Muhametit, Bakiut, Fadilit, Ukës, Arsimit, Elhamiut, Florës, Luljetës, Behares, Tahires, Bujarit, Mirëindës, Menduhes, Seharës, Ruzhdiut, Hamdies, Lavdies, Kimetes, Armenit, Agimit, Besartit, Teutës, Fazës, Alushit, Edmonit, Saliut, Zukës, Farukut, Filloretës, Sofijes, Dritës, Lyrës, Aidës, Liries, Jetës, Meritës, Aurorës dhe mbi 7.400 viktimave të tjera të cilat kaluan nëpër ferrin e vitit 1990, vit ky kur mbi ririnë kosovare u hodhën sasi të mëdha të helmeve nervore dhe ngulfatëse nga familja e helmeve kimike të luftës.*

Libri u kushtohet edhe *Afrim Prebrezës, Burimit, Jetmiri, Dini dhe Afrim Paçarizit, Nesim Danës, Afrim Bytyqit, Shukne Obërtincës, Ylfete Humollit, Ajrim Badallajt, Sami Ramës* e shumë e shumë fëmijëve të tjerë shqiptarë, viktimat e terrorit shtetëror serb.

Librin ua kushtoj edhe mijëra arsimtarëve shqiptarë, të cilët nuk kursyen asgjë për ta mbrojtur shkollën shqipe, prindërve shqiptarë që dhanë jetën për mbrojtjen e shkollës shqipe, Haki Pavatajt që vdiq në zyrën e policisë serbe për të mbrojtur pavarësinë e arsimit shqip në Kosovë, Xhemali Berishës misionarëve të Kishave Katolike në Ferizaj, në Binçë dhe në vende të tjera, të cilët nuk kursyen asgjë për t'ua lehtësuar dhembjet e padurueshme fëmijëve dhe të rinjve të helmuar në Kosovë, mijëra e mijëra mjekëve dhe motrave medicinale e posaçërisht motrave të nderit, të cilat po ashtu bënë çmos për t'ua shpëtuar jetën viktimave të helmimeve të viteve 1989 dhe 1990.

A u t o r i

PARATHËNIE

Studimi *E vërteta për helmimet në Kosovë*, është rezultat i një gjurmimi empirik, i një pune të mundimshme, i një hulumtimi pesëvjeçar. Gjurmimi është bërë në mbështetje të kritereve rigoroze shkencore dhe të një pune metodologjike, e cila ka synuar që më në fund, duke u nisur nga rezultatet relevante, nga mendimet dhe studimet e tjera të mjekëve shqiptarë, nga analizat laboratorike të bëra në laboratorët ndërkombëtarë, nga vlerësimet kompetente të mjekëve me famë ndërkombëtare dhe të toksikologëve e të ekspertëve të tjerë, anëtarë të ndryshëm të komisioneve shëndetësore të organizatave ndërkombëtare, nga raportet e gazetarëve, të cilët raportuan nga vendet e ngjarjeve ku ndodhën helmimet, nga intervistat dhe anketat e bëra me 300 individë, kryesisht: nxënës, arsimtarë dhe prindër, nga studimi i listës së viktimave të identifikuara të helmimeve (7421), nga studimi teorik i literaturës së botuar me këtë temë, nga opinioni shqiptar dhe ai ndërkombëtar në mënyrën complete, përmes një vepre sintetike do të prezentohet e vërteta për helmimin e fëmijëve, nxënësve, studentëve dhe të qytetarëve, kryesisht shqiptarë, në periudhën 1989-1990.

Qëllimi fundamental i këtij studimi është: të konstatohet e vërteta për këtë ngjarje tragjike, e cila ishte me të vërtetë e llahtarshme, por e papritur.

Detyrat e gjurmimit ishin:

1) të konstatohet numri i të helmuarve sipas komunave dhe institucioneve, të cilat ishin objekt i atakimeve të helmeve kimike të luftës (struktura e tyre për nga përkatësia kombëtare, sociale si dhe nga aspekti i moshës);

2. që me disa nga të helmuarit të bëhet anketimi dhe intervistimi, me qëllim që të merren të dhëna për simptomet, për gjendjen e tyre shëndetësore dhe psikike, gjatë dhe pas atakimeve me helmet;

3. që të studiohen mendimet e konsorciumit të mjekëve të formuar më datën 23 mars 1990, si dhe mendimet e ndryshme të mjekëve dhe të ekspertëve për këtë krim vërtet të rrallë dhe antinjerëzor;

4. që të studiohet në mënyrë të gjithanshme një pjesë e gjurmëve materiale të evidencuara në mjetet e informimit, në publikimet, në raportet e ndryshme, qofshin ato të organeve zyrtare apo të organizatave ndërkombëtare joqeveritare;

5. që duke e përcjellë dhe studiuar procesin e helmimit eventual të bëhet rikonstruimi i procesit dhe i gjendjes së këtij procesi, si dhe të analizohet, aq sa është e mundur, skenari hipotetik (plani apo elaborati), në mbështetje të të cilit është bërë ky veprim, që në esencë ishte në një shkallë shumë të lartë të organizimit (ky konstatim më mundësoi të konkludoj se procesin e përgatitjes, të zbatimit dhe të përcjelljes, jo vetëm që e kanë bërë ekspertë të profileve të ndryshme, të niveleve shumë të larta, por, sipas të gjitha gjasave, për realizimin e tij, janë aplikuar teknikat bashkëkohore të planifikimit - dinamik iterativ dhe të gjurmimeve operationale. Ky supozim është vërtetuar gjatë këtij gjurmimi);

6. që të konstatohet dhe studiohet dinamika e helmimit dhe nga rezultati i studimit të dinamikës së zbatimit të helmimit të nxirren përfundime relevante dhe objektive;

7. që të prezentohen dëshmitë dhe rrëfimet, përjetimet e viktimeve të helmeve, të prindërve dhe të arsimtarëve, me qëllim që të shihet shkalla e koherencës, jo vetëm mes deklarimeve të tyre, por edhe mes simptomeve të manifestuara;

8. që të krahasohen simptomet e manifestuara dhe të regjistruara nga mjekët shqiptarë, por edhe të komisionit ndërkombëtar, i cili ishte në Kosovë gjatë muajit gusht 1990 dhe

9. që në gjurmime të hulumtohen dhe zbulohen të dhëna të reja dhe të panjohura, të cilat do të qitnin më tepër dritë në këtë krim "misterioz" dhe "enigmatik", veçmas në vitet 1990 dhe 1991.

Në gjurmim janë aplikuar metodat shkencore siç janë: metoda historike, metoda kauzale, metoda e gjurmimeve operationale (metoda e planifikimit rrjetor).

Pos metodave të përmendura gjatë këtij gjurmimi janë aplikuar këto teknika: teknika e studimit dhe e analizës së dokumentacionit dhe e literaturës, teknika e vrojtimit protokollet e ndryshme të incizimit - listat evidencuese, gjirimet TV, incizimet e ndryshme, studimi i fotografive etj.), teknika e anketimit dhe e intervistimit.

Për gjurmim jemi mbështetur në hipotezën zero, të cilën e kemi definuar: "Në Kosovë ndërmjet viteve 1989-1990 nuk ka pasur helmim të fëmijëve, të nxënësve, të studentëve dhe të qytetarëve, kryesisht shqiptarë".

Jemi mbështetur në këtë hipotezë, për këto qëllime:

1. Përmes kësaj hipoteze të definuar kështu kam dëshiruar dhe synuar që plotësisht të eliminoj në gjurmim subjektivizmin dhe notën subjektive, meqë në kohën kur ka ngjarë helmimi, jo vetëm që kam qenë prezent në Kosovë, jo vetëm që i kam parë të helmuarit, por vetë kam qenë shumë i trazuar, si duke i parë skenat llahtarë të viktimeve para spitalit, ku e kërkoja fëmijën tim, nxënës i shkollës së mesme ekonomike "Velko Vlahoviq" në Prishtinë, kur

me sytë e mi e kam parë dhe me veshë i kam dëgjuar klithmat e të helmuarve, shtrëngimet dhe shtangimet e tyre, por edhe sharjet e policëve serbë, të cilët i pengonin të helmuarit që të vendoseshin në spitale. Kjo, nga një anë, dhe, nga ana tjetër kam parë policin shqiptar në një gjendje të rëndë psikike, i cili me shpirt të lënduar u thoshte të rinjve që i bartnin të helmuarit "*Ikni, se do t'ju rrahin!*" Atë natë, më sillëshin në kokë skena, klithma e sharje policësh serbë, dhe fytyra e trishtuar e policit të mjerë shqiptar, i cili atë natë, sikur edhe unë, nuk do të ketë fjetur. Ky moment ishte vendimtar që unë të orientohem për këtë hipotezë.

2. E vërteta është më e lartë se çdo gjë tjetër. Kjo duhet të jetë synim i secilit njeri. Etika ime profesionale dhe kodeksi i intelektualit më bëri të orientohem dhe kështu ta definoj hipotezën gjenerale. Hipotezat e tjera, janë dhënë në formë të pyetjeve në kaptinën e ardhshme.

Me vërtetimin e kësaj hipoteze do të argumentoj se në Kosovë në periudhën 1989-90 nuk ka pasur helmim. Njëkohësisht do të vërtetoheshin edhe vlerësimet zyrtare të ish - qeverisë jugosllave; e cila në një përgjigje zyrtare, më 30 mars 1990 (*-vërejtja e H.H.*) drejtuar Zyres Rajonale të Organizatës Botërore Shëndetësore, dhe informatën për një hulumtim zyrtar, të kryer më 24 mars, gjatë të cilit u zbuluan 4009 persona të nacionalitetit shqiptar që kërkuan ndihmë në 8 qytete të Kosovës dhe se deri më 27 mars shumica prej tyre ishin lëshuar dhe në të cilën më pastaj konstatohet "*...se një numër i caktuar mostrash gjaku dhe të urinës ishin marrë në Prishtinë dhe se "analizat toksikologjike nuk tregojnë praninë e përbërjeve të grupeve të helmeve organofosforike, karbamateve dhe përbërjeve të tjera që ndikojnë në kolinesterazë në mostrat që i morëm"* (24:17).

Njëkohësisht, do të vërtetoheshin edhe vlerësimet e mjekëve dhe të gazetarëve serbë, që një pjesë e madhe e tyre pohonin se

fjala është për: "*aktrim kolektiv të shqiptarëve*" (33:71). Me vërtetimin e kësaj hipoteze nuk do të demantoheshin edhe mendimet e një pjese të gazetarëve dhe të mjekëve serbë dhe kroatë të cilat u pranuan edhe nga disa mjete dhe publicistë të huaj p.sh. Kristina fon Kol dhe Wolfgang Libal, shih: (6:122) të cilët flisnin dhe shkruanin për një "afërë", për "*një histeri masive konvulzive të shqiptarëve*" (37:4). Me vërtetimin e kësaj hipoteze nuk do të mund të demantoheshin edhe mendimet se fjala ishte për një afërë të përgatitur për qëllime të larta politike (6:122). Duke vërtetuar këtë hipotezë do të hidheshin poshtë si të pabaza vlerësimet e disa gazetarëve dhe të "shkencëtarëve" serbë, si p.sh. të dr. Gjorgje Lekiqit (29:46) dhe të gazetës serbe "*Jedinstvo*", të datës 7 gusht 1990. Dr. Gjorgje Lekiq thotë dhe pohon se në Kosovë pati helmim, por këtë e bënë shqiptarët për qëllime të larta politike (20:46), ndërsa gazeta "*Jedinstvo*" shkruan se në Kosovë kishte helmim, por për këtë kjo gazetë përpiqet t'i fajësojë kishën katolike dhe personelin e saj (33:90).

Për vërtetimin e kësaj hipoteze kemi gjurmuar listën e personave të atakuar me helme dhe kemi konstatuar se kemi të bëjmë me 7421 individë, të identifikuar, kryesisht shqiptarë (mirëpo në mesin e tyre kishte edhe të nacionaliteteve të tjera si serbë, malazez, turq, romë e myslimanë). Po ashtu, janë analizuar mendimet e mjekëve shqiptarë, serbë dhe të mjekëve ndërkombëtarë. Kemi analizuar qindra raporte të gazetarëve të "*Rilindjes*", të "*Botës së Re*", të "*Kosovares*", të "*Shkëndijes*", "*Zërit*" të Prishtinës, të "*Veçernji listit*" të Zagrebit, të "*Vjesnikut*" të Zagrebit, të "*Ninit*" të Beogradit, të "*Politikës*" së Beogradit etj.

Është analizuar dinamika dhe kalendari i ditëve në të cilat fëmijët, nxënësit, studentët dhe qytetarët, kryesisht shqiptarë, janë ankuar për simptomat të cilat sinjalizonin se kishin të bënin me

pasojat e kontaktet me helme toksike. Në gjurmim janë anketuar 300 persona, të cilët kanë deklaruar se kanë qenë të atakuar me helmim.

Gjatë studimit kemi lexuar dhe analizuar raportet e mjekëve shqiptarë, (raportin e konsorciumit të mjekëve të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë), raportin e Dr. Gravesit, raportin e Mayit dhe Foranit, etj.

Në studimin e strukturës së të helmuarve kemi konstatuar se me helmim janë atakuar të gjitha kategoritë e moshave prej fëmijëve deri te persona të vjetër. Në gjurmim kemi konstatuar se fëmija më i ri i atakuar me helmim ishte i riu *Igor Gashiqi*, trevjeçar nga Gjakova, dhe më i vjetri ishte *Alush Beqiri*, 66-vjeçar nga Mitrovica.

Në gjurmim, duke u nisur nga një qasje sistemore, i kemi identifikuar etapat nëpër të cilat ka kaluar procesi i helmimit. Me aplikimin e metodës së statistikës dhe të krahasimit të simptomeve të manifestuara të personave, të cilët janë ankuar apo kanë kërkuar ndihmë mjekësore, apo janë hospitalizuar, kemi konstatuar se ekziston një lidhje tepër e fortë korelative mes simptomeve të manifestuara të personave, që janë ankuar apo të hospitalizuar, të simptomeve të cilat i përmendin të anketuarit e helmuar, të simptomeve të konsorciumit të mjekëve të Fakultetit të Mjekësisë, të ekspertëve të mjekëve ndërkombëtarë dhe të ekspertëve toksikologë, të cilët, duke analizuar simptomatologjinë, unanimisht deklarojnë se kemi të bëjmë me helme organofosforike, andaj më së shpeshti përmendet helmi "*Sarin*".

Gjatë gjurmimit kemi konstatuar se tre persona kanë vdekur nga pasojat e kontaktit me helm.

Përmes intervistimit të nxënësve të helmuar, të prindërve dhe të arsimtarëve, si dhe deklaratave të incizuara në kaseta TV janë

nxjerr përfundime po ashtu relevante. Në mbështetje të të gjitha këtyre parametrave, fakteve dhe të dhënave është hedhur poshtë hipoteza e parashtruar si e pabazë dhe është vërtetuar se në Kosovë, në periudhën 1989-1990, është bërë helmimi masiv i fëmijëve, i nxënësve, i studentëve dhe i qytetarëve të tjerë kryesisht shqiptarë, me helme kimike të luftës. Rezultatet e këtij gjurmimi përpunohen plotësisht me konfirmimin e prof. A. Heyndrickxit, ekspert për shkencën mbi toksikologjinë e rrethit të njeriut dhe drejtor i IRUL-it (International Referenc University, Laboratories), i cili në Konferencën Ndërkombëtare në Paris, më 8 shkurt 1992, deklaroi mes të tjerave: *"Teza e shqiptarëve të Kosovës e dëshmuar me një mori dokumentesh dhe dëshmitarësh - e vërtetuar nga autoritetet e besueshme mjekësore, se në fund të marsit 1990 janë përdorur materie kimike kundër nxënësve, studentëve dhe punëtorëve kryesisht shqiptarë..."* - për ne është më e pranueshme se çfarëdo teze tjetër. Nuk ekziston asnjë argument i natyrës mjekësore, i cili vërteton se helmimi mund të ketë qenë aktrim apo diç e ngjashme (12:2). A. Heyndrickxi në intervistën dhënë "Zërit" deklaroi: *"...se në Kosovë ka pasur helmime dhe se për këtë e ka informuar OKB-në dhe Stejt Departmentin"* (23:14). Konkluzionet në raportin e dr. Gravesit (24:16-18), mendimet në intervistën e dr. Bernar Benedetit dhënë korrespondentit të Agjencisë bullgare BTA, të cilën e botoi "Duma" (2:22), deklarata e ish-kryetarit të Kryesisë së ish- Jugosllavisë, Stipe Mesiqit, (10:3), mendimet e ekspertëve shqiptarë: dr. Simë Dobrecit, Z.Hundozit, Luljeta Gashi-Luci, Kajmak Gazidedës, A. Zajmi, Isuf Dedushajt dhe I. Telakut (9:29-35), rezultatet laboratorike të Parisit si dhe të Zagrebit janë komplementare dhe të përpunshme me rezultatin e këtij gjurmimi, i cili mund të definohet kështu: Në periudhën prej 19 mars 1989 deri më 6 dhjetor 1990 në Kosovë u bë helmimi masiv

i fëmijëve, i nxënësve, i studentëve, i punëtorëve dhe i qytetarëve, kryesisht shqiptarë, me helme kimike të luftës. Ky përfundim do të dëshmohej me shumë të dhëna dhe fakte në këtë studim. Nga përfundimi i definuar kështu, i eksplikuar me të dhëna, analiza, krahasime, i përcjellë me pasqyra tabelare, me paraqitje grafike, me faksimile, me fotografi, me deklarata, në mënyrën komplekse, objektive e të qartë del e vërteta se helmimi është organizuar nga qarqet e pushtetit të ish-Jugosllavisë, ku rol dominant kishte ish-Armata Popullore e Jugosllavisë, e cila, siç do të konstatojë dhe zbulojë më vonë majori David Graig, në fabrikën ushtarake në Potoci afër Mostarit ka prodhuar dhe prodhon përbërjen *sarin* nga i cili prodhohet gasi nervor (10:3). Me këtë zbulim vërtetohet konstatimi i Stipe Mesiqit, "*...i cili në cilësinë e kryetarit të atëhershëm të ish-Jugosllavisë, kishte vizituar fshehurazi Uashingtonin dhe Pentagonin dhe ua kishte dhënë atyre dokumentacionin për arsenalin kimik jugosllav (10:3) se ndaj rinisë shqiptare u përdorën helmet kimike: Sarin, Tabun, Soman - helme nervore dhe difozgen e klorifozgen - helme ngulfatëse (15:8). Me këtë zbulim të majorit David Graig vërtetohet dhe konstatimi i dr. Bernar Benedetit, i cili deklaroi se "ky krim është bërë nga agjentë të Beogradit, me siguri agjentë ushtarakë" (2:22).*

Rezultatet e gjurmimit në këtë studim, po ashtu tregojnë se në helmimin e qytetarëve të Kosovës, pati gisht ish-Armata Popullore e Jugosllavisë. Kjo vërtetohet edhe me rastin e hedhjes së helmeve në shkollën fillore "25 Maji" në Ferizaj ku është parë "*një ushtar i paidentifikuar duke bërë veprime të dyshimta, që lidhen me çështjen e helmimit*" (33:74).

Ky studim assesi nuk ka mundur dhe nuk mund të jetë rezultat i punës dhe i angazhimit individual. Me formësimin e tij ndihmë të pakursyer më kanë dhënë shumë arsimtarë, drejtorë të shkollave

fillore dhe të mesme, kryetarë të nënkëshillave komunale për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut, pedagogu i gjimnazit "Muharrem Bekteshi" në Vushtrri, miq dhe dashamirë të shumtë të mi. Meritë të veçantë ka Partia Shqiptare Demokristiane dhe, veçmas, anëtari i saj Frrok Kristaj i cili asnjëherë "nuk më la të qetë", duke kërkuar nga unë që të përfundoj sa më parë këtë gjurmim. Është obligim i madh imi ndaj kësaj Partie, e cila u angazhua që me vërejtjet dhe sugjerimet kritike, ky studim të dalë me sa më pak gabime. Shfrytëzoj rastin t'i shpreh falënderim të sinqertë, për daljen në dritë të këtij studimi edhe komunës së Kamenicës, e cila participoi përmes disa përfaqësuesve të ndërmarrjeve private dhe të individëve për çka u angazhuan Kadri L. Qehaja dhe Shaban Berisha.

Më në fund duhet pranuar se përkundër angazhimit tim, ndihmës së madhe të miqve dhe të dashamirëve, ky studim assesi nuk i vë pikë dhe nuk pretendon të jetë përfundimtar lidhur me çështjen e helmimeve në Kosovë. Ka ende çka të thuhet. Çështja do të qartësohet plotësisht pas disa dekadave kur do të hapen arkivet sekrete ushtarake dhe shtetërore të ish-Jugosllavisë, atëherë kur do të dalë në dritë elaborati dhe projekti i helmimit. Deri atëherë, gjithnjë do të ketë nevojë që ky krim kundër njerëzimit të gjurmohet dhe të hulumtohet. Çdo gjë e re që të thuhet për këtë çështje vetëm se do të kompletojë dhe do ta begatojë këtë studim. Do t'u jem mirënjohës të gjithë atyre të cilët me vërejtjet e tyre kritike do të kontribuojnë për evitimin e të metave eventuale të cilat mund të jenë përvjedhur.

NË VEND TË HYRJES - SHUMË PYETJE PËR HELMIMIN

Helmimi i rinisë shkollore dhe i qytetarëve të tjerë të Kosovës (kryesisht shqiptarë) një kohë të gjatë ishte një enigmë, një fenomen misterioz, rreth të cilit dhe për të cilin u fol edhe u shkrua shumë, pati mendime, ndër më të ndryshmet, trauma dhe përjetime të rënda psikike, spekulime dhe dezinformata si në Kosovë, ashtu edhe jashtë saj - në Serbi, në ish - Jugosllavi dhe në botë.

Më 21 mars 1989, në formë testi eksperimental, u përdorën helmet në shkollën e mesme "*Luigj Gurakuqi*" në Klinë, pastaj edhe në Prizren më 6.12.1989. Edhe pse nga ajo kohë kaluan shumë vite, nuk po bie niveli i interesimit si ndër shqiptarë e serbë ashtu edhe ndër faktorë ndërkombëtarë për këtë fenomen të mbjellësve të vdekjes. Si në kohën kur ndodhi helmimi, ashtu edhe sot ende janë aktuale këto pyetje:

- Cila është e vërteta për helmimet?
- Si janë përdorur helmet, pse opinioni botëror nuk reagoi në mënyrën më të vendosur ndaj këtij krimi të gjenocidit dhe, pse nuk u ndërmorën masa ndaj aktorëve të kësaj vepre konform me nenin 3 të Konventës ndërkombëtare për pengimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit?
- Pse nuk u organizuan hetimet për zbulimin e aktorëve të helmimit?
- Pse konsorciumi mjekësor, të cilin më 22 mars 1990 e formoi dekani i Fakultetit të Mjekësisë, prof. dr. Alush Gashi, nuk dha as sot e kësaj dite, komunikatë zyrtare decidive për helmimet?

● A ishin me të vërtetë nxënësit serbomalazez të rrezikuar nga "nacionalistët dhe separatistët" shqiptarë, kur kërkuan që për ta, të organizohet mësimi në objekte, në kate dhe në ndërtesa të veçanta?

● Pse profesorët serbomalazez nënshkruanin peticione, në të cilat në mes të tjerash, kërkohej ndarja e nxënësve dhe e studentëve që shkolloheshin në gjuhën serbe nga ata në gjuhën shqipe?

● Pse dhe kur në arsimimin e Kosovës u aplikua APARTEIDI?

● Për çfarë qëllimesh bëheshin fotomontazhet, inskenimet dhe pse fabrikoheshin gënjeshtra serbe për Kosovën dhe shqiptarët?

● Pse helmimi i shkollarëve dhe i qytetarëve shqiptarë të Kosovës u vlerësua si "aktrim kolektiv" a "simulim masiv"?

● Pse "psikozat" merreshin si "shkas" i helmimeve?

● Pse mjetet e informimit në gjuhën serbe flitnin për helmime njënacionale, a ishte kjo e vërtetë?

● Pse në "shkencën" serbe bëhen përpjekje falsifikuese me pohime se "shqiptarët e helmuan rininë e vet"?

● Në çfarë raporti janë induksioni dhe helmimi?

● Sa veta u helmuan në Kosovë - dihet apo nuk dihet numri i saktë i tyre?

● Çfarë ishte struktura e viktimave të të helmuarve?

● A ekziston lidhja mes pastrimit etnik dhe helmimeve në Kosovë?

● Dihet apo nuk dihet kush i bëri helmimet?

● Dihet apo nuk dihet se me çfarë helmesh u bë helmimi?

● Cilat ishin simptomat e të helmuarve?

● Dihet apo nuk dihet si u hodhën helmet?

● Pse policia pengonte shërimin e viktimave të helmit në spitale dhe në ambulanca shëndetësore?

● Pse policia i merrte në pyetje njerëzit, të cilët u ofronin ndihmë të helmuarve?



Kujdes i mjekëve ndaj të helmuarit

- Pse u bastis Kisha Katolike në Ferizaj?
- Sa veta vdiqën nga helmimet?
- Cilat ishin motivet e helmimit të qytetarëve në Kosovë?
- Këto janë vetëm disa pyetje, të cilave do të bëjmë përpjekje t' u përgjigjemi objektivisht dhe me argumente, me qëllim që nga fenomeni i helmimit të hiqen mjegullira dhe paqartësi lidhur me këtë. Për shpjegime dhe përgjigje në këto pyetje do të mbështetemi në argumente dhe fakte relevante e të pamohueshme.

HELMIMI - AKT GJENOCIDI MBI POPULLIN SHQIPTAR

Helmimi i fëmijëve, i nxënësve, i studentëve dhe i qytetarëve të tjerë të Kosovës, i cili filloi më 21 mars 1989, në vitin kur filloi të rrënohet me dhunë dhe tërësisht autonomia e Kosovës, që përfundoi më 6 dhjetor 1990, në vitin kur rrënimi i arsimit shqiptar merr përmasa shqetësuese dhe dramatike, nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare sistemohet në aktet më barbare, më sadiste dhe më gjenocide që mund të kenë ndodhur në Evropën e civilizuar në pesë dekadat e fundit. Në historinë e njerëzimit, njihen fare pak raste, në të cilat u bë helmimi kaq i madh dhe kaq masiv, në një shtet dhe në një kohë kaq të gjatë. Ky helmim u bë në paqe, ndaj qytetarëve që me asgjë nuk provokuan nxitje lufte, e për këtë, askush nuk u mor në përgjegjësi, bile as nuk u organizua kurrfarë forme e hetimeve për zbulimin e aktorëve të krimit. Mosorganizimi i hetimeve për konstatimin e së vërtetës, objektivisht e shton dyshimin se këtë e ka bërë vetë shteti ish - jugosllav, se ky ka gisht në këtë krim. Dëshmitë dhe provat që pasojnë në këtë libër e vërtetojnë këtë dyshim. Andaj, obligimi që e vërteta për këtë vepër të dalë në shesh është një akt njerëzor dhe civilizimi. Në këtë mënyrë luftohet krimi i gjenocidit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë i jipet kontribut procesit të demokratizimit të jetës publike dhe të qytetërimit.

Helmimi i bërë la pasoja tepër të rënda te 7.421 të rinj kryesisht shqiptarë. Frustrimet, traumat dhe psikoza e krijuar u bartën në farefisën e familjeve, të viktimave të helmimit, e nga ato dhe

përmes tyre, në tërë popullatën shqiptare. Ishte ky një akt krimi, dhune dhe terrori shtetëror, ishte kjo një vepër gjenocide në mbi dy milionë banorë, sa atë kohë Kosova kishte qytetarë.

Akti i helmimit masiv të shqiptarët, përkundër karakterit të vet kriminel, brutalitetit dhe vrazhdësisë, nuk u dënua nga opinioni botëror.

Me helmimet që iu bënë qytetarëve të Kosovës iu shkaktuan plagë të rënda psikike dhe fizike 7.421 viktimave, sa dihet deri më tash, se kanë qenë të helmuara. Plagët e rënda psikike iu shkaktuan tërë popullatës shqiptare dhe një pjese të vogël të popullatës joshqiptare. Duke pasur parasysh këtë dhe duke u nisur nga neni 2 i Konventës ndërkombëtare për pengimin dhe dënimin e krimit, nënshkruese e së cilës ishte edhe ish-Jugosllavia (ku thuhet me gjenocid nënkuptohet edhe akti me të cilin dënohet krimi nëse: *"qëllimisht shkaktohen pasoja dhe plagë të rënda psikike dhe fizike të pjesëtarët e bashkësisë etnike"*). Atëherë pa kurrfarë dyshimi del se me këtë vepër mbi popullatën shqiptare në përgjithësi dhe mbi qytetarët e Kosovës në veçanti u ushtrua vepra më e rëndë e gjenocidit klasik.

Në nenin 1 të Konventës së cituar thuhet:

"Si akt krimi gjenocidi është në kundërshtim të plotë me frymën dhe qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe të civilizimit.

Krimi i gjenocidit gjatë historisë, por edhe sot, njerëzimit i shkaktoi dëme të mëdha. Për këtë arsye nënshkruesit e kësaj Konvente janë marrë vesh dhe janë dakorduar të luftojnë krimin e gjenocidit, si në luftë ashtu edhe në paqe".

Me fjalë të tjera, kjo nuk është vepër gjenocidi vetëm ndaj shqiptarëve dhe qytetarëve të tjerë të Kosovës, por njëkohësisht është vepër kundër njerëzimit, kundër parimeve të proklamuar dhe të miratuara të Kombeve të Bashkuara.

Duke marrë parasysh krimin e bërë dhe duke u nisur nga nenet

1,2 dhe 3 të Konventës për pengimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, organet dhe institucionet ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare, organet dhe institucionet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive elementare të njeriut, kanë obligim të kërkojnë të organizohen hetimet për helmimet dhe aktorët e kësaj vepre të qiten para Gjyqit ndërkombëtar.

Edhe organet e ish - Jugosllavisë në të tri nivelet e organizimit të atëhershëm (krahinor, republikan dhe federativ), duke u mbështetur në Konventën e përmendur, por edhe në Ligjin penal të ish-Jugosllavisë, kanë pasur obligim që t'i organizojnë hetimet, me qëllim që të zbulohen aktorët e këtij krimi dhe ndaj tyre të merren masa administrative dhe juridike. Shteti i ish - Jugosllavisë këtë nuk e bëri, edhe pse, siç u tha, e kishte obligim dhe detyrë. Sjelljet barbare të policisë ndaj viktimave të helmimeve, pengimi i tyre që të mjekoheshin në institutet shëndetësore, maltretimi fizik i atyre që u ndihmonin të helmuarve, bastisja e Kishës katolike në Ferizaj, por edhe në vende të tjera vetëm pse ato u kishin ofruar ndihmë të helmuarve, tregon se shteti ka gisht në helmime dhe se vetë shteti (ish - Jugosllavia) helmoi atëherë qytetarët e vet, për qëllime politike dhe ushtarake.

Analizat laboratorike të gjakut, të bëra në dy laboratorët e Parisit, video - filmat dhe xhirimet e tjera "*tregojnë se fjala është për helme kimike të luftës*" dhe se "*ky krim është bërë nga agjentët e Beogradit, me siguri agjentë ushtarakë*", deklaroi dr. Bernar Benedeti (2:22) (shih, *faksimilin*). Rezultate të njëjta nxjerr edhe A. Heyndrickx, drejtor i Laboratoriumit Ndërkombëtar të Universitetit ILUR, ekspert i KB dhe drejtor i projektit UNIDO në shkencat toksikologjike dhe të ambientit. Ky, në Konferencën e Parisit që i është kushtuar luftës biologjike dhe asaj kimike, në janar të vitit 1993, deklaroi se "*në Kosovë u bë intoksikimi masiv i fëmijëve shqiptarë si rrjedhojë e përdorimit të gazrave neurotok-*

sike nga regjimi serb" (13:2). A. Heyndrickx në intervistën dhënë revistës "Zëri" helmimin e konsideron akt gjenocidi dhe kërkon që të shqyrtohet në tribunalin e Hagës (23:14).

PROF. AUBIN HENDRIKS, EKSPERT I BOMBVEJE TË BASHKOHARA PËR HELMIMET NËNDE DHE DARTËSITË

Helmimi në Kosovë duhet të shqyrtohet në tribunalin e Hagës për krime të luftës!

Fax: Deklaratë e A. Hendriksit

Aubin Hendriks, toksikolog me famë botërore, i cili kërkoi që helmimet në Kosovë të shqyrtohen në tribunalin e Hagës



Pse hesht faktori ndërkombëtar?

Përkundër informatave objektive dhe me kohë të korrespondentëve shqiptarë dhe të huaj, të cilat plasoheshin në mjetet e informimit në botë, opinionin ndërkombëtar nuk ndërmori asgjë për të

penguar këtë krim dhe për të dënuar organizatorët e tij. Shteti në të cilin u bë kjo vepër brutale nuk pati kurrfarë pasojash. Ka shumë arsye pse heshti faktori ndërkombëtar.

Së pari pushteti jugosllav censuroi përdorimin e dokumenteve, të cilat kishin të bënin me helmimet.

Së dyti, regjimi jugosllav, përmes një propagande të furishme, të zezë, e relativizoi helmimin duke e vlerësuar si një "*aktrim kolektiv të shqiptarëve për qëllime separatiste*".


Së treti, policia serbe, përmes bisedave informative, maltretimit të njerëzve në stacionet e policisë, burgosjeve dhe arrestimeve të të gjithë atyre që dinin diçka për helmimet, ndikoi që të fuste frikë te njerëzit, qytetarët, udhëheqësit politikë, mjekët profesionistë, toksikologët dhe punëtorët e sigurimit dhe të hetuesisë dhe kështu arrin që të mos thuhej qartë dhe në mënyrë decitive e vërteta evidente. Dënimi i Gani Babatincës me pesë vjet burg dhe rrahja brutale e tij vetëm pse e kishte zënë një të ri serb për të cilin dyshohej se e kishte hedhur helmin në Podujevë, i vërtetojnë konstatimet e mësipërme. Kjo bëri që njerëzit kompetentë për çështje toksikologjike të ndërronin, brenda natës, vlerësimet për helmimin, apo kumtesat e mjekësisë. Ka indikacione se fjala ishte për helmime, por nga analizat (të cilat kurrë nuk u komunikuan) nuk mund të pohohet me siguri se fjala është për helmim, qe thënë atëherë. Edhe vlerësimet e Këshillit Ekzekutiv të Kosovës ishin të përgjithësuara. Me qëllim që e vërteta të dalë në shesh, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë e kishte formuar Konsorciumin mjekësor më 22.III.1990 në përbërje: Prof. dr. Izedin Osmani, Prof. dr. Ymer Koçinaj, Prof.dr.Stevan Balosheviq, Prof.dr.Orhan Kubati, Prof.dr.Voja Trajkoviq dhe prof.dr. Sasha Dobriçanin. Si shihet nga raporti, Konsorciumi i mjekëve më datën 22.3.1990 i vizitoi të sëmurët e hospitalizuar në klinikën neuropsikiatrike,

interne, infektive dhe gjinekologjike të Fakultetit të Mjekësisë. "Në mënyrë konsiliare janë shikuar rastet më të rënda. Të gjithë të sëmurët janë jashtë rrezikut të jetës...", thuhet në raportin, të cilin e nënshkruan të gjithë anëtarët e Konsorciumit më 22 mars 1990 në orën 15, në mesin e të cilëve ishin edhe mjekët serbë. Në raport pastaj thuhet "*Etimologjia e kësaj simptomatologjie do të përcaktohet pas analizës së gjakut, urinës dhe përmbajtjes së vjellë, që do të bëhet në laboratorët gjegjës toksikologjikë*".

Presioni nuk bëhej vetëm mbi shqiptarët. Ky bëhej edhe mbi mjekët serbë. Sipas të gjitha gjasave u bë presion edhe ndaj anëtarëve të konsorciumit, të cilët, edhe pse në raportin e cituar, me nënshkrimin e tyre, pranojnë se pasqyra klinike (e të sëmurëve, pra e të helmuarve) është polimorfe, e përcjellë me të skuqur të fytyrës, me të skuqur të lehtë të koniuktivave, me tahikardi, gërçe në stomak, humbje të vetëdijes dhe me frymëmarrje të vështirësuar, pa sindrom infektiv dhe pa puçrra në lëkurë. Më vonë me deklaratat e tyre bien në kundërshtim me etikën e Hipokratit, i mohojnë të gjitha konstatimet klinike të mjekëve me simptomatologjinë e evidencuar në historinë e sëmundjes. Ata jo vetëm se i mohojnë konstatimet profesionale të kolegëve të vet në klinikat e përmendura, por bien në kundërshtim edhe me konstatimet e veta, të cilat i nënshkruajnë në raportin konsorciumit. Të njëjtën ditë, disa orë pas nënshkrimit të raportit, dr. Stevan Balosheviq i përshkruan pacientët si artistë të ushtruar mirë (1:3).

Së katërti, helmet kimike u përdorën edhe në disa vende të tjera. Për të vërtetuar këtë, do t'i referohemi Konferencës së Parisit të mbajtur gjatë janarit të vitit 1993. Në konferencën për shtyp, Prof. A.Neyndriek, drejtor i IRUL-it deklaroi: "*Dhjetorin e kaluar në rajonin e SIEM REAP (CAMBODIA-Kamboxha) u gjetën dy depo me gasmaska dhe me pajisje ruse për të hulumtuar materiet*

luftarake kimike. Të njëjtat pajisje i gjeti UNITA të përdorura nga MPLA dhe forcat kubane në Angolë (1986). Materialet kimike-biologjike janë përdorur që nga viti 1975 kundër refugjatëve kamboxhanë. Iraku i përdori kundër Iranit më 1984. Më 1990 u zbuluan gaze neurotoksike që i përdorën serbët kundër fëmijëve në foshnjore- çerdhe. Gjatë Kërshëndellave më 1989, në Sibiu (Rumani) u helmua rezervuari nr.4 i ujit me gaz nervor (Sarin)" (13:3). Në njoftimin që e solli gazeta kroate "Veçernji List", në numrin e 28 nëntorit (1995)-vër. Halim Hyseni), thuhet se majori Graig ka biseduar me punëtorët e asaj ish-fabrike dhe ka mbledhur fakte të reja. Në fabrikën ushtarake në Potoci, Jugosllavia e ka prodhuar sarinin dhe nga ajo fabrikë i kanë shkuar dërgesat Sadam Huseinit në Irak. Në fabrikën kryesore irakiane për prodhimin e helmeve luftarake në Samari, Sadam Huseini me ndihmën jugosllave ka prodhuar helmet që i ka përdorur në Iran kundër kurdëve (10:3). Qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare iu dërguan raporte shkencore të mjekësisë dhe të toksikologjisë të nënshkruara nga disa ekspertë ndërkombëtarë. Përdorimi i helmeve kimike të luftës dëshmon se me këto helme u bë një kontrabandë, zbulimi i së cilës, sipas të gjitha gjasave do të ishte



Projektmarrëveshja për ndalimin e përdorimit të gazrave - helmeve kimike të luftës

një skandal me përmasa botërore, andaj organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e shumë shteteve nuk ishin të interesuara të organizoheshin gjurmimet ndërkombëtare për t'i zbuluar akterët e këtij krimi. Këtë e konfirmon në një mënyrë edhe Bernar Benedeti i cili thotë: "*Unë pata krijuar bindjen pas hulumtimeve që kisha bërë dy herë te ju, që në Kosovë janë përdorur substanca kimike*". Kjo bindje është dalë edhe nga laboratorit i toksikologjisë të Ministrisë së Drejtësisë në Paris dhe veçanërisht nga shefi i këtij laboratorit, profesori Hydler. Por rezultatet e këtij hulumtimi "*u futën në dollap*" që është një shprehje franceze, do të thotë se jam ballafaquar me një vullnet të çuditshëm të qeverisë franceze të asaj kohe dhe veçanërisht të zotit Rolan Dyma ministrit të jashtëm francez të asaj kohe, "të fshehtë" këtë lloj aksioni dhe rezultatet e këtij hulumtimi. Kur Bernar Kushneri (ministri i shëndetësisë dhe i çështjeve humanitare) e ka braktisur pushtetin për shkak të rrethanave të reja politike, kam kuptuar se ai në postin e tij të atëhershëm të ministrit shtetëror për çështje humanitare ishte ballafaquar me një bllokadë totale të bëjë diç që kjo dosje të ecte para (21:20). Kjo ndikoi që e vërteta për helmimin në Kosovë të mos depërtojë shpejt dhe në përmasa të gjera.

Këtë hipotezë të parashtruar në fund të vitit 1994, nga koha kur nuk diheshin rezultatet e gjurmimit të programit televiziv, "Vorl in Action" e vërtetojnë edhe konstatimet e Graigut, në një anë, dhe në anën tjetër dëshmitë e Stipe Mesiqit, lider i demokratëve të pavarur kroatë dhe ish-kryetar i RSFJ-së, të prezentuara Ministrisë Amerikane të Mbrojtjes, e cila i shfrytëzoi këto të dhëna dhe me "*siguri nëpërmjet kanaleve të caktuara i tërhoqi vërejtjen Serbisë*" (10:3).

Nga bllokada informative pasuan dy rrjedhoja tepër negative për shqiptarët me çka u krijuar në botë huti dhe dilema se a pati apo

nuk pati helmime në Kosovë dhe kështu edhe brenda Jugosllavisë Serbia arriti po ashtu ta relativizonte çështjen e helmimeve.

Konstatimin e parë dhe të dytë e vërtetojnë pohimet e Kristina Fon Kollit dhe të Vollfgang Libalit, të cilët lidhur me këtë deklarojnë: "*Keqësimit dramatik të situatës ndërmjet popullatës shqiptare dhe administratës serbe i kontribuoi afërsisht 3000 shkollarëve shqiptarë...Autoritetet serbe flasin për histerinë masive të organizuar këtu*" (6:122). Më pastaj deklarojnë: "...*hulumtimet e organizatave ndërkombëtare nuk dhanë rezultate unike për sa u përket helmimeve*"(6:122). *Këtu vërehen këto karakteristika: Autorët helmimet i quajnë aferë dhe çuditërisht këto fjalë i fusim nën thonjëza. Kjo do të thotë se edhe vetë këta autorë dyshojnë se ka pasur helmime. Konstatimi i tyre se organizatat ndërkombëtare nuk arritën në rezultate unike është i paqëndrueshëm. Këtë pohim e demantojnë gjurmimet e dr. Bernar Benedetit, HEYNDRICKS DOLENCIT, GRAJGUT, GRAVESIT, etj.*

Serbët, përmes një propagande të furishme dhe të zezë, arritën t'i relativizojnë helmimet, të bllokojnë publikimin e materialeve dhe të fakteve për këtë krim. Të trimëruar nga mosreagimi i faktorit ndërkombëtar, procesin e helmimit e vazhdojnë edhe 52 ditë gjatë vitit 1990.

Nga provat dhe faktet e prezentuara pamëdyshje vërtetohet se helmimi i qytetarëve të Kosovës, kryesisht të rinj me përkatësi kombëtare shqiptare ishte një akt gjenocidi i orientuar kundër një populli joslav. Ky akt krimi me konotacione ekskluzive politike dhe ushtarake kishte për qëllim:

- që të provoheshin efektet e helmeve, teknika e helmimit dhe doza, e cila do të ishte e mjaftueshme për shfarosjen masive të popullit shqiptar në luftën eventuale shqiptaro-serbe;

PROF. A. HEYNDRICKX
1876, M. Sc. Dr. Ph. Sc.
TOXICOLOGY ENVIRONMENTAL SCIENCES
UNWOC PROJECT DIRECTOR UN EXPERT
Dr. h. c. UNIV. (LILLE) FRANCE
OUTSTANDING ACHIEVEMENT AWARD
UNIV. MARYLAND, U.S.A.
INTERNATIONAL REFERENCE UNIVERSITY
LABORATORIES (IRUL) DIRECTOR

8-5408 CHEMIST
41 BENAARDSTRAAT
BELGIUM
TEL. FROM ABROAD
07311 25 32 48
FAX 07311 34 13 21
IN BELGIUM 0911

7th January 1993

PRESS RELEASE

Chemical Biological Warfare - Paris Conference

(January 1993)


Last December 1992 in the region of SIEM REAP (Cambodia) two depots were found with russian gasmasks and russian equipment to detect chemical warfare agents. The same equipment was found by UNITA used by the MPLA and Cuban forces in Angola (1986).

Chemical and (or) Biological warfare agents were used since 1975 against Cambodian refugees. Since 1984 by Iraq against Iran.

In 1990 we detected neurotoxic gases used by Serbs against children in nurseries (Kosovo).

At Christmas 1989 at Sibiu (Roumania) water tower n°4 was poisoned by nerve gas (Sarin).

Scientific medical and toxicological reports signed by several international known experts were sent to Governments and International Organisations.



Prof. A. HEYNDRICKX
Director IRUL
Ghent - Belgium



A. Hendriks për helmimet në Kosovë

- që në popullatën shqiptare të shkaktohej panik dhe një presion, pasojë e së cilës do të ishte pastrimi etnik, shpërngulja dhe pasiguria;



Duke e bartur të helmuarën për në spital

- që nxënësit e shkollave të mesme nga frika dhe pasiguria, ta braktisnin arsimin e mesëm dhe kështu të këputej zinxhiri natyror mes shkollave të mesme dhe fakulteteve dhe në këtë mënyrë përfundimisht të rrënohej arsimi shqiptar;

- që shqiptarët, nga mllëfi, të çoheshin në një kryengritje eventuale, e cila, ashtu siç e pat thënë Vasa Qubrilloviqi në *Elaboratin e parë* (1937), të shuhej me gjak, dhe kështu një herë e përgjithmonë të bëhej pacifikimi i Kosovës përmes gjenocidit klasik.

Me qëllim që pasqyra për helmimet të jetë sa më objektive, në mbështetje të argumenteve relevante, do të bëjmë analizën e mendimeve të ndryshme për helmimet.

ÇFARË ËSHTË E VËRTETA PËR HELMIMET

Helmimi i qytetarëve të Kosovës, edhe pse filloi para 9 vitesh, gjatë tërë kësaj kohe mbeti aktual. Këtij fenomeni i kthehemi ne shqiptarët, pasi që ky si proces la trauma të përhershme, jo vetëm te viktimat e helmimit, por edhe te familjet, farefesi dhe tërë populli shqiptar, kudo që ai jeton. Helmimi la vrugë të mëdha te intelektualët shqiptarë, të cilët assesi nuk mund të pajtohen dhe nuk mund të jenë të kënaqur me heshtjen e botës së qytetëruar ndaj këtij krimi, i cili edhe pse në esencë ishte bërë kundër shqiptarëve, me orientim ishte dhe është krim kundër njerëzimit.

Helmimeve, pandërprerë u kthehen edhe serbët, qoftë në mjetet e informimit (TELEVIZION, RADIO apo SHYTP), qoftë në intervistat e politikanëve, mjekëve, punëtorëve publikë, qoftë nëpërmjet publikimeve periodike profesionale apo shkencore dhe pseudoshkencore, por edhe nëpërmjet fjalimeve dhe paraqitjeve të tjera publike. Jemi të prirur të besojmë se ky kthim i serbëve në temen e helmimeve, në mes të tjerash, bëhet edhe për shkak të ndërgjegjes së vrarë dhe të ndjenjës së fajësisë.

Nga konstatimet e deritashme mund të konkludohet se vlerësimet për helmimet janë të ndryshme. Kjo do të thotë se ka shumë vlerësime dhe shumë të "vërteta". Kështu mund të flitet për të vërtetën e shqiptarëve, për disa të "vërteta" dhe vlerësime serbe për helmimet dhe për të vërtetën e vërtetë e objektive për helmimet.

Vlerësimet shqiptare për helmimet

Vlerësimet jooficiele për helmimet, pa aluduar dhe saktësuar se kush, me çka dhe si i bëri, i dhanë shqiptarët në mjetet e informimit duke u mbështetur në diagnozat klinike të mjekëve dhe në barnat, të cilat iu dhanë pacientëve për t'i ndalur dhembjet e mëdha dhe të padurueshme. Këto vlerësime u shpallën në mjetet e informimit në gjuhën shqipe. Korrespondentët dhe gazetarët shqiptarë, të cilët ishin në vendet e ngjarjes në të gjitha qytetet e Kosovës, për gazetat e tyre informonin në hollësi për numrin e të helmuarve dhe për simptomet e të sëmurëve. Ata përcillnin mendimet e mjekëve lidhur me simptomatologjinë dhe gjendjen shëndetësore të të sëmurëve. Me shqetësime të mëdha raportonin për skenat trishtuese dhe llahtarë, nëpër të cilat kalonin viktimat e helmimeve masive të rinisë shqiptare.

Raportet e gazetarëve dhe të korrespondentëve informonin se kishim të bënim me "*helmim të rëndë, të cilit, kryesisht, i nënshtrohen nxënësit dhe qytetarët shqiptarë*". Në terren, gazetarët dhe reporterët shqiptarë dhe gazetarët e huaj me kujdes dhe pedanteri regjistronin edhe sjelljet dhe veprimet e policisë serbe. Organet profesioniste dhe organet e shtetit në Kosovë, përkundër numrit enorm të viktimave të helmeve, para opinionit nuk dhanë kurrfarë komunikate zyrtare. Kështu, korrespondenti i "*Veçernji listit*" të Zagrebit, z.Shefki Ukaj, më 23 mars 1990 për ditarin e TV-Zagreb bit deklaroi: "*Kaluan katër ditë dhe askush prej organeve shtetërore dhe profesionale të mjekësisë nuk u deklarua se për çfarë mjetesh kimike është fjala*".

Konsorciumi i mjekëve (i formuar më 22 mars 1990, në orën 15) raportoi duke konstatuar se: "*Pasqyra klinike është polimorfe, e përcjellë me pamje të skuqur të fytyrës, tahikardi, shtrëngime në*

Konzilijum koji je formirao Dekan Medicinskog Fakulteta
u sastavu

1. Prof. dr Izudin Osmani
2. Prof. dr Ymer Koçina
3. Prof. dr Stevan Baljosević
4. Prof. dr Orhan Kubati
5. Prof. dr Voja Trajković
6. Prof. dr Sasa Dobričanin

Obišao je hospitalizirane bolesnike po klinikama
Medicinskog fakulteta: Neuropsihijatrijska klinika, Infektivna,
Internā i Ginekologija.

O primljenim bolesnicima referisali su lekari koji
su ih primili i koji ih leče u toku današnjeg prepodneva.

Konzilijarno su pregledani najteži slučajevi, svi
su van životne opasnosti i primaju odgovarajuću terapiju. Neophodno
je da se teški bolesnici neprekidno prate a onima koji su ischezli
simptomi otpuste kući po naloženju lekara koji ih leče.

Etiologija ove simptomatologije će biti utvrđena
posle analize krvi, mokraće i povraćanog sadržaja koji će se ana-
lizirati u odgovarajućim toksikološkim laboratorijama. Klinički
nalaz uz simptomatologiju evidentiran u istoriji bolesnika.

Klinička slika je polimorfna, propraćena zažarenim
izgledom lica, lakim crvenilom konjuktiva, tahikardijom, grčevima
u truhu, nesvesnicom i otežanim disanjem bez infektivnog sindroma
i osipi po koži tela.

22. III. 1950 u 13 časova

1. Prof. dr Izudin Osmani
2. Prof. dr Ymer Koçina
3. Prof. dr Stevan Baljosević
4. Prof. dr Orhan Kubati
5. Prof. dr Voja Trajković
6. Prof. dr Sasa Dobričanin

Izudin Osmani
Ymer Koçina
Stevan Baljosević
Orhan Kubati
Voja Trajković
Sasa Dobričanin

Mendimi i konsorciumit të mjekëve për helmimet në Kosovë

stomak dhe vështirësi NË FRYMËMARRJE dhe pa SINDROM INFEKTIV dhe plloha (ospe) nëpër lëkurën e trupit".

Këshilli Ekzekutiv i Kosovës "u bën ftesë qytetarëve që të mos bien në provokime dhe të mos dalin në rrugë se këtë me qëllim dikush e kërkon". Kjo kërkesë në formë të apelit drejtuar shqiptarëve tregon se ekzistonin dyshime se helmimi ka për qëllim që shqiptarët të provokohen për t'u ngritur në një protestë, e cila pastaj, në frymën e porosive të Vasa Qubrilloviqit, do të dënohej me gjakderdhje.

Sa më tepër që shtohet vlerësimi se kishim të bënim me helmime, proporcionalisht me këtë shtohet dhuna dhe represioni mbi shqiptarët. Presioni i organeve të Serbisë mbi udhëheqësit e atëhershëm shqiptarë, mbi organet e pushtetit dhe mbi organet profesionale dhe shkencore të mjekësisë bëhej gjithnjë më i madh. Ky presion shkaktoi frikën për pasoja individuale dhe kolektive. Kërcënimet dhe shantazhet e policisë serbe, dhe të organeve të pushtetit bënë që udhëheqësit e atëhershëm shqiptarë, ekspertët dhe profesionistët të mos guxonin ta thoshin të vërtetën për helmimet. Vlerësimet, edhe pse ishin të përgjithësuara dhe të kamufluara, sinjalizonin mjaft qartë se fjala është për helmim. Frika krijoi pasoja shumë të mëdha në gjendjen e përgjithshme të shqiptarëve.

Pasoja më e madhe ishte eskalimi i mëtejme i dhunës shtetërore mbi shqiptarët në përgjithësi e veçmas mbi ata të Kosovës. Sikur udhëheqësit e atëhershëm shqiptarë të Kosovës të kishin guximin elementar të qytetarit, ata do të kërkonin me ngulm që nën mbikëqyrjen e një KOMISIONI NDËRKOMBËTAR të organizoheshin hetimet, me qëllim të zbulimit të aktorëve të krimit. Duhet përmendur se me kërkesën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (Prishtinë) Kosovën e viziton një komision

ndërkombëtar në përbërje: Dr. Çarlls Grejv (Komisioni Ndërkombëtar i Punëtorëve Shëndetësorë për të Drejtat Shëndetësore dhe të Njeriut), zonja Verena Graf (Lidhja Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Lirinë e Popujve), dhe Dr. Zhan Zhak Kirikijarian (Lëvizja kundër Racizmit dhe për Miqësinë mes popujve) në gusht të vitit 1990, i cili mbledh informata të rëndësishme, por kthehet pa përfunduar punën, dëbohet nga policia serbe (24:16-18).

DËBIMI I MISIONIT NGA KOSOVA

Misioni ynë ishte shumë i shkurtër, e në fakt ishte shkurtuar edhe më nga ndërhyrja policore; dy ditë me radhë jemi mbajtur tre orë në hetime. Më në fund, kërkuan nga ne që të braktisim Jugosllavinë brenda 24 orëve. Për shkak të kësaj, nuk ishim në gjendje të dëgjojmë shumë dëshmitarë dhe, paradoksalisht, rasti i dytë, kur na arrestoi policia, ishte gjatë takimit tonë me shoqatën serbe "Bozhur". Në atë takim, për më tepër, shumë pak mund të diskutohej për ndonjë zgjidhje. E njëjta vlen edhe gjatë arrestimeve të policisë, që do të duhej të konsideroheshin si hetime policore.

Raportet për sëmundje në mesin e shumë nxënësve në Kosovë, që datonin më 22 dhe 23 mars të këtij viti, së shpejti

*Dëshmi për dëbimin e Komisionit Ndërkombëtar
për zhdukjen e gjurmëve të krimit.*

Ky komision në raportin e përgatitur konstaton të dhëna dhe argumente të cilat do t'u ndihmojnë ekspertëve ndërkombëtarë të konstatojnë se në Kosovë u bë helmimi dhe se ky helmim u bë me helmin *Sarin*. Vetë dëbimi i komisionit tregon se Jugosllavia ka qenë e interesuar që e vërteta të mos dalë para opinionit.

Është shumë e besueshme se sikur insistimi i organeve të Kosovës, intelektualët shqiptarë, mjekët dhe institucionet e tjera të Kosovës të ishin më këmbëngulëse, do të thyhej bllokada që organet e ish-Jugosllavisë u bënë komisioneve të ndryshme ndërkombëtare. Ky insistim ndoshta do të ndalte dhunën e mëtejme, ndërsa kriminelët përgjegjës për këtë vepër gjenocide ndoshta do ta merrnin dënimin e merituar. Nga kjo do të arriheshin edhe efekte politike meqë çështja e Kosovës do të kuptohej në mënyrë më të drejtë dhe më objektive. Terrori, dhuna dhe gjenocidi i ushtruar nga regjimi serb mbi shqiptarët do të nxiste reaksione më të mëdha ndërkombëtare. Në vend të mirëkuptimit ndaj politikës kriminale dhe antinjerëzore serbe, Jugosllavisë përkatësisht Serbisë si bumerang do të mund t'i kthehej izolimi dhe presioni më i hershëm ekonomik, politik dhe monetar. Sikur kjo të bëhej me kohë, tragjedia ballkanike ndoshta nuk do të ndodhte, shqiptarët nuk do të ishin në këtë gjendje çfarë janë sot, nuk do të pësonin qindra mijëra familje nga format e ndryshme të trajtimeve policore, nuk do të përjashtoheshin mbi 450.000 nxënës dhe studentë nga objektet e veta shkollore, nuk do të mbahej mësimi në objekte private siç po ndodh me studentët shqiptarë, me mbi 95% të nxënësve të shkollave të mesme dhe me mbi 52.000 nxënës të shkollave fillore, nuk do të shpërnguleheshin nga Kosova mbi 500.000 të rinj, nuk do të bëheshin të gjitha këto vrasje, plagosje, torturime të ndryshme policore, nuk do të bëhej kolonizimi i ri i Kosovës me kolonistë serbë siç po ndodh me ndërtimin e 350

shtëpive në Junik e në vende të tjera ku kurrë nuk ka pasur serbë, (qeveria serbe pohon haptas se do të vendosë mbi 100.000 serbë), nuk do të mbyllej qendra e studentëve, e kështu me radhë.

Ekspertët e Fakultetit të Mjekësisë, kryesisht shqiptarë, përkundër ngathtësisë, frikës, burgosjes së tre mjekëve dhe izolimit të dy të tjerëve (në burg) dhanë vlerësime relevante, profesionale dhe objektive për helmimet. Kështu, dr.Kajmak Gazideda, mjek në Klinikën Infektive, atë kohë, për *"Veçernji list"* të Zagrebit më 26 mars 1990, deklaroi: *"... se asnjë nga 400 pacientët, sa kaluan nëpër këtë klinikë deri të enjten nuk kishte sindrom infektologjik. Pasqyra klinike tregon për ATAKIMIN NË SISTEMIN NERVOR VEGJETATIV, përkatësisht për çrregullimin e balancit"*.

Mendim të ngjashëm me këtë dha edhe prof.dr.Iusuf Dedushaj, i cili për të njëjtën gazetë deklaroi se nuk kemi të bëjmë me kurrfarë epidemie të shkaktuar me bakterie apo viruse, por me një sëmundje masive nga shkaktarë të panjohur.

Profesor dr.Mustafë Cakaj neuropsikiatër, për ditarin e TV-Zagrebit, më 23 mars 1990 tha: *"...se nuk mund të deklaronte asgjë"*. Më pastaj shtoi *"...se janë bërë analizat e gjakut dhe se këto janë dërguar në hulumtim në Entin Higjienik të Kosovës dhe në disa poliklinika jashtë Kosovës"*.

Dr. Muharrem Avdiu korrespondentit të *"Veçernji listit"* të Zagrebit, Shefki Ukajt i deklaroi: *"Kemi të bëjmë me helme neurotoksike të natyrës tepër të rëndë"*.

Mjekët shqiptarë S. Dobreci, Z. Hundozi, L. Gashi, L. Luci, K. Gazideda, A.Zajmi dhe I. Dedushaj, në raportin e tyre me titull: *"Faktet dëshmojnë për helmimin në Kosovë"*, deklarojnë: *"Në bazë të të gjitha të dhënave, ngjarja e vitit 1990 nuk mund të shpjegohet si histeri e përgjithshme, por si helmim masiv i popullatës shqip-*

tare, kryesisht i nxënësve". Për këtë doc. Isuf Dedushaj, dekan, deklaroi se nuk është fjala për kurrfarë epidemie të sëmundjeve ngjitëse të shkaktuara nga bakteriet, virusët, parazitët apo ndonjë agjens tjetër infektiv, i cili do të mund të gjendej në ushqim apo në ujë të kontaminuar. Për këtë shih në revistën "Shkëndija" nr. 8, 15 prill 1990, në artikullin e Sabit Jahës: "Ç'THONË EKSPERTËT PËR HELMIMIN MISTERIOZ", ku thuhet: "Që nga 22 deri më 29 mars (1990) nga "sëmundja misterioze" u prekën më shumë se 4 mijë veta. Nuk kontestohet sëmundja, por shkaktarët dhe simptomat e saj. Për 59,52 për qind të të shtrirëve në Klinikën e Sëmundjeve Ngjitëse në Prishtinë u caktua diagnoza klinike përfundimtare NEUROTOXICITATI (lexo e kupto: HELMIMINË BAZË NERVORE). Shpërputhja ndërmjet simptomatologjisë klinike dhe rezultateve laboratorike kërkon shpjegime të mirëfillta shkencore, të cilat do të mënjanonin thashethemet dhe keqinterpretimet e opinionit të ndarë. Megjithatë, Akademia Mjekësore Ushtarake publikon të dhënë se s'ka helmim..." (18:2).

Lidhur me vlerësimet shqiptare për helmimet Elviana Berani shkruan: "Në ato ente shëndetësore, në të cilat organet e sigurimit nuk prekën historitë dhe dokumentacionin tjetër mjekësor të pacientëve, sikundër edhe në entet ku evidenca është mbajtur e duplikuar, u punuan raportet e thukëta në të cilat pos aspektit informativ për gjendjen u bënë edhe analizat e simptomeve të konstatuara te pacientët. Në raportin e Klinikës së Kirurgjisë në Prishtinë, të cilën e përpiluan dr. Shpëtim Robaj, doc. dr. Zuvdija Kandiç, dr. Miomir Qosiq, anaesteziolog, dr. Hasan Ahmeti e dr. Dalip Limani theksohej se ndër 67 pacientët e hospitalizuar atëbotë në Klinikë me diagnozë "Intoxicatio acuta" qenë pranuar 62 syresh. Të gjithë 62 pacientët nga Klinika qenë lëshuar me diagnozën "INTOXICATIO ACUTA CAUSA INNOTA", thuhej

pos tjerash në atë raport, ku gjithashtu vihej në spikamë se nga numri i gjithmbarshëm i pacientëve të hospitalizuar asokohe 19 sish në Klinikë, u sollën në gjendje të alivanosur, se 74,6 për qind me kokëdhembje, 64,1 për qind me dhembje abdominale. Ndër simptome të tjera që përmendeshin në këtë raport ishin edhe atonia e ekstremiteteve të poshtme (12 veta), vjelljet (20 veta), ngërçet e duarve në formë të dorës akusherike (12 pacientë), midriazë, miozë, hiperemi të konjuktivit konvulzione, cianozë periferike (tek 3 sish), trizmus të nofullës (1 pacient)". Përmenden edhe marramendja, djegia dhe dhembjet e syve, skuqja e mollëzave dhe e laprave të veshëve, pengesat në frymëmarrje, molisje e të ngjashme. Në diagnozën *Intoxicatio* qenë lëshuar edhe pacientët nga Klinika Infektive e Prishtinës, ambulanca shëndetësore në Vushtrri, Podujevë, në Spitalin e Gjakovës etj. Se fjala është për helmim pajtohen edhe mjekët dr. Ilir Tolaj, Dr. Izedin Osmani, dr. Nysret Ramadani, dr. Dylen Vranica, dr. Agron Zajmi, etj. (3. nr. 4, fq. 27, mars 1995) (3:4).

Kjo është e vërteta shqiptare për helmin e vitit 1990, kur pësuan keq më se 7.421 viktima të drejtpërdrejta, kryesisht të rinj e të reja shqiptare.

Me të vërtetën shqiptare, fare nuk pajtohen dhe nuk përputhen vlerësimet serbe, andaj, duke pasur parasysh këtë, do t'u referohemi edhe vlerësimeve serbe për këtë krim.

Vlerësimet dhe "të vërtetat serbe" për helmimet

Për helmimet, mjetet e informimit në gjuhën serbe, punëtorët shkencorë, politikanët dhe diplomatët serbë kanë disa vlerësime dhe "të vërteta". Këto vlerësime do t'i paraqesim në mënyrën kronologjike ashtu siç janë paraqitur dhe siç janë plasuar para opinionit.

Të gjitha mjetet e informimit në gjuhën serbe, vlerësimin e parë "profesional" e marrin nga prof. dr. Stevan Balosheviq, i cili, siç thamë, përkundër asaj që kishte nënshkruar në raportin e konsorciumit të mjekëve më 23 mars 1990, në orën 15, në mbrëmje të së njëjtës ditë, në bisedën e " rastit " me gazetaret serbë deklaroi për helmimin se *"fjala është për një teatralizëm të ushtruar mirë"*. Ky ishte vlerësimi i parë serb dhe e "vërteta" e parë serbe për helmimet masive të të rinjve. Duke e marrë këtë komunikatë, reporteri dhe korrespondenti i TV Beogradit nga Kosova Milisav Miliq, për ditarin e TV-Beogradit deklaroi në mënyrën skandaloze se *"Akttrimeve të shqiptarëve do t'ua kishin lakmi edhe artistët e festivalit të Kanit"*. Pos pësimeve të mëdha të të rinjve shqiptarë dhe të të tjerëve si dhe ankthit të prindërve të fëmijëve të helmuar, tragjike është edhe se me vlerësimet e këtilla të prof. dr Stevan Balosheviqit ra në provim etika mjekësore, parimi i Hipokratit u bë viktimë e një politike gjenocide. Kjo tragjike është edhe më e rëndë kur dihet se Stevan Balosheviqi ka qenë në krye të UNICEF-it dhe rektor i Universitetit të Prishtinës. Ai pastaj u bë udhëheqës i dhunshëm i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, të cilin "e transformoi" në Qendër klinike pas përjashtimit të më se 1400 punëtorëve shëndetësorë dhe të gjithë studentëve dhe profesorëve shqiptarë. Vlerësimet e këtilla cinike, sikur të mos kishin të bënin me skenat vërtet trishtuese dhe të llahtarshme të të rinjve dhe të qytetarëve kosovarë në përgjithësi, do të ishin vërtet komike, mirëpo një vlerësim i këtillë , konform tragjedisë së pashembullt të mijëra familjeve ishte tepër jonjerëzor, cinik dhe kriminel. Është për t'u habitur se si mund të jpte një vlerësim të këtillë ai njeri, i cili pati rast jo vetëm të shohë, por dhe t'u ofrojë ndihmë dhe shërbime të tjera mjekësore mijëra fëmijëve dhe të rinjve, të cilët kishin dhembje të padurueshme, temperaturë të lartë, tahikardi, pengesa të

mëdha në frymëmarrje, shtrëngime të mëdha të muskujve, ngërçe të padurueshme në stomak, dhembje të mëdha koke, në qafë, në kraharor, që kishte rast të shohë fëmijë që binin në komë si pula pa kokë e kështu me radhë. Si qe e mundur dhe çka e shtyri këtë njeri që, në kundërshtim me atë që vetë e kishte nënshkruar, pak orë më vonë të japë mendim kaq monstruoz, cinik dhe jonjerëzor. Profilin e vet mental, emocional dhe social ky e kishte treguar edhe në kohën kur ishte rektor i Universitetit të Prishtinës, kur nuk lejonte që në fakultet të regjistroheshin studentë shqiptarë, apo kur i dënonte dhe i përjashtonte ata dhe punëtorët e tjerë vetëm për shkak të bindjeve të tyre politike. Si nuk e "kuptonte" dot se nuk ishte e mundur që shqiptarët ta detyronin të teatrizojë fëmijën e helmuar trevjeçar me përkatësi malazeze, nga Gjakova me emrin *Igor Gashiq*, të pyeste si ishte e mundur të teatralizonte plaka 50-vjeçare, *Mara Gjuroviq* nga Fushë Kosova për qëllime politike të shqiptarëve. Ky nuk donte të merrte vesh se pse milicët serbë nga Vushtrria "teatralizojnë" për interesa politike nacionaliste dhe separatiste shqiptare.

Në të vërtetë, ky i dinte të gjitha këto. E dinte se helmimet ishin realitet dhe objektivitet, diç që ka ndodhur dhe që ndodhte pandërprerë. E dinte se kush e bënte këtë dhe për çfarë qëllimesh. Ky kishte marrë detyrë që kështu të deklaronte dhe të sillej ashtu që etikën mjekësore t'ua nënshtronte motiveve gjenocide serbe për pacifikimin e Kosovës përmes dhunës.

Në mbështetje të deklarimeve dhe të sjelljeve të këtilla, duke u bazuar në nenin 3 të Konventës për pengimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, ky duhet të ndiqet si pjesëmarrës në krimin e gjenocidit kundër shqiptarëve.

"Të vërtetën" e dytë serbe për helmimet, pas "teatralizimit kolektiv", e hodhën poshtë argumentet shkencore. Përgënjeshtrimi

i parë për shqiptarët "ARTISTË", dhe "SIMULANTË" për "qëltime separatiste" vjen nga neuropsikiatri i njohur prof. dr. Vojislav Trajkoviq, i cili në deklaratën për ditarin e TV të Novi Sadit tha...se te shumica e pacientëve është konstatuar gjendje e induktuar psikoreaktive, këto gjendje nuk mund të teatralizohen e as të simulohen (shih faksimilin).

PSIHUZA UZROK TROVANJA'?

● Prof. dr. V. Trajkovic izjavio da se radi o "psihoreaktivnoj indukciji" kao uzroku oboljenja ● Ostavke, smjenjivanja, suspenzije STR 4

Si bie në provim etika e Hipokratit

Ky mjek pranon se aktrim nuk ka. Për çudi, mjeku serb e demanton mjekun serb e të dy janë anëtarë të konsorciumit. Në këtë vlerësim, të cilit në aspektin profesional nuk mund t'i jipet vërejtje, kemi një konstatim, i cili nuk përkon me realitetin. Ky në deklaratë thekson se shumica e pacientëve janë me gjendje të induktuar psikoreaktive. Është më se e sigurt se kjo nuk mund të jetë e vërtetë dhe bie në kundërshtim me ligjshmëritë, të cilat i nënshtrohen distribuimit normal.

Me këtë vlerësim në mënyrë të tërthortë pranohet te një pakicë se ekzistojnë dyshime për diçka tjetër e jo për induksion psiko-reaktiv. Mirëpo, për mjetet në gjuhën serbe, ky formulim njafton të konstruktohet e "vërteta" e dytë serbe për helmim. Duke u nisur nga një pjesë e këtij vlerësimi dhe duke bërë përpjekje që shqiptarët e rinj t'i paraqesin si njerëz të indoktrinuar me separatizëm dhe

nacionalizëm, në vend për helmim, flasin për një histeri masive. Kështu - në titull bombastik shkruhet: HISTERIA MASIVE E SHQIPTARËVE APO PSIKOZA SHKAK I "HELMIMIT" (shih faksimilin).

PROF. DR. VOJISLAV TRAJKOVIC O EPIDEMJI PSIHOFIZICKIH TEGOBA MEËU MLADIMË NA KOSOVU

»Pshioreaktivna indukcija«

PRIËTINA - U sobotu naveçer posjetili smo Infektivnu i neuropsihijatrijsku kliniku Medicinskog fakulteta glavnog grada Kosova, gdje smo razgovarali s liječnicima i posjetili nekoliko pacijenata. Prof. dr. Kajmak Gazideda, s Infektivne klinike, kazao nam je da nijedan od 400 pacijenata koliko ih je od četvrtka prošlo kroz kliniku nije imao infektozski sindrom, ali klinička slika ukazuje atakiranje na vegetativno-zlčvanci sistem, odnosno na poremećaj balansa. Rekao nam je i to da je bilo i induciranih slučajeva. Njegov kolega prof. dr. Jusuf Dedushaj, načelnik Instituta za epidemiologiju, rekao je da se ne radi ni o kakvoj epidemiji prouzrokovanoj bakterijama ili virusima, nego o masovnim oboljenjima nepoznatog uzročnika.

Oboljeli pacijenti koje smo posjetili na Infektivnoj klinici, zaćudo, premda je riječ o srednjoškolicima, nisu znali srpsko-hrvatski jezik, zale se na bolove u trbuhu, vrtoglavicu, visoku temperaturu, grčeve u ekstremitetima. Ako nije riječ o epidemiji ćiji su uzročnici bakterije ili virusi, onda preostaje samo da se nagada, til da se prenose dezinformacije koje lansiraju albanski nacionalisti i separatisti. Naime, oni fabriciraju priće da su ućenici albanske narodnosti iskušali bojne otrove, za šta ne postoje nikakvi dokazi. Međutim, sasvim decidna stručna mišljenja dobili smo na Neuropsihijatrijskoj klinici koja je primila 180 pacijenata koji su se, nakon ukazane pomoći, vratili kućama.

Direktor te klinike prof. dr. Vojislav Trajković, poznati neuropsihijetar, u izjavi za TV Novi

Sad rekao je da su kod najviše pacijenata utvrdena psihoreaktivna inducirana stanja. Ta stanja ne mogu se glumiti, niti se mogu simulirati jer su to nesvjesne reakcije.

- Tim stanjima su podložni mladi ljudi, jer su frustrirani, osjećaju neizvjesnost, strah, tjeskobu i dovoljna je samo jedna dezinformacija ili dovoljno je da vide oboljelog kojem je narusen neurovegetativni sistem, da se induciraju, to jest da dođu u psihoreaktivna stanja, da budu zahvaćeni induciranom konverzivnom neurozom koja imitira gotovo svako organsko oboljenje. Objasnio nam je dr. Ferid Agari, dežurni liječnik u Neuropsihijatrijskoj klinici. Baš u trenutku razgovora s njim došao je jedan pacijent iz Prištine, srpske nacionalnosti. Naš sugovornik nam je rekao i to da o svim pacijentima koji su prošli kroz njihovu kliniku postoji i dokumentacija koju su vodili lijećnici svih nacionalnosti te da na njihovoj klinici nije moglo biti ni rijeći o bolesnicima-glumcima.

Neslužbeno smo doznali da je kroz sve klinike Medicinskog fakulteta (ginekologija, interna, kirurgija, neuropsihijatrija, infektologija, dječja...) prošlo oko 1800 pacijenata. Kod mnogih od njih vrtoglavica, povišena temperatura, bolovi u trbuhu, nesvjestica i drugi simptomi, kad im već nije uzrok trovanje, vjerojatno su uzrokovani politićkim razlozima? Jer, vaši izvjesitelji nako ne mogu prihvatiti kao normalno to što dvije pacijentkinje na Infektivnoj klinici dva dana leže u krevetu obućene u džempere i jeans-jakne.

Dëshmi e mjekut serb, Prof. dr. Vojislav Trajković se megjithatë në Kosovë pati helmim

Për gjendjen e indukuar psikoreaktive, flet edhe neuropsikiatri dr. Ferid Agani, i cili thotë: *"Këtyre gjendjeve u shtrohen njerëzit e rinj, pasi që janë të frustruar, e ndiejnë pasigurinë, frikën, brengën (anaksiozitetin) dhe është e mjaftueshme vetëm një dezinformata apo vetëm ta shohin të sëmurin, të cilit i është rrënuar sistemi neurovegjetativ që të induktohen përkatësisht t'u shkaktohet gjendja psikoreaktive, që të përfshihen me neuroza të induktuara konversive, të cilat imitojnë gati secilën sëmundje organike"*.

Ndaj këtyre mendimeve profesionale nuk mund të ketë vërejtje, por assesi, nuk mund të pohohet se kolapsi dhe disa simptome të tjera, të manifestuara të ngjashme me histerinë kolektive, i zëvendësojnë helmimet siç konkludojnë mjekët May dhe Foran. Është e vërtetë se te një numër i vogël i pacientëve kishte reagime të shkaktuara në baza psikologjike, por shumica e pacientëve tregonin simptome të helmimit.

Se helmimi nuk mund të arsyetohet me induksion psikoreaktiv dhe me neuroza konversive dhe me gjendje hipnoide ka edhe shumë argumente të tjera. Ne do t'i përmendim disa nga këto dëshmi, të cilat e demantojnë "të vërtetën" e dytë serbe, veçmas të potencuar në masmediumet për gjoja "histerinë kolektive".

Gjatë kohës kur u bë helmimi në Kosovë (shih kalendarin dhe grafikonin) *"pos simptomeve të tjera, te pacientet paraqitej të skuqurit e syve dhe topitja e reflekseve, pastaj mydriasi, mosisi, pengesa në të parët nystagmus, gasciculacion", të konstatuara nga mjekët kosovarë.*

Përpyekja që helmimi të shpjegohet me gjendje induktive - me histeri kolektive apo me neurozë konversive a gjendje hipnoide nuk mund të qëndrojë, sepse "... simptome të tilla kishin edhe 11 fëmijë të sëmurë të moshës 1-5 vjeç, një moshë, e cila përjashton reagimin histerik". Tezën e mjekëve serbë për gjendjet psikoreaktive e

demanton edhe neuropsikiatri shqiptar dr. Agron Zajmi, i cili në kohën kur u bë helmimi masiv i të rinjve shqiptar ishte edhe drejtor i Spitalit në Gjakovë, ai thotë: *"Terapia e dhënë të gjendjet psikoreaktive të indukuara do ta qetësonte menjëherë pacientin, por në rastet tona në terapinë e tillë nuk reagonte fare për arsye se vendi ku duhej lidhur me neurotransmiter ishte i zënë dhe i bllokuar me neurotoksi"* (26 mars 1996, fq.6) (3:6).

Helmimi i qytetarëve të Kosovës u bë në bazë të SKENARIT të përgatitur mirë dhe të hartuar nga ekspertë të disiplinave të ndryshme. Këtu marrin pjesë, sipas të gjitha gjasave, edhe ekspertë të luftës speciale, të luftës psikologjike, psikologë dhe kimistë , toksikologë, ekspertë ushtarakë etj. Me skenar ishte parashikuar që në rast të fajësimit të organeve shtetërore dukuria e helmimeve të shpjegohej me gjendje hipnoide. Sipas fjalorit psikologjik, për gjendjen hipnoide thuhet:

Dominon mendimi se të gjitha histeritë pak a shumë janë hipnoide. Gjendje hipnoide me elemente histeroide në sjellje mund të paraqiten edhe në kontekstin e gjerë shoqëror, kryesisht në forma të fshehura, por jo edhe përherë në forma të lehta dhe me raporte eventuale psikotike ndaj realitetit. Në situatë stresi nën veprime të prekshme represive ndaj popullit shqiptar, me siguri gjatë helmimeve kanë pasur ndikim edhe gjendjet e këtilla hipnoide, të cilat kanë diktuar që numri i qytetarëve me induksione psikoreaktive të jetë më i madh, duke u nisur nga distribuimi normal, pasi që edhe neurozat psikoreaktive i nënshtrohen kësaj shkapërderdhjeje - distribuimi i sasive të neurozave konversive në rrethanat normale mund të silltet prej 1-5 për qind nga numri i përgjithshëm. Në situatën konkrete numri i induksioneve do të ishte prej 74-370 veta.

Në situatën, në të cilën është bërë helmimi, nga numri i rasteve të evidencuara të helmimit me induksione psikoreaktive prej

13.72% për qind, do të mund të silleshin rreth 1000 apo konkretisht 994 individë. Rastet e tjera nuk mund të arsyetohen me induksion psikoreaktiv apo me neuroza konversive. Në mesin e tyre rastet më drastike janë vdekja e dy vajzave dhe e një të riu shqiptar, *Vesel Demi*, të të helmuarve: *Ljamie Kadriut* dhe *Arlinda Vllasakut*. Në vërtetimin për vdekjen e *Arlinda Vllasakut*, (1977-1993), nga Podujeva, me LN. nr. 77105, me numrin personal 12911977919924, të dhënë nga SPB, rruga, K. Ivana nr.156, sa i

 СОЦИЈАЛИСТИЧКА ФЕДЕРАТИВНА РЕПУБЛИКА ЈУГОСЛАВИЈА СОЦИЈАЛИСТИЧКА РЕПУБЛИКА СРБИЈА		  2911977919924 (ЛИЧНИ БРОЈ)	
ПОДУЈЕВО (ОПШТИНА)		К. Ивана бр. 156	
АРИЛДИНА (ИМЕ)		Подујево (ПРЕБИВАЊЕ И АДРЕСА СТАНИ)	
ВЛАСАКУ (ПРЕБИМЕ)		10. год.	
Бајрам (ИМЕ ЈЕДИНОГ ОД ПРАРОДИКА)		77105 (ГРОБНИ БРОЈ)	
29.11.1977. год. (ДАН-МЕСЕЦ И ГОДИНА РОЂЕЊА)		07.1993 (ГРОБНИ БРОЈ)	
Подујево, Подујево (МЕСТО РОЂЕЊА, ОПШТИНА, ВОКРЕЊЕЊА И РЕПУБЛИКА)		 СР08200932	
АПКМ Р Србија (ОБНАМА КРМЕ ГРУПЕ)		СР08200932	

Letërnjoftimi i Arlinda Vllasakut, e cila vdiq nga pasojat e helmimit

përket sëmundjes apo gjendjes, e cila drejtpërsëdrejti ka shkaktuar vdekjen, thuhet: "*Fëmija është shëruar nga helmimi*"; shkas i vdekjes thuhet: "*Fëmija ka vuajtur nga helmimi*". Ndër gjëra të tjera me rëndësi, që kanë mundur të sjellin vdekjen, por që nuk kanë të bëjnë me shkaktarin kryesor të vdekjes thuhet: "*Prindi*

thotë se fëmija, pos sëmundjes nga helmimi nuk ka qenë më parë i sëmurë nga asnjë sëmundje". Sa i përket kohëzgjatjes nga fillimi i sëmundjes deri në vdekje, sipas deklaratës së prindit del se fëmija është helmuar më 1990, ndërsa herën e fundit sëmundja ka zgjatur gjithsej 20 ditë. Arlinda vdiq më 29 tetor 1993, në Podujevë në orën 16 e 15 minuta (shih fotokopjen e lejes së njoftimit).

Struktura heterogjene e viktimave të helmimit, sipas përkatësisë kombëtare, moshave etj., tregon se nuk mund të flitet për histori kolektive. Po ashtu, kohëzgjatja e helmeve të hedhura, kalendari i ri i helmimit, testimi i helmimit etj., tregojnë se nuk mund të flitet për induksione psikoreaktive për tërë popullatën e viktimave të përfshira në helmime.

Në faksimil shihet se prej datës 23-26 mars të vitit 1990 numri i të helmuarve shtohet prej 87 në 160. Brenda këtyre ditëve, prej 19-26 mars, që do të thotë vetëm për shtatë ditë, nëpër klinikat e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë kanë kaluar rreth 1600 pacientë. Në këtë faksimil vërehet edhe një moment karakteristik për mjetet e informimit në gjuhën serbe. Këto nuk mund të lirohen nga vlerësimet politike. Ato, përkundër dëshmimeve evidente që dalin nga simptomat siç janë: dhëmbjet e mëdha në kokë, stomak, pengesat në frymëmarrje, temperaturat e larta, shtrëngimet dhe ngërçet e ekstremiteteve, deklaratat e mjekëve, më shumë bren-gosen pse nxënësit shqiptarë nuk e njohin gjuhën serbokroate, pse dy pacientë rrinë dy ditë të shtrirë në shtretër me jakne "jeans", sesa për shëndetin e tyre. Në kundërshtim me këto qëndrime, korrespondenti Shefki Ukaj në "*Veçernji list*" në të njëjtën faqe, pra për të njëjtën gazetë raporton në mënyrë objektive duke thënë: "*Në poliklinikat e Prishtinës dje u shënua një numër më i vogël i pacientëve të sëmurë në bazë nervore vegetative. U informuam se u lirua një numër i konsiderueshëm i të sëmurëve*".

Në mjetet serbe të informimit, në takimet e ekspertëve, vlerësimet ndryshojnë me nuancime të reja, të cilat janë në funksion të politikës së ditës. Kështu, në takimin e ekspertëve të KSBE-së mbi pakicat kombëtare në Gjenevë, e cila u mbajt prej 1-19 korrik të vitit 1991, Miodrag Perishiq, ministër i informatave në qeverinë e Milan Paniqit (ishte në krye të delegacionit të së ashtuquajturës Jugosllavi) lidhur me helmimin e rinisë shkollore tha: *"Edhe fëmijët janë viktima sipas një koncepti familjar. Ata shtrëngohen t'i përmbushin urdhrat verbërisht, madje edhe në çështjet e përgënjeshtrove flagrante politike në kundërshtim me të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare. Shembulli i shkëlqyeshëm i një përgënjeshtrimi të këtillë ishte helmimi i rremë në fillim të këtij viti. Duke u munduar ta bindin komunitetin ndërkombëtar mbi karakterin kriminal të autoriteteve serbe, liderët nacionalë shqiptarë keqpërdorën disa mijëra fëmijë"* (30:8).

Ky është një shembull i shkëlqyeshëm i konstruksioneve morbide politike në funksion të ideve nazifashiste, është ky një cinizëm i pashoq dhe jonjerëzor, një mendim satanik dhe morbid me porosi të theksuara gjenocide, të paraqitura në një takim ndërkombëtar para ekspertëve për të drejtat dhe liritë e njeriut. Në këta pak rreshta të cituar implikohet tërë filozofia e urrejtjes së serbëve ndaj shqiptarëve.

Ministrit Perishiq nuk i intereson e vërteta për helmimin e rinisë së Kosovës, e cila në atë kohë, kur ngjau kjo vepër barbare, ishte dhe bënte pjesë shteti jugosllav, kontinuitin e të cilit, me çdo kusht don ta vazhdojnë z. Perishiq, Milosheviq, Qosiq, Paniq e të gjithë të tjerët, të cilët pas kontinuitetit të Jugosllavisë e mendojnë Serbinë e Madhe, në të cilën do të jenë edhe territoret shqiptare pa apo me shumë a pak shqiptarë. Në këtë shtet shqiptarët do të vriteshin siç u vranë dhe po vriten sot, do të helmohen siç u

helmuan më 1987-1990, do të ndiqen e persekutohen, siç janë ndjekur dhe persekutuar në të kaluarën dhe si po ndiqen e persekutohen sot, e këta gjatë tërë kohës do të trumbetojnë për të drejtat dhe liritë që shqiptarët i kanë gëzuar, i gëzojnë dhe do t'i gëzojnë në Jugosllavinë e ardhshme (Serbia e zgjeruar). Logjika e ish - ministrit Perishiq është në vijën e ultranacionalistëve serbë, logjika e të cilëve është "*shqiptari i ndershëm*" analfabet, pa ndjenjë dhe krenari kombëtare, në kuptimin më të mirë të pozitës së tij. Ky qëndrim i z. Perishiqit pak dallon nga akterët e helmimit për të cilët "*shqiptar i mirë është shqiptari i vdekur*". Analiza sipërfaqësore e mendimeve, e gënjeshtreve, e shpifjeve, falsifikimeve dhe e të pavërtetave të fabrikuara z. Perishiqin e vë në mesin e epigonëve dhe të tratatëve të sjelljeve dhe të mendimeve gjenocide mbi dhe për shqiptarët.

Sikur z. Perishiqit t'i interesonte e vërteta për helmimet si nga posti dhe detyra që kishte, për shkak të takimit në të cilin duhej ta prezentonte të vërtetën për pozitën e shqiptarëve në "shtetin e tij" ai do të kërkonte informacion plotësues dhe objektiv si për pozitën e përgjithshme të shqiptarëve si në ish- -Jugosllavi, ashtu edhe në "Jugosllavinë e tashme" dhe në Kosovë, do të gjurmonte të vërtetën për helmimet e shkollarëve shqiptarë kosovarë, do t'i shpalonte sekretet ushtarake të Gjeneralshtabit të ish - Jugosllavisë, apo të sigurimit shtetëror të Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme, do të pyeste prindërit e *Igor Gashiqit*, do të pyeste për gjendjen e *Mara Gjuroviqit*, e helmuar serbe nga Fushë Kosova, do të bisedonte me prindërit e viktimave të helmimit, të *Ljamie Kadriut* dhe të *Arlinda Vllasakut*, të cilat vdiqën nga pasojat e helmimeve dhe të helmeve kimike të luftës. Ky ka mundur të bisedojë me cilindo nga lista prej 7.421 (25:73) viktimave të helmimeve, ka mundur të konsultojë histerinë e mbi 6.000 vetave,

të cilët kishin kërkuar ndihmë në stacionet, në klinikat dhe në ambulancat shëndetësore. Ka mundur të bisedojë me motrat e nderit të Kishës katolike në Ferizaj dhe në Binçë. Ky ka pasur mundësi të kërkojë shpjegime pse policia në kohën kur helmoheshin qytetarët kosovarë bëri bastisje në Kishën katolike në Ferizaj dhe në atë rast i mori të gjitha barnat, të cilat, në mënyrë legale, me lejen e Këshillit Federativ të ish-Jugosllavisë i kishte importuar nga jashtë. Nëse shqiptarët verbërisht u binden urdhrave, siç pohon Z. Perishiq, si qe e mundur që këtyre urdhrave "të liderëve nacionalë shqiptarë" t'u binden fëmijët, nxënësit, të rinjtë, të vjetrit dhe policët nga radha e serbëve, malazezve, turqve, myslimanëve dhe të romëve? A mund ta shpjegojë z. Perishiq se si qe e mundur që edhe milicët serbë "t'u binden urdhrave të liderëve nacionalë shqiptarë".

Sikur z. Perishiq të dëshironte të punonte sipas parimeve të demokracisë dhe të humanizmit, ai në vend që të villte kundër shqiptarëve në takimin e ekspertëve eminentë në Gjenevë, do të dilte me të vërtetën për helmimet dhe për të gjitha format e represionit dhe të terrorit shtetëror që ushtrohet mbi shqiptarët edhe në kohën dhe për kohën kur ai ishte ministër i informatave (vrasjet, plagosjet, rrahjet masive, bastisjet e shtëpive shqiptare, armatimi i serbëve dhe maltretimi i shqiptarëve me pretekst të kërkimit të armëve, rekrutimi me dhunë i shqiptarëve, mbyllja e shkollave, e institucioneve të arsimit, përjashtimi nga puna e nga banesat, plaçkitjet masive, burgosjet, ndjekjet penale izolimet etj).

Sikur të ekzistonte arsyeja e jo logjika e krimit, e ekspansionit, e dhunës, e dominimit të një populli mbi popujt e tjerë, të mos ishte politika egocentrike serbe e ushqyer me urrejtje, ksenofobi dhe animozitete të tjera, nuk do të ndodhte ky masakër që po ndodh në Ballkan, nuk do të derdhej gjithë ky gjak, nuk do të bëheshin gjithë

ato dhunime, të gjitha ato masakrime shtazarake dhe bizare. Ballkani do të ishte i qetë, ndërsa banorët e tij do të ishin të lumtur. Duke u nisur nga këto argumente z. Perishiq është mirë që për hir të së vërtetës t'i vërtetojë fjalët e Stipe Mesiqit, i cili publikisht deklaroi se helmet, të cilat u përdorën në Kosovë u siguruan në Çekosllovakia; do të pyeste se kush e bëri kontratën, kush dhe kur i importoi këto helme, çfarë ishin ato, kush i hodhi në Kosovë dhe për çfarë qëllimesh.

Nga posti që ka pasur, ky, jemi të bindur se të gjitha këto duhej t'i dinte, mirëpo edhe ky i mohon dhe gënjen për qëllime "patriotike" serbe.

Në aspektin e shumë të "vërtetave" serbe për helmimet e kemi edhe një "të vërtetë" për gjoja "HELMIMIN NJËNACIONAL". Kur serbët e panë se helmimet nuk mund të fshihen as si "teatrim kolektiv", e as si "histeri masive", mjetet e informimit në gjuhën serbe dhe masmediumet e japin edhe një vlerësim të padefinuar, të përgjithësuar dhe shumëkuptimor. Ky vlerësim filloi të plasohet në vitin 1991, në kohën kur në skenë dolën shumë argumente për ekzistimin e helmimeve. Ishte ky një vlerësim "diplomatik", pas të cilit mund të shtroheshin shumë pyetje, e para së gjithash vlerësimi i tillë linte mundësi të kuptohet se helmimet gjoja u bënë vetëm në popullatën shqiptare, se gjoja u bënë për qëllime separatiste, për të lënë mundësinë që të kuptohen si vepër e vetë shqiptarëve për ta diskredituar "politikën e drejtë serbe".

Nga kjo e "vërtetë" krijohen kushtet edhe për një involim të procesit të helmimeve. Kështu, në simpoziumet "shkencore", të cilat organizohen në institucionet shkencore dhe profesionale gjithnjë e më tepër plasohet mendimi se helmimet i bënë shqiptarët për "qëllime të larta". Këtu mendohet në ligjërata dhe kumtesa për gjenocidin, të cilat i organizoi Bashkësia e Kulturës e Beogradit

(1991), këshillimet e Akademisë Serbe të Shkencave (1992), në temën "Gjenocidi i luftës" etj. Në kumtesat dhe referatat e paraqitura flitet edhe për gjenocidin e shqiptarëve mbi serbët. Kështu në vitin 1993, në publikimet e materialeve nga simpoziumet, këshillimet dhe ligjëratat e mbajtura konstatohet se *"të gjitha kërkesat, memorandumet dhe aksionet në organizimin e separatizmit "shkencërisht" u inicuan dhe iu dorëzuan "bashibuzukëve" që t'i realizojnë, duke shkatërruar përmendoret, duke dhunuar vajzat dhe plakat, duke vrarë në prag të shtëpive, duke helmuar rininë e vet në emër të qëllimeve të larta dhe duke bërë veprime të tjera etnocide dhe gjenocide. Por, për këto veprime nuk janë përgjegjës vetëm shqiptarët, por edhe serbët, të cilët në të gjitha këto kanë marrë pjesë dhe kanë marrë për këtë shpërblime dhe dhurata për "suksese" të arritura në "Kosmet"*.

Të gjitha këto gënjeshtër që këtu përmenden si vlerësime janë të cituara nga vepra e prof.dr. Gjorgje Lekiqit (28:46). Me këtë rast këtu do të ndalemi në fenomenin e helmimeve. Ky nuk i konteston helmimet. Në të vërtetë ky e pranon se ka pasur helmime. Ky ishte në Kosovë, ka pasur rast të drejtpërdrejtë t'i shohë skenat trishtuese. Duke u ballafaquar me argumente të pamohueshme, ky fajin në mënyrë të paturpshme ua hedh shqiptarëve. Do theksuar se vlerësime të këtilla pat publikuar edhe gazeta serbe *"Jedinstvo"*, që del në Prishtinë. Ajo më datën 7 gusht 1990, në f. 10 e pranon se kishte helmim të të rinjve dhe të qytetarëve në Kosovë, por, sipas saj, këtë helmim gjoja e kanë bërë persona klerikë të kishës katolike. Një vlerësim të këtillë e jep edhe gazeta *"Politika"* e Beogradit më 8 gusht të vitit 1990 duke gënjyer se në kishën katolike janë gjetur qindra kilogramë barna dhe material sanitar. Aluzioni është se helmimin e ka bërë kisha katolike në Ferizaj për qëllime separatiste (33:71). Për helmimin e të rinjve akuzohet

edhe Bernar Benedeti. Ky lidhur me këtë në intervistën dhënë "Zërit", revistë javore politike shqiptare, thotë: "*kur u largova prej Kosovës, gazeta ditore serbe "Politika" kishte botuar një artikull ku thuhej që isha anëtar i një organizate shqiptare që e kishte selinë në Gjenevë e që ishte një organizatë terroriste që sillte barna për t'i helmuar fëmijët*" (21:19). Mirëpo, kjo metodë që gjenocidin që e bëjnë vetë serbët t'ua hedhin të tjerëve tani është e njohur, veçmas pas luftës në Bosnjë. Me fjalë të tjera, serbët, atë që vetë i bëjnë veprat e tilla me një propagandë të furishme, përpiqen t'ua mveshin të tjerëve, në radhë të parë viktimave që i shkaktajnë. Edhe pse këtë nuk ka nevojë ta komentojmë, është e domosdoshme të konstatohet se një gjë të tillë ka mundësi ta bëjë vetëm shteti, e shqiptarët e Kosovës, siç dihet, këtë nuk e kishin në vitin 1990.

E vërteta ndërkombëtare për helmimet

Në arenën ndërkombëtare, edhe pse gjatë tërë kohës sa bëhej helmimi, nuk arrinin informacione lidhur me këtë ngjarje. Veçmas diaspora shqiptare, qytetarët e Kosovës, të cilët përkohësisht punonin jashtë, ishin të shqetësuar shumë, meqë fëmijët e tyre jetonin dhe shkolloheshin në Kosovë. Helmimi u regjistrua edhe në shirita filmikë përmes videokasetave. Shumë fëmijë të punëtorëve shqiptarë, që punojnë jashtë atdheut u helmuan. Një pjesë e tyre u mjekua në klinikat e Zvicrës, Francës dhe të qyteteve të ndryshme të Gjermanisë.

Përkundër informacioneve të këtilla, qeveritë e shteteve perëndimore, nuk reagonin ndaj kësaj vepre. Ngjashëm u sollën edhe organizatat dhe organizmat ndërkombëtarë, ekspertët e ndryshëm të KSBE-së. Kjo, siç u tha, ndodhi kryesisht për shkak të bllokadës informative, censurimit të materialeve të helmimeve dhe

ndalimit të publikimit të dukumenteve, me të cilat dëshmoheshin helmimet, por ndoshta edhe "skandali ndërkombëtar".

Represioni policor, burgosja e tre mjekëve dhe izolimi i dy të tjerëve, marrja në biseda informative e shumë profesorëve dhe qytetarëve si dhe maltretimi i tyre në stacionet e policisë krijojnë psikozën e frikës, kështu që udhëheqësit e atëhershëm shqiptarë dhe ekspertët e ndryshëm nuk guxonin që në mënyrë decidive t'i thoshin dhe t'i publikonin dëshmitë dhe materialet për helmime. Mostrat e gjakut, të cilat dr. Benedet dhe dr. A. Dolenc i dërguan në Lubjanë për analizë, qenë vjedhur dhe kjo po ashtu ndikoi që e vërteta për helmimet të mos depërtojë shpejt në arenën ndërkombëtare.

Gazetat botërore dhe mjetet e tjera informative raportnin se në Kosovë po ndodhte diçka që u përngjet helmimeve, por propaganda e furishme serbe këto i "demantonte" dhe helmimet mbështilleshin me velin e misteriozitetit. Të gjitha këto bënë që zonja Kristin Fon Koll helmimet t'i quajë "afërë" dhe këtë ta vërë nën thonjëza. Zonjës Koll shqiptarët i janë mirënjohës për punën e saj të madhe në plasimin e së vërtetës për dhunën serbe mbi shqiptarët, për lotët e saj që i derdhi në Podujevë me rastin e mbylljes së dy shkollave shqipe në këtë qytet, për punën e saj të pakursyer si veprimtare e palodhur në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, për kontributin e saj në botimin e veprës së saj "*Kosova nyjë e Gordiut e Ballkanit*" edhe pse në të, pjesa historike, nuk përkon me realitetin shkencor, sepse është shkruar kryesisht në mbështetje të burimeve të njëanshme dhe të falsifikuara të histriografisë serbe: (por këta autorë nuk kanë të drejtë që helmimet t'i quajnë afërë).

Helmimet nuk mund të quhen afërë (është prekëse, veçmas pse një gjë e tillë vjen nga zonja Kristinë Fon Koll) dhe nuk mund të

vihet nën thonjëza. Duke e ditur luftën e saj të madhe dhe të palodhur që bëri në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive elementare të njeriut, jemi të prirur të besojmë se një vlerësim të tillë e jep për shkak të mungesës së informacioneve dhe të ngathtësisë e të punës së pamjaftueshme të vetë shqiptarëve në plasimin efektiv e efikas të së vërtetës së mirëfilltë e të dokumentuar.

Me kalimin e kohës, me grumbullimin e të dhënave, me analizat laboratorike, me studimin e dokumentacionit, me shikimin e incizimeve filmike, në arenën ndërkombëtare dalngadalë, por në mënyrë objektive filloi të dalë e vërteta për helmimet në Kosovë. Kështu, A. May dhe J. Foran në raportin e tyre "*Jugosllavi: helmime apo epidemi histerie në Kosovë*" (Lamcet 1991;338:1197) përmendin 3.000 pacientë duke thënë se disa prej pacientëve nga dy mjekë të ekipit të tyre ndërkombëtar "*s'ishin në gjendje të vetëdijshme, me sy të skuqur, hipertoni, me refleksë të ngadalësuarra dhe me ndjeshmëri të zvogëluar ndaj dhembjeve*".

Dr. Bernar Benedeti...solli mostra të gjakut të fëmijëve nga Kosova dhe i dha për analizë në dy laboratorë të Parisit. Në të dy vendet u zbuluan molekula kloroorganike. Ky më tutje thotë: "*Ky krim është bërë nga agjentët e Beogradit, me siguri agjentë ushtarakë*" (5:22). Publikimin e këtyre dokumeteve e ka ndaluar censura jugosllave (shih. faksimilin).

Përafërsisht rezultate të njëjta nxjerr edhe A. Heyndrickx, ekspert për shkencat toksikologjike dhe të ambientit, drejtor i Labororit Ndërkombëtar të Universitetit (IRUL). Më 8 shkurt 1992, në tekstin me titull "*Çka ka të bëjë me Kosovën*", ai i jep konstatimet në bazë të studimeve të raporteve mjekësore të bëra nga shkencëtarët e njohur ndërkombëtarë jashtë Jugosllavisë dhe të shënimeve të tyre nga vendi i ngjarjes, të raporteve të misioneve

të ndryshme si dhe të analizave shkencore toksikologjike të gjakut dhe të urinës të personave të helmuar të të gjitha moshave.

KONKLUDOJMË:

**SE ËSHTË PËRDORUR NJË GAS NERVOR ORGANIKO-KIMIK,
SARIN dhe TABUN QË NJIHEN SI MATERIE KIMIKO-LUFTARAKE**

Prof. A. Heyndrickx

Drejtor IRUL

8 shkurt 1992

PËRFUNDIM

Teza e shqiptarëve të Kosovës, e dëshmuar me një mori dokumentesh të vërtetuara nga autoritete të besueshme mjekësore se në fund të marsit 1990 janë përdorur materie kimike kundër nxënësve, studentëve dhe punëtorëve kryesisht shqiptarë, për ne është më e pranueshme se çfarëdo tezë tjetër.

Nuk ekziston asnjë argument i natyrës mjekësore, i cili vërteton se helmimi mund të ketë qenë teatralizim apo diç e ngjashme.

Kur është fjala për një çështje kaq me rëndësi vetëm argumentet shkencore dhe dëshmitë e bëra nga profesionistë të besueshëm mund të jenë të pranueshme.

"Kërkojmë, thotë më tutje prof. dr. A. Heyndrickx, që në Kosovë të dërgohet një mision i ekspertëve me autorizim të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, një Nënkomision për parandalim dhe mbrojtjen e minoriteteve nga diskriminimi, për t'i vlerësuar të gjitha të dhënat dhe për të biseduar me të gjithë dëshmitarët".

Siç u konstatua më parë, në janar të vitit 1993, në Konferencën ndërkombëtare, të mbajtur në Paris në temën *Helmet kimiko -biologjike të luftës*, prof. A. Heyndrickx thotë: *"Më 1990 u zbuluan gaze nerotoksike, të cilat i përdorën serbët kundër fëmijëve në çerdhe në Kosovë"*. Kjo është e vërteta ndërkombëtare për helmimet e qytetarëve të Kosovës, kryesisht shqiptarë.

Nga analiza komparative e vlerësimeve të ndryshme, studimi i dokumentacionit që ka të bëjë me helmimet, nga studimi i listës prej 7421 individëve qoftë të helmuar qoftë me reaksione koversive, apo me induksion psikoreaktiv, në mënyrë të pakontestueshme mund të konkludohet se helmi i viteve 1987 - 1989 (Gjilan, Klinë dhe Prizren), dhe i vitit 1990, në Kosovë, u bë me helme kimike të luftës nga agjentë sekretë ushtarakë të ish-Jugosllavisë. Nga ai helmim edhe sot vuajnë një numër i madh i viktimave, ndërsa nga helmet jetën e humbën dy të reja shqiptare: *Ljamie Kadriu* (1974-1991), nga Mitrovica, dhe *Arlinda Vllasaku* (1977-1993) nga Podujeva dhe një i ri shqiptar nga Gjilani, *Vesel Demi*. Në bazë të të gjitha të dhënave ngjarja e vitit 1990 nuk mund të shpjegohet si histeri e përgjithshme e as si simulim, por vetëm si helmim i popullatës shqiptare, kryesisht të nxënësve.

Helmimi i nxënësve, studentëve, i fëmijëve dhe i qytetarëve të tjerë të Kosovës, sipas fakteve të njohura, u bë në bazë të një skenari të përgatitur dhe të operacionalizuar deri në detaje. Helmimet kaluan një rrugë të gjatë prej përpunimit teorik, të aksionit të paraqitur në një dokument deri te segregacioni dhe aparteidi.

PREJ APARTEIDIT NË HELMIM

Kishte apo nuk kishte skenar për helmimin?

Është më se e sigurt se helmimet u bënë në bazë të një skenari tepër sekret. Ky parashikonte që helmimet të kalojnë në disa etapa. Procesit të helmimeve i parapriu një përgatitje solide. Sipas të gjitha gjasave skenari për helmimet e ka formën e një elaborati të detajizuar. Ky elaborat paraqet sekret shtetëror, dhe gjasat për publikimin e tij sot janë shumë të vogla. Ndoshta pas disa dekadave do të publikohet ose do të gjendet nëpër arkiva ushtarake, siç qe rasti me elaboratet e tjera fashisoide për shpërnguljen (lexo: shfarosjen e shqiptarëve) të Vasa Qubriloviçit, Ilija Garashaninit, Ivo Andriçit, Ivan Vukotiqit etj. Lidhur me këtë, shtrohet pyetja si qe e mundur që elaborati për helmimet të përgatitet në detaje e në opinion të mos rrjedhë asnjë informacion. Kjo mund të shpjegohet se në të punuan ekspertë me qëndrime ultranacionalisteshoviniste dhe me orientime antishqiptare. Këta njerëz bënë që skenari për helmimet të përgatitet në konspiracion të thellë dhe për të në opinion të mos dihet asgjë. Me skenar deri në detaje janë parashikuar: kalendari i helmimeve, vendet, shpenzimet, propaganda, hedhësit e helmeve, instruktorët, kursi për aftësimin e hedhësve të helmeve etj. Të gjitha këto bënë që helmimet një kohë të gjatë të jenë nën mbulojën e misteriozitetit. Dëshmia e Stipe Mesiqit, kryetar i Kryesisë së ish-Jugosllavisë, i cili thotë: "*Pos*

armëve, në Çekosllovakia u siguruan edhe sasi të mëdha të helmeve të rrezikshme, të cilat u shfrytëzuan më parë mbi popullsinë shqiptare në Kosovë" (më 27 shtator 1991 në Washington D.C) ishte dëshmia e parë zyrtare jugosllave.

Sipas të gjithë gjasave me elaborat ishte parashikuar që përgatitja dhe zbatimi i helmimeve të kalojë nëpër këto etapa:

- elaborimi i procesit të helmimeve,
- mbrojtja dhe sigurimi i popullatës joshqiptare nga helmimet,
- prova dhe testimi eksperimental i helmeve,
- relativizimi i helmimeve.

Këto etapa janë identifikuar duke bërë rikonstruktimin e procesit të helmimeve dhe të studimit të aktiviteteve të ndërmarra para, gjatë apo pas helmimeve.

Aparteidi - instrument i mbrojtjes së popullatës joshqiptare nga helmimet

Një prej problemeve më të mëdha, me të cilin u ballafaquan akterët e helmimeve ishte çështja e sigurimit të popullatës sllave dhe joshqiptare nga helmimet. Nuk kishte shumë zgjidhje optimale. Bile e vetmja zgjidhje ishte ndarja e nxënësve, fëmijëve dhe e studentëve serbo-malazez dhe joshqiptarë nga shqiptarët. Duhej të zbatohej ndarja e nxënësve, fëmijëve dhe e studentëve, në gjuhën serbe në objekte, ndërtesa dhe kate të veçanta. Natyrisht nuk ishte lehtë që kjo kërkesë të shtrohet dhe të realizohet. E para ishte në kundërshtim të plotë me parimin e përbashkësisë dhe të "*vël-lazërim-bashkimit*", që trumbetohej 50 vjet me radhë. Duhej gjetur arsyen "*bindëse*" për realizimin e një kërkesë të këtillë, e cila ishte në kundërshtim të plotë me të gjitha proklamimet politike për "*barazinë në arsim*". Po ashtu me këtë kërkesë duhej siguruar që

nxënësit me mësim në gjuhën serbokroate, në mbështetje të ndarjes në baza etnike dhe të prejardhjes nacionale, të kenë përparësi sa i përket zgjedhjes së kushteve të punës (godinave, ndërtesave dhe kateve). Me zbatimin e kësaj kërkesë në Kosovë u aplikua diskriminimi racor, përkatësisht segregacioni. Kreatorët e elaboratit, në bazë të analizës detaje, erdhën në përfundim se për të arsyetuar ndarjen duhet të merren parasysh këta faktorë:

Të shpifet "rreziku" i nxënësve serbomalazez nga shqiptarët dhe nga "albanizimi" i vendbanimeve të pastra etnike serbe.

Natyrisht këto ishin të pavërteta, të cilat duhej prezentuar si të vërteta para faktorit ndërkombëtar për të arsyetuar veprimin që ishte në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave ishte edhe ish-Jugosllavia dhe për të thyer rezistencën e shqiptarëve ndaj këtyre shkeljeve flagrante të të drejtave dhe lirive elementare. Për këtë qëllim u vunë në veprim lëvizjet masive populiste, mitingjet e dirigjuara nga Beogradi, protestat, demonstratat e paguara etj., nënshkrimi i peticioneve, bojkotimi i mësimin, inskenimet e ndryshme, kualifikimet false, gënjeshttrat dhe fotomontazhat. Pos arsyetimit të kërkesave të këtilla, gënjeshttrat për gjoja rrezikun e nxënësve me mësim në gjuhën serbokroate dhe për gjoja "albanizimin" e dhunshëm të fshatrave të pastra etnike kishin për qëllim edhe justifikimin e masave barbare serbe kundër popullatës shqiptare dhe përgatitjet për zbatimin praktik të helmimeve.

Kush ishin të rrezikuarit

Në kuadër të dhunës së programuar serbe ishte planifikuar edhe dhuna në arsim, e cila kishte për qëllim rrënimin e arsimit si një etapë drejt pacifikimit të Kosovës, qoftë përmes asimilimit dhe të

shkombëtarizimit, qoftë përmes dëbimit të shqiptarëve ose përmes kolonizimit të dhunshëm të Kosovës me serbë, qoftë përmes vrasjeve, helmimeve etj. Me qëllim të shpejtimit të këtij procesi në praktikë pothuaj u zbatuan të gjitha format e dhunës duke përfshirë këtu edhe fenomenin e psikozës së frikës përmes represionit policor: bisedave informative, rrahjeve në stacionet e policisë, bastisjeve në shtëpi, rrahjeve me rastin e bastisjeve para anëtarëve të familjes, rekrutimit me dhunë të të rinjve shqiptarë, përjashtimeve nga puna, izolimeve, burgosjeve, ndjekjeve penale etj. Ndaj nxënësve shqiptarë merreshin të gjitha këto masa: përjashtoheshin nga shkolla edhe nxënësit e shkollës fillore, ndalohej regjistrimi i nxënësve nëpër shkolla të mesme dhe në fakultete etj. Vetëm nga viti 1981 deri në vitin 1985 nga shkolla fillore dhe e mesme u përjashtuan 1015 nxënës dhe 298 arsimtarë shqiptarë për shkak të "nacionalizmit" (14:110). Në Universitetin e Prishtinës nuk mundën të regjistroheshin 1.820 studentë shqiptarë për shkak të bindjeve të tyre politike. Nxënësit dhe studentët shqiptarë ishin ata që pësonin si nga nxënësit serbë ashtu edhe nga policia serbe. Andaj, fare nuk mund të flitej për rrezikimin e serbëve. Derisa në Kosovë nuk kishte asnjë rast të lëndimit dhe të rrahjes së fëmijëve, nxënësve dhe të rinjve serbo-malazez nga ana e shqiptarëve, fëmijët shqiptarë pësonin pandërprerë dhe në kontinuitet nga fëmijët serbomalazez. Sa për ilustrim po përmendim vetëm disa raste.

Në Pozharevc djali shtatëvjeçar me emrin Burim, theret në sy, kryesit e krimit nuk u zbuluan, rasti dy muaj fshihet, ndërsa vetë krimi, si e vëren Shpiro Galoviqi, nxit asociacione në thikën çetnike (shkruan "Politika" e Beogradit, më 17 tetor 1987, fq.16).

Në fshatin Zhur, më 28 mars 1989, policia serbe organizon një masakër të vërtetë mbi shkollarët e këtij fshati. *"Atë ditë... në Zhur vjen një autobus përplot milicë të njësisë speciale të Serbisë dhe*



FËMIJËT SHQIPTARË, VIKTIMA TË
REPRESIONIT TË PUSHTETIT SERB NË
KOSOVË

NJË GJENERATË PA BUZËQESHJE

Në Kosovë, në dekadën e fundit e veçmas ndërmjet viteve 1989-92, u vrarë 18, kurse u plagosën 48 fëmijë shqiptarë. Vrasjet e bëra nga serbët kualifikohen si vrasje «nga pakujdesia» ose dorasit janë «të mitura».



Dëshmi se cili nacionalitet në Kosovë ka qenë i rrezikuar

me të hyrë në fshat njëri nga prijësit urdhëron të shtihet në masë me armë zjarri. Në Zhur filloi masakra e paparë. U vranë Xhymshit dhe Gjylbehar Badallaj, të lindur me 1964, përkatësisht 1966 (fëmijë të dy vëllezërve) dhe Hajrim Badallaj i lindur më 1976, nxënës i klasës VI. Nga plumbat e milicisë u plagosën rreth 30 veta, prej të cilëve disa mbetën invalidë të përjetshëm" ("Bujku" më 22 mars, 1992).

Masakra e 28 marsit të vitit 1989 nuk ishte vepra e fundit e milicisë serbe. Ende pa u tharë mirë gjaku i atyre shpitrave të njomë, që ranë viktimë e një politike të çoroditur serbosllave, në Zhur filloi ndjekja e disa personave, për të cilët kinse dyshohej se i kishin organizuar dhe kishin marrë pjesë në ngjarjet e 28 marsit... Vetëm disa ditë pasi kishte ndodhur ajo më e keqja në këtë fshat, milicia arreston Reshat Badallajn, Elmaz Susurin, Rexhep Badallajn, Iliaz Susurin dhe Mërxfan Badallajn. Në gjykimin e shpallur më 22 dhjetor të vitit 1989, Gjykata e Qarkut në Prizren Reshat Badallajn e dënon me 8 vjet burg, Elmaz Susurin me 7 vjet, Rexhep Badallajn me 6 vjet, Iliaz Susurin me 6 vjet burg dhe Mërxfan Badallajn me 8 muaj burg.

Lidhur me masakrën e Zhurit Reshat Badallaj, i dënuari i parë thotë: "Arrestimi dhe burgosja jonë u bënë me qëllim që të fshihen gjurmët e masakrës në Zhur, që bëri policia serbe dhe në një mënyrë që të arsyetohen krimet e bëra mbi popullin e pafajshëm", (kështu shkruan "Bujku" i datës 26 mars 1991).

Pa u mbushur një vit, në shkollën fillore "Boro e Ramizi" në Zhur u krye edhe një vepër gjenocide, u helmuan nxënësit dhe 5 arsimtarë të shkollës.

Se cilët ishin të rrezikuarit tregon edhe ky rast: Afrim Prebreza, fëmijë 9 - vjeçar, të cilin me shkop e mbytën serbët e Kuzminit, lagje serbe afër Fushë-Kosovës (rasti nuk u ndriçua nga organet e

hetuesisë, por u kamuflua me konstatim se këtë e bëri një serb i sëmurë dhe askush nuk u përgjigj për këtë vepër). Po ashtu edhe *Ylfete Humolli* e qindra fëmijë të tjerë shqiptarë qenë viktime të terrorit serb.

Hamide Latifi, gazetare e "*Bujku*" (gazetë e cila bën përpjekje për të ndriçuar errësirën informative pas ndalimit të së vetmës gazetë ditore në gjuhën shqipe "*Rilindja*", ndaljen e së cilës e bëri Kuvendi i Serbisë më 8 gusht 1990), në fejtounin e botuar me titull: "*Fëmijët shqiptarë-viktima të represionit të pushtetit serb*" shkruan: Në Kosovë, në dekadën e fundit, e veçmas ndërmjet viteve 1989-92 u vranë 18, kurse u plagosën 48 fëmijë shqiptarë. Vrasjet e bëra nga serbët kualifikohen si vrasje nga "pakujdesia" ose dorasit janë "të mitur" (shih edhe 4:18-24).

Pasqyra tabelare e fëmijëve të vranë ndërmjet viteve 1989 - 1990

Nr.	Emri dhe mbiemri	Mosha	Vendlindia	Viti i vrasjes
1.	Muharem Kabashi	18	Dushanovë - Prizren	28 mars 1989
2.	Afrim Bytvqi	14	Dushanovë - Prizren	28 mars 1989
3.	Din Paçarizi	11	Dragobil - Malishevë	5 prill 1989
4.	Arsim Paçarizi	11	Dragobil - Malishevë	5 prill 1989
5.	Afrim Badallai	13	Zhur - Prizren	28 mars 1989
6.	Shukrie Obërtinca	16	Prishtinë	27 mars 1989
7.	Bekim Ruzhdi Seidiu	15	Koshare - Ferizai	31 janar 1990
8.	Enver Abdurrahman Ramadani	17	Giilan	28 shkurt 1990
9.	Arsim Abdullah Mazreku	17	Malishevë	30 janar 1990
10.	Ylfete Isa Humolli	17	Podujevë	1 shkurt 1990
11.	Fatmir Hazir Ukai	18	Pejë	27 shkurt 1990

Pohimi serb për gjoja rrezikun e fëmijëve joshqiptarë në përgjithësi dhe të serbëve e të malazezeve në veçanti, nuk mund të qëndrojë edhe për një arsye tjetër. Në rrugë, para dyerve dhe oborreve të shkollave, në korridore dhe kate të shkollave rrinin kordonët e policëve serbë, të agjentëve policorë të armatosur deri në dhëmbë.

Pasqyra tabelare e fëmijëve të plagosur në vitin 1990

Nr.	Emri dhe mbiemri	Mosha	Vendi	Nr.	Emri dhe mbiemri	Mosha	Vendi
1.	Afrim Hvseni	18	Vushtri	21.	Hvsen Abazi	17	Gllgovc
2.	Avni Dvorani	17	Gllgovc	22.	Hafiz Shora	10	Kacanik
3.	Agron Stublla	17	Ferizaj	23.	Hvsen Lipovica	18	Ferizaj
4.	Arif Mazreku	16	Malishevë	24.	Ismet Krasniqi	17	Podujevë
5.	Agron Gashi	15	Pejë	25.	Ibrahim Gashi	17	Krushë
6.	Beitë Rexhepi	18	Gllgovc	26.	Ismet Kaciu	16	Podujevë
7.	Blerim Shabani	15	Pejë	27.	Myfail Ademi	15	Ferizaj
8.	Buiup ?	12	?	28.	Misim Leskovica	18	Ferizaj
9.	Adnan Rarniqi	16	Viti	29.	Mevlude Zogai	14	F. Kosovë
10.	Driton Shaliani	18	Vushtri	30.	Naser Seidiu	17	Viti
11.	Eset Kaciu	15	Podujevë	31.	Naşuf Seidiu	17	Viti
12.	Ekrem Ymeri	18	Viti	32.	Nehat Cerkini	16	Ferizaj
13.	Fazli Jashari	17	Vushtri	33.	Ramush Aliu	18	Viti
14.	Flamur Shala	17	Krushë e M.	34.	Rashit Haliti	12	Ferizaj
15.	Florim Mehmeti	16	Vushtri	35.	Rashit Bvtvoi	15	Ferizaj
16.	Fatmir ?	14		36.	Sadije Laici	18	Pejë
17.	Gëzim Laici	17	Pejë	37.	Sadete Aliu	16	Prishtinë
18.	Gani Kadriaj	14	Lipian	38.	Samit Salihu	18	Viti
19.	Genc Palushi	13	Klinë	39.	Vlora Jakupi	13	Podujevë
20.	Gjon Berisha	14	Pejë				

Gënjeshtat "patriotike" në funksion të vendosjes së apartheidit

Historia e hershme serbe, e vonshmjja, por edhe ngjarjet e sotme, dëshmojnë se për t'i realizuar qëllimet e veta ekspansioniste dhe pushtuese, serbët janë në gjendje të gënjejnë, inskenojnë, falsifikojnë, të helmojnë dhe të vrasin. Vend të rëndësishëm në diplomacinë serbe, bile mund të themi boshtin kurrizor të saj, e zë gënjeshtra. Këtë më së miri e pohon shkrimtari serb Dobrica Qosiq kur thotë: *"Gënjeshtra është formë e patriotizmit tonë dhe dëshmi e inteligjencës sonë natyrore. Ne gënjejmë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive"*.

Rreziku i fëmijëve serbomalazez nga "nacionalistët shqiptarë" "ishte një gënjeshtër patriotike, fantastike dhe kreative" serbe. Me gënjeshtër serbët fshehin krimet, ndihmojnë realizimin e qëllimeve dhe të synimeve e aspiratave politike, i mëshirojnë dhe i bëjnë për vete të tjerët. Gënjeshtër e tyre e përcjellë me qarje, vaj, mimikri bindëse të bën të besosh. Gënjeshtër është alfa dhe omega e propagandës serbe. Gënjeshtër serbe shqiptarëve përherë u ka kushtuar shtrenjtë. Ia pamë sherrin edhe me rastin e helmimit të nxënësve, fëmijëve dhe të qytetarëve të Kosovës. Përmes propagandës gënjeshtër atë shumë zmadhohen, perfeksionohen sa që edhe atyre që vetë i bëjnë u duken si të vërteta. Është ky me të vërtetë një kreativitet fantastik i denjë për studim. Kreacioni në fushën e gënjeshtërve përcillet dhe ndihmohet me një spektër të inskenimeve, fotomontazhave, rekonstruktiveve, falsifikimeve, me propagandë, me presione përmes nxitjes së lëvizjes masive populiste (mitingjeve, protestave, peticioneve, bojkotimeve etj.). Në këtë fushë Gebelsi është pionier, krahasuar me politikanë më minorë serbë. Me qëllim që këto t'i argumentojmë do t'i përmendim katër raste të gënjeshtërve serbe:


E para ka të bëjë me mendimin e prof. dr. Gjorgje Lekiqit kur u thotë "*Të gjitha kërkesat, memorandumet, aksionet në organizimin e separatizmit*" (fjala është për zëvendësim të tezave, sepse projektet për shfarosjen e shqiptarëve i hartuan serbët e jo shqiptarët, si bie fjala, projekti i Ilia Garashaninit i hartuar më 1844, tri elaborate për dëbimin e shqiptarëve të Vasa Qubriloviqit, 1937, 1944 dhe 1945, një i Ivo Andriqit, 1939, një i Ivan Vukotiqit, 1939 (me mbështetje të të cilave dëbuan rreth 800.000 shqiptarë (340.000 mes dy luftërave, 412.000 pas Luftës së Dytë Botërore në vitet e 50-ta e 60-ta), një memorandum (1985), një është në përgatitje e sipër, në mbështetje të të cilëve filloi gjakderdhja në

Ballkan, një Konventë e nënshkruar në Turqi për shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve dhe vendosjen e tyre në shkretëtirën e Anadollit (1938), një program për kolonizim (Programi për kthimin e serbëve dhe malazezve të shpërngulur nga Kosova më 1985) dhjetëra ligje, e para së gjithash, Ligji për kolonizimin e Kosovës 1914, Ligji për reformën agrare, me të cilat ligje shqiptarëve iu morën me dhunë 385.000 hektarë tokë dhe u formuan me dhunë vendbanime me kolonistë të ardhur nga Mali i Zi, Hercegovina, Dalmacia etj., (*vërejtja e autorit H.H.*) janë përgatitur në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (29:46).

Më tutje dr. Gjorgje Lekiqi e përmend edhe një gënjeshtër të madhe. Ky flet për dhunimin e femrave serbe nga shqiptarët. Në vend të demantimit tonë, t'u kthehemi gjurmimeve të bëra nga vetë serbët në këtë temë. "Në vjeshtë të vitit 1990 nga një grup eminentë juristësh e sociologësh politikisht të pavarur u botua në Beograd një studim, i cili trajtonte në mënyrë kritike pasqyrën mbi shqiptarët dhe situatën në Kosovë, që e përhapnin qarqet politike serbe. Nën thjerrëz u morën sidomos dhunimet dhe dëbimet. Studimi dëshmon se në Serbinë e ngushtë janë paraqitur dyfish më shumë fletëparaqitje për dhunime se në Kosovë, ku mesatarja e dhunimeve është përgjysmë më e vogël se mesatarja në ish - Jugosllavinë dhe dukshëm më i vogël se numri i dhunimeve në Vojvodinë. Në periudhën ndërmjet viteve 1979/1987 nga 323 raste të dhunimit apo të tentimdhunimit vetëm 9,6 për qind e dhunimeve ndaj grave serbe e malazeze ishin bërë nga shqiptarët, nga viti 1982 numri i fletëparaqitjeve madje u zvogëluar, ndërmjet viteve 1987/1989, nuk u regjistrua asnjë rast" (cit. sipas 6:118).

Dr. Lekiq vazhdon më tej "shkencërisht" u inicuan (gjoja në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, *vër.H.H.*) dhe ua dorëzuan bashibuzukëve që t'i realizojnë duke shkatërruar

përmendore, duke dhunuar vajza dhe plaka, vrasjet në prag të shtëpive, *helmimin e rinisë së vetë në emër të "qëllimeve të larta"* dhe veprime të tjera etnocide dhe gjenocide" (29:46). Në këta pak rreshta jipen shumë gënjeshtra. Kulmi dhe kreacioni fantastik, siç shihet edhe këtu, arrihet kur me rrena, shqiptarëve u përshkruhet ajo që vetë e bëjnë serbët. T'u referohemi fakteve. Ata akuzojnë shqiptarët se shkatërrojnë përmendoret serbe. Deri më tash është konstatuar se asnjë përmendore serbe shqiptarët nuk e kanë thyer. Përkundrazi thyhen përmendoret shqiptare, në pikë të ditës digjen librat shqipe në fabrikën e letrës në Lipjan, rrënohet me ndihmën e policisë kultura materiale shqiptare. Dëshmi për këtë ka shumë. Me fotos paraqesim vetëm rrënimin e bustit të Xhevdet Dodës, emrin e të cilit e mban edhe sot një gjimnaz në Prishtinë.



Dikur dukej kështu



Ndërsa sot ...?

Shqiptarët nuk hartuan asnjë dokument dhe memorandum për dëbimin e serbëve. Sikur serbët të kishin së pakut një argument ata do ta kishin përmendur një emër. Përkundrazi, serbët hartuan një projekt për dëbimin e shqiptarëve në emër të krijimit të Serbisë së Madhe, në bazë të të cilit nga territori i sotëm i Nishit, Leskocit, Prokupies, Pirotit, Krushevcit, Kurshumlisë, Lebanës, Medvegjës, Vrajës u bë pastrimi etnik me dhunë i afro 700 fshatrave kryesisht shqiptare. Duke ua djegur shtëpitë natën, u dëbuan mbi 340.000

shqiptarë nga Arnautllëku i Toplicës së Shqipërisë etnike (1877-1878).

Gënjeshtër e tretë e madhe serbe ka të bëjë me gjoja dëbimin me dhunë të serbëve dhe të malazezve nga Kosova. Është e evidente se asnjëherë shqiptarët nuk kanë qenë në pozitë që t'i dëbojnë serbët dhe malazezët nga Kosova.

Nga ky vend ekonomikisht më i pazhvilluari, lëvizjet migruese ishin karakteristike dhe vlenin për të gjithë, veçmas pas viteve 1970 kur në tregun e punës në shtetet e Evropës Perëndimore fillon vala e madhe e punësimit. Në këtë aspekt më së shumti të shpërngulur pati shqiptarë. Serbët e lëshonin Kosovën për çështje ekonomike dhe për shkak të humbjes së një pjese të vogël të privilegjeve që kishin deri në pakufi para Plenumit të Brioneve. Kjo bëhet pas Plenumit të Brioneve (1966). Shpërngulje të madhe serbe nga Kosova nuk ka dhe nuk ka pasur. Ajo është trillim i serbëve si mjet për të rrënuar autonominë e Kosovës, për të arsyetuar masat represive, për të ndërmarë masa të reja për zbatimin e kolonizimit të ri të Kosovës, për serbizimin definitiv të saj ashtu siç bënë edhe me territorin e Kurshumlisë, Toplicës, Prokupjes, Krushevcit, Leksovcit, Lebanës, Nishit, Medvegjës, Vrajës dhe Pirotit. Lidhur me "shpërnguljet" serbe nga Kosova t'i referohemi deklaratës së Stane Dolancit, atëherë anëtar i Kryesisë së RSFJ-së dhe sekretar i Sekretariatit të Punëve të Brendshme të ish-Jugosllavisë, i cili më 1981, ndër të tjera thotë: "*Nuk është e vërtetë se pas vitit 1968 ngjau një shpërngulje e madhe e serbëve dhe një vendosje e tyre në Serbi*". Për shpërnguljet serbe nga Kosova e kemi edhe një mendim të një serbi, i cili thotë se:

Sipas vlerësimit të autorit të bazuar në gjurmimin dhjetëvjeçar, dhe duke e krahasuar me vlerësimet e serbëve të Kosovës, të cilëve mund dhe duhet t'u besohet, sepse ata përkundër presioneve "të

mëdha" dhe të torturave të "mëdha" edhe më tutje janë banorë të Kosovës. "Nëntëdhjetë për qind të serbëve të Kosovës janë shpërngulur për shkak të interesit të realizuar me shitjen e pasurisë së patundshme me valutë stabile dhe me çmime shumë më të larta se ato ekonomike.

Dhjetë për qind të të tjerëve janë shpërngulur me presion ose me ndjenjën e paperspektivës në çka duhet të llogariten edhe masat e planifikuara të Sekretariatit Krahinor për Punë të Brendshme, në krye të cilit përherë ka pasur serbë... Nëse nuk pajtohemi rreth atyre 10% duhet të theksojmë se ata kanë shkuar për shkak të atyre 90%, apo për shkak të serbëve që kanë qenë në pushtet" (36:14). Gënjeshtra më e madhe serbe është kur tentojnë të dëshmojnë se shqiptarët helmojnë fëmijën e vet, pastaj pohimi i tyre për vrasjet në prag të shtëpisë, me çka dëshirohej të thuhej se populli serb ishte i rrezikuar nga shqiptarët. Këtë e demanton fotografia, në të cilën policët, siç shihet, në mënyrë të egër futen në institucionet e arsimit.



Policët duke hyrë
në objektin shkollor

Me qëllim që gënjeshttrat të zmadhohen, të glorifikohen pa masë, ato përcillen me inskenime, me vrasje e tortura. Në Paraqin inskenohet rasti i *Aziz Kelmendit*. Vritet në shërbim ushtarak, gjoja pse ka vrrarë katër shokë të vet. Në ekranin televiziv e qesin plakën nga Samodrezha e Vushtrrisë, së cilës gjoja shqiptarët ia kanë thyer dorën. Në gjips e kishte dorën të shëndoshë. Për vrasjen e djalit të kësaj plake thuhet se e vrau shqiptari në prag të shtëpisë. Pa u konstatuar e vërteta, ai ekzekutohet me pushkatim. Rasti i Gjorgje Martinoviçit, njeri perverz, i cili vetë lëndohet me shishe, tashmë dihet se u përdor për çështje të politikës së ditës me aq banalitet sa edhe vetëlëndimi. Fotomontazhi i "Nënës me pushkë"/ Prekallë, në Dukagjin, rast të cilin, si e tregon Goran Miliq, atë kohë gazetar i TVB -së kishte të bënte me një grua që nuk kishte fare fëmijë, ndërsa në vend të shkopit me fotomontazh vihet pushka. Kjo fotografi duhej të tregonte se në çfarë rreziku ishin të rinjtë serbomalazez.



Fotomontazh: Edhe kështu vërtetohet gënjeshttra serbe

Pas plasimit të vlerësimit për gjoja rrezikshmërinë e fëmijëve, nxënësve dhe të studentëve serbo-malazez dhuna mbi nxënësit, arsimtarët dhe punëtorët e tjerë shqiptarë eskalon pa masë dhe merr përmasa shqetësuese. Nga shkollat fillore dhe të mesme përjashtohen arsimtarët më të mirë. Kështu nga shkolla e mesme "*Boro e Ramizi*" në Gjilan përjashtohen 11 arsimtarë shqiptarë. Gjatë një periudhe të shkurtër rrënohen bustat e personaliteteve të rëndësishëm të kulturës, artit dhe të historisë shqiptare (Luigj Gurakuqi në Klinë, Hivzi Sylejmani në Fushë-Kosovë, Halit Ibishi në Babush, Hasan Prishtina në Prishtinë, Emin Duraku në Prishtinë etj). Në këtë kohë emërtimet shqipe të shkollave fillojnë të ndërrohen dhe të zëvendësohen me emërtime sllave.

Duke vepruar në këtë mënyrë në Kosovë krijohet psikoza e tensionuar dhe tepër e rëndë mes shqiptarëve dhe serbëve.

Masat dhe aktivitetet serbe për vendosjen e aparteidit

Kërkesa publike për ndarjen e nxënësve me mësim në gjuhën serbokroate, për herë të parë dëgjohej në mitingjet e serbo-malazezve. Këtë kërkesë shqiptarët e refuzuan dhe nuk u pajtuan me të. Për këtë shkak presioni serb si mbi organet e pushtetit ashtu edhe mbi organet arsimore shtohet gjithnjë e më shumë. Profesorët serbë të Universitetit të Prishtinës në krye me Radivoje Papoviçin përjashtuan nga Universiteti 964 punëtorë dhe mbi 30.000 studentë shqiptarë, të cilët që nga viti 1992 mësimin e dëgjojnë nëpër shtëpi private. Në mesin e shumë kërkesave të tjera ishte edhe kërkesa për ndarjen në baza kombëtare të nxënësve dhe të studentëve serbë në ndërtesa, kate, ndërresa dhe konvikte të veçanta. Për të ushtruar presion më të madh një grup studentësh serbo-malazez në vitin 1990 e lëshojnë konviktin me pretekst se janë të rrezikuar nga

"secionistët shqiptarë". Ky grup i studentëve serbo-malazez shkon në Fushë - Kosovë dhe atje vendoset nëpër familje. Ky largim i studentëve, nga qytetarët serbë të Fushë - Kosovës merret si pretekst për të udhëtuar në Beograd dhe për të bërë presion të forcuar në organet e pushtetit të ish- Jugosllavisë dhe për të neutralizuar rezistencën e shqiptarëve dhe të tjerëve në organet federative.

Pas petitionit dhe largimit të grupit të studentëve serbo-malazez nga konvikti fillon bojkotimi i mësimit në Universitet dhe në disa shkolla të mesme në Kosovë. Ky intensitet i presioneve shtohet sa më shumë që afrohej afati për helmim. Pas presionit të këtillë pason edhe presioni i organizuar edhe nga Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste, në krye të të cilit ishte Rrahman Morina, njeriu i cili ishte dorë e zgjatur e politikës gjenocide serbe. Ky ishte ai, i cili iu drejtua



Kështu studentët shqiptarë kanë vepruar që t'u shpëtojnë kthetrave të policisë serbe


vëllezërve nga Beogradi për ndihmë, më 26 mars 1981, kur, sipas "bilancit zyrtar të demonstratave të 26 marsit 1981, u plagosën 23 demonstrues dhe 14 pjesëtarë të policisë, 21 të rinj kinse prijës të trazirave, u burgosën" (6:77:78).

Nën presionin e madh të Komitetit Krahinor edhe të ndikimit të tij të drejtpërdrejtë bihet vendimi për dëbimin e të gjithë studentëve shqiptarë nga konvikti i studentëve.



Studentët shqiptarë të detyruar nga dhuna lëshuan konviktet. Ndoshta kjo ishte fat në fatkeqësi...

Pas dëbimit të studentëve shqiptarë, të cilët vendosen nëpër shtëpi private, policia hyn në konvikt dhe thyen çdo gjë që sheh para vetes.



Vandalizmi serb bën kërdi pas dëbimit të studentëve shqiptarë nga konviktet

Nën presion shumë të madh Komiteti i atëhershëm Krahinor i Arsimit i Shkencës dhe i Kulturës, më 8 mars 1990 (10 ditë para fillimit të helmimeve), qendrave komunale të Kosovës ua dërgon teleksin nr.91 (shih faksimilin në fq.78).

Në teleks, mes tjerash, thuhet: "*Është e nevojshme që organet e shkollave menjëherë nxënësave me mësim në gjuhën serbokroate t'ua mundësojnë vijimin e mësimin në ndërresën e parë, gjersa të zgjasin rrethanat e jashtëzakonshme*". Gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë u vu me dy prill të vitit 1981, kur ushtria rrethoi me tanke Prishtinën, kur aeroplanët qarkullonin natë e ditë mbi kryeqytet, edhe në Podujevë e në Ferizaj u angazhua ushtria. Bilanci i viktimave u komunikua më 6 prill 1981 në një konferencë

SRBIJA - SAP. KOSOVO
POKRAJINSKI SEKRETARIJAT ZA
PROSVETU I KULTURU
BEOGRAD, 03. 1998. GODINE
P. P. 1. S. T. I. N. A. Z.

URUČITI DOMAH

ŠKOLSTINA OPŠTINE

PRESEDIKU IZVRŠNOG VEĆA

P. P. 1. S. T. I. N. A. Z.

VEŠTA: TELEKS BR. 91 DD 5. MARTA 1998. GODINE

POTPISANO JE DA ORGANI ŠKOLA DOMAH OBEZBEDE UCENICIMA SA
NASTAVOM NA SRPSKOHrvATSKOM JEZIKU POKADJANJE NASTAVE U PRVOJ
ŠKOLSTINI STE DOB TRAJNO VANREDNE SPOKOSTI.

RASPOREDOM RADA OBEZBEDETI NORMALNO UČENJE NASTAVE UCENICIMA
SA NASTAVOM NA ALBANSKOM JEZIKU.

HAPRITINJEMO DA JE NEDI VOLJIVO OJVAJATI ŠKOLE NA NACIONALNO
OSNOVI, VEC U PRVOJ ŠKOLSTINI OBEZBEDETI DA PAPER UCENIKA SA
NASTAVOM NA SRPSKOHrvATSKOM JEZIKU, U PREOSTALIM OŠKOLSTINAMA
RUDU I UCENICI SA NASTAVOM NA ALBANSKOM JEZIKU.

Dokumenti me të cilin u vendos aparthejdi në arsimin e Kosovës

shyti në Beograd para gazetareve të botës së jashme: 11 të vrarë
2 prej të cilëve policë, 57 persona të plagosur (6:80). Kjo gjendje
vazhdoi deri në ditët e sotme.

Ishte ky një pranim i hapët i pozitës nënçmuese, pranim i pozitës së rendit të dytë dhe miratimit institucional të apartheidit në Kosovë. Mirëpo me një ndarje të këtyllë nuk u pajtuan institucionet arsimore në Kosovë. Për këtë arsye Këshilli Ekzekutiv i Kosovës në një mbledhje të vetë të jashtëzakonshme (më 15 mars 1990) deklaroi se "*nuk pajtohet me ndarjen e mësimin në baza nacionale*". Për ta realizuar serbët një qëllim të tillë të ndarjes së shkollës në baza kombëtare, udhëheqësit e tyre udhëtuan shumë shpesh për në Beograd. Për në Beograd udhëtuan edhe nxënës serbo-malazez të shkollës së mjekësisë "*9 Maji*" të Prishtinës. Pas këtij udhëtimi kjo shkollë u nda në dy shkolla në baza nacionale. *Me këtë akt u thye edhe rezistenca e shqiptarëve dhe u siguruan kushtet për mbrojtjen e nxënësve dhe të studentëve joshqiptarë nga helmimet që pasuan.*

Ç'ka të bëjë apartheidi me pastrimin etnik


Në Kosovë asgjë nuk ndodhi rastësisht. Çdo gjë ishte e lidhur dhe e kushtëzuar me politikë dhe me luftë për dominim absolut nacional serb. Edhe midis apartheidit, pastrimit etnik dhe të helmimeve të qytetarëve të Kosovës ka lidhje dhe kushtëzime të drejtpërdrejta. Në thelb vetë esenca e apartheidit nënkupton fenomenin e pastrimit etnik dhe anasjelltas, pastrimi etnik ka domethënie dhe kuptim të apartheidit, i cili këtu filloi të realizohet në etapa dhe u bë në emër të luftës kundër "albanizimit" të fshatrave të pastra etnike. Filloi në Batusë dhe Prilluzhë, i pari fshat afër Fushë - Kosovës dhe i dyti në Komunën e Vushtrrisë.

Në emër të luftës kundër "albanizimit" të fshatrave serbe, në Batusë rrënohet shtëpia e një shqiptari, i cili kishte migruar në këtë fshat kur tokën e kishte blerë në mënyrë legale e të cilit "tetë fëmijë dhe gruaja javë të tëra kishin mbetur në shtëpinë e rrënuar si simbol i drejtësisë serbe" në Kosovë (14:124).

Në fshatin Dushanovë të Prizrenit qytetarët serbë kërkojnë nga pushteti lokal që të dëbohet nga fshati familja e Aziz Kelmendit, djaloshtit 18-vjeçar, i cili u vra në kazermën ushtarake në Paraqin gjoja se ai kishte vrarë katër shokë në fjetje (14:124).

Në fshatin Prilluzhë "Ndodhi e papritura kur mëse 248 nxënësve të nacionalitetit shqiptar të Stanovcit të Poshtëm nuk u lejohet të kapërcejnë lumin Llap për të vijuar mësimet nga klasa e V - VIII në Prilluzhë..." thuhet në artikullin "PËRÇARJE E PANEVOJSHME NDËRNACIONALE" të autorit S. Jaha, botuar në "Shkëndija" (1989), ku në intervistën e Zoran Angjelkoviqit, anëtar i kryesisë së KQ të LKS, dhënë "Interviju-s" nr.194, më 11 nëntor 1988 thotë: *"Ndjej një kënaqësi që pas bisedave që pata me udhëheqësit e komunës së Vuçiternës, u zgjodhën disa probleme. Në Prilluzhë, për shembull, e zgjidhëm problemin e shkollës, me të cilin u hapen dyert për zgjidhjen e shumë problemeve të tjera..."* Ky komunist, përkatësisht anëtar i Kryesisë së KQ të LKS, për çudi, u mburrka me këtë "zgjidhje" të problemit të shkollës së Prilluzhës?! Ne, ndërkaq mendojmë se në këtë mënyrë siç është vepruar në Prilluzhë, vetëm mbillet fara e urrejtjes ndërmjet dy nacionaliteteve" - shkruan në artikullin e cituar (18:?). Nga shkolla fillore "Vuk Karaxhiq", - të Prilluzhës në shtator të vitit 1988, dëbohen 281 nxënës shqiptarë me 22 arsimtarët e tyre vetëm pse nuk ishin të nacionalitetit serbo-malazez. Në këtë fshat përherë të parë aplikohet apartheidi për të vazhduar pastaj më 1990 në këto shkolla: "Jovan Joviçeviq" në Gorazhdec, (largohen 458 nxënës shqiptarë me 21 arsimtarë), "M.Glishiq" në Vitomicë (largohen 336 nxënës shqiptarë e 16 arsimtarë), "Vasilije Gjuroviq" Gurakoc (732 nxënës, 38 arsimtarë shqiptarë), "Vuk Karaxhiq" Lepinje të Lipjanit (largohen 15 nxënës shqiptarë dhe 1 arsimtar), "Slobodan Peneziq Kërcun", Laposaviq (5 nxënës shqiptarë me 1 arsimtar, nga shkolla fillore në Mushnikovë të Prizrenit (largohen 103

nxënës me 5 arsimtarë) "V. Bashkimi" Podujevë, (largohen 1827 nxënës shqiptarë me 102 arsimtarë), shkolla e mesme "Trepça" në Zveçan, (largohen 748 nxënës me 48 arsimtarë), shkolla e mesme "8 Nëntori" në Podujevë (largohen 1304 nxënës me 94 arsimtarë), shkolla e mesme "Gjuro Gjakoviq" Podujevë në dhjetor 1990 (largohen 2.339 nxënës me 103 arsimtarë), shkolla e mesme "Nikolla Tesla" në Obiliq, shkurt 1991 (largohen 1973 nxënës me 101 arsimtarë) dhe shkolla e mesme në Lipjan (largohen 2.229 nxënës me 120 arsimtarë shqiptarë).



Faksimili i aktvendimeve të personit - ligj për mbylljen e shkollave me mësim në gjuhën shqipe. Me këtë përgënjeshtrohet pohimi serb se nxënësit shqiptarë me vetëdëshirë dolën nga objektet shkollore.

Mësimi në gjuhën shqipe ndalohet plotësisht më 1 shtator të vitit 1991, kur para të gjitha shkollave vendosen pjesëtarë të policisë dhe të ushtrisë serbe. Sërish mësimi fillon në shkurt të vitit 1992 në bazë të projektit të Entit Pedagogjik të Kosovës për organizimin e mësimimit edhe në shtëpi private, në bazë të tri

varianteve. Me qëllim të pengimit të mësimin më 31 janar të vitit 1991 në Uçë të Istogut vriten tre prindër dhe një plagoset.

Dëshmorët e Uçës të cilët ranë viktimë për mbrojtjen e shkollës shqipe



Muharrem Hysenaj



Bajram Hoxhaj




Hasan Hysenaj

Mbi 90% të shkollave fillore dhe pothuaj në të gjitha shkollat e mesme, me përjashtim të vendeve ku nuk ka serbë, mësimi nuk lejohet në objekte shkollore, aty ku e kanë zhvilluar mësimin para se ky të ndalohej. Andaj ky filloi dhe mbahet në shtëpi private ku organizohet edhe sot (shih hartën). E njëjta gjë vlen edhe për mësimin në shkolla të larta dhe fakultete.

Gazetari, Bajram Kabashi, në gazetën "*Bujku*" më 10 nëntor, 1992 shkruan: "*Në planin e përgjithshëm të Serbisë për pastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët, një vend i rëndësishëm i është dhënë pastrimit etnik të qetë, përmes ndalimit të shkollimit në të gjitha nivelet shkollore*".

Ky konstatim mundëson të konkludohet se helmimet kanë qenë në funksion të pastrimit etnik, siç ka qenë edhe aparteidi. Po ashtu, helmimi ka qenë në aspektin primar në funksion të rrënimit të arsimit shqip.

PENGIMI I SHKOLLAVE SHQIPE NË FUNKSION
 TË PASTRIMIT ETNIK
 CLOSED ALBANIAN SCHOOLS IN FUNCTION OF THE
 ETHNIC CLEANING



Pengimi i shkollave shqipe në funksion të pastrimit etnik dhe të apartheidit

Në vazhdim e paraqesim një dëshmi konkrete për aplikimin praktik të aparteidit në shkollat fillore "*Vladimir Iliq Lenin*" (sot "*Dardania*") në Prishtinë.

Bogi Gogiq, "drejtor" i shkollës fillore "*V.I.Lenin*", i emëruar nga Serbia, më 2 shtator 1991 i njofton "mësimdhënësit shqiptarë se klasët në të cilat mësojnë nxënësit serbë nuk mund të shfrytëzohen nga shqiptarët. Kjo sipas Gogiqit bëhet nga se na ishte rritur numri i paraleleve serbe.

Do theksuar se në vitin shkollor 1990/91 në këtë shkollë kishte 2450 nxënës shqiptarë dhe rreth 520 nxënës serbë. Për këta nxënës Gogiqi formoi 24 paralele, të cilat shfrytëzonin tërë lokalit shkollor. Pyetjes se ku do të mësojnë nxënësit shqiptarë, ky i përgjigjet: "*Në fund të fundit kjo nuk më intereson*".

Prova eksperimentale e helmeve - etapë e re për zbatimin e helmimit

Me skenar, ishte paraparë që të bëhet testimi eksperimental i efikasitetit të helmeve, që më vonë do të aplikohen në mënyrë masive në tërë Kosovën. Sipas të gjitha gjasave ishte parashikuar të bëhej testimi i helmeve neurotoksike. Viktima për eksperiment ishin zgjedhur nxënësit e shkollës së mesme "*Luigj Gurakuqi*" në Klinë dhe të rinjtë e Prizrenit. Zgjedhja e të rinjve për eksperimentin nuk ishte e rastit. Kjo ishte bërë me qëllim që helmimet të kamufloheshin me shqetësime psikike, që lidhen me këtë moshë. Ishte kjo edhe një dëshmi se në skenarin e helmimeve punonin ekspertë të lëmenjve të ndryshëm: psikologë, toksikologë, ekspertë të luftës speciale etj. Dhe, me të vërtetë, siç u konstatua më herët, për fenomenin e helmimeve dalin shumë versione. Në mesin e tyre ishte edhe ai i "histerisë masive".

Në këtë shkollë ka herë kishte filluar represioni. Kërkohej ndër-
rimi i emrit të shkollës, u rrënuar busti i shkollës, nxënësit serbë
kërkonin që mësimi të bëhej në ndërresa të veçanta. Acarimi i
marrëdhënieve mes nxënësve dhe punëtorëve të nacionaliteteve të
ndryshme bëhej me qëllim që kërkesa për ndarje të arsyetohej si
pamundësi e punës së përbashkët pedagogjike të nxënësve shqip-
tarë dhe serbomalazez në këtë shkollë. Qëllimi i fshehur i kësaj
ishte mbrojtja e nxënësve serbomalazez nga helmimet. Në testin
eksperimental u helmuan 33 nxënës të kësaj shkolle. Në mesin e
të cilëve ishin: *Afërdita Mustafaj, Remzije K. Becaj, Vjollca G. Foniqi, Shpresa Kuqi, Burbuqe S. Rraci, Shqipe R. Marmullaku, Fazë Dushi, Skënder Skeli, Shpresa H. Zeqa, Sevdije Shala, Sabrije A. Dauti, Feride H. Berisha, Shukrije Desku, Violeta Berisha, Sanije Sylaj, Suzana Thaçi, Teutë Elezi, Myrvete Gashi e Islam-Marmullaku.* Të gjithë u hospitalizuan në spital, kryesisht
në spitalin e Prishtinës. Simptomat e nxënësve të helmuar ishin të
së njëjtës sëmundje si të asaj që ndodhi pikërisht një vit më vonë
në Podujevë. Ishin ato mjete kimike të luftës, të grupit të trillonit.
Në këtë kohë askujt nuk i shkante mendja se fëmijët shqiptarë u
helmuan nga agjentët e shtetit, qytetarë të të cilit ishin edhe vetë.

Prova e dytë eksperimentale u bë në Prizren, në shkollën e
mesme të mjekësisë "*Boro e Ramizi*" më 14.12.1989. Helmimi u
bë në paralelen II-3 të kujdestarit Qazim Kabashi, profesor i
historisë. U helmuan 7 nxënës të kësaj paraleleje, kujdestari i
klasës dhe dy fëmijë të drejtorit të shkollës. Dy, nga ata shtatë
nxënës edhe sot vuajnë shumë nga helmimet. Janë këto: *Hatixhe Dakaj dhe Fitnete Bytyqi.*

Për helmimin në këtë shkollë Qazim Kabashi thotë se është
menduar se kishin të bënin me karbon - dioksid. Në kërkesën që i
bënë Entit Higjenik të Kosovës, që të ekzaminojë këtë dukuri, nuk
hasën në mirëkuptim!!!?

Prova eksperimentale kishte këtë qëllim:

- të simulojë procesin e mëvonshëm të helmimeve,
- të përcaktohej doza e helmeve, e cila do të përdorej një vit më vonë,
- të matej pulsi i shqiptarëve dhe të studiohej reagimi i tyre,
- të testohej reagimi i faktorit ndërkombëtar,
- të thellohej edhe më tutje ndjenja e pasigurisë së shqiptarëve,
- të acaroheshin edhe më tej marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe të serbëve si dhe
- të nxitej agresiviteti i shqiptarëve me qëllim që këta të çoheshin në demonstrata, të cilat do të shtypeshin me gjak, siç u bë disa herë më parë (pikërisht ashtu siç porosiste Vasa Qubrilloviqi në projektin e tij fashisoid të vitit 1937).

Kalendari i helmimeve

Helmimi i qytetarëve të Kosovës filloi më 21 mars 1989 në qytetin e Klinës dhe përfundoi më 6 dhjetor 1990. Helmimi masiv filloi më 19 mars 1990 në komunën e Podujevës. Ky qytet siç shihet edhe në hartë gjendet në pjesën periferike të Kosovës Veriore. Kufizohet me komunën e Kurshumlisë e cila është pjesë e territorit serb. Kurshumlia është e banuar kryesisht me serbë. Si komunë kufitare Podujeva ishte e përshtatshme që helmimi të bëhet në të, të drejtohet dhe të kontrollohet lehtë nga qendra e Kurshumlisë. Në anën tjetër kjo komunë në aspektin etnik ishte dhe është homogjene, sepse mbi 99% e popullatës është shqiptare. Shkalla e sigurisë që me helme të mos atakohet popullata joshqiptare ishte shumë e madhe (99%). Kjo njëherit ishte e përshtatshme për një testim të ri dhe modelim të sërishëm eksperimental për helmim masiv të shqiptarëve. 19 marsi 1990 ishte ditë e hënë, dita

e parë e javës dhe e mësimit. Procesi i inagurimit të aparteidit kishte përfunduar më 16 mars, kur studentët shqiptarë ishin dëbuar nga konvikti i studentëve në Prishtinë dhe ditë kur edhe kundërshtimi i fundit i shqiptarëve për vendosjen e aparteidit mori fund me detyrimin e shkollës së mesme të mjekësisë "9 Maji" tani "Ali Sokoli" në Prishtinë që zhvillimin e mësimit ta mbajnë ndaras në kate dhe ndërresa të veçanta, kjo ishte bërë pas udhëtimit të arsimtarëve serbo-malazez për në Beograd, të cilët para organeve të Serbisë dhe të organeve të ish-Jugosllavisë në mënyrë ultimative dhe me nervozizëm të shtuar kërkojnë që të ndahen nga shqiptarët.

Helmimi masiv fillon në shkollën e mesme "Gjuro Gjakoviq" në Podujevë me këtë rast janë helmuar këta nxënës: *Violeta Gashi, Valdete Gashi, Shyhrete Jupolli, Afërdita Jupolli, Shpresa Bajrami, Asrie Beshiri, Naimë Murati, Armend Maloku, Sheqir Pakashtica, Ibrahim Rexha* dhe profesor *Agron Jaha*. Në këtë ditë Podujeva ishte ngritur në këmbë. Hutia ishte e madhe. Prindërit e fëmijëve ishin alarmuar. Të gjithë nxënësit e helmuar kërkuan ndihmë mjekësore në ambulancën shëndetësore apo në Spitalin e Prishtinës. Përkundër shqetësimit të madh, këtë ditë nuk pati më tepër nxënës të helmuar në këtë qytet e as në qytetet e tjera të Kosovës. Në të njëjtën shkollë helmimi vazhdon më datën 20 mars 1990. Në këtë ditë helmi ishte më masiv, trishtimi dhe paniku, frika dhe tmerrri ishin shtuar pa masë. Tani u bë e qartë se fjala është për helmim. Mjekët në ambulanca kishin shënuar në diagnozën "*intoxicacion*". Në këtë ditë drejt kësaj shkolle nxituan edhe gazetarët, mjekët e shumë njerëz të tjerë që me vetura të veta të ndihmojnë të helmuarit dhe këta t'i vendosnin në spitalin e Prishtinës.

Gazetarët dhe fotoreporterët regjistruan skena të llahtarshme dhe trishtuese. Arsimtarët dëshmonin se nxënësit binin përtokë si

"zogjët pa krahë". Dhëmbjet, shtrëngimet, të vjellat, dridhjet, vaji dhe tmerri sërish e kapluan Podujevën. Më 20 mars në shkollën e mesme "Gjuro Gjakoviq" u helmuan këta nxënës: *Driton Abdullahu, Shefqet Fazliu, Hasim Blakqori, Lulëzim Krasniqi, Florie Haxhiu, Sabile Hoti, Florie Hoxha, Kimete Ymeri, Fitim Maloku, Elife Salihu, Mirvete Sheholli, Basrie Berisha, Kimete Ajvazi, dhe Hanife Xhemajli*. Më 20 mars 1990 helmimi sërish u bë vetëm në Podujevë madje vetëm në shkollën e mesme të sipërpërmendur. Në këtë ditë në asnjë qytet tjetër nuk pati helmim. Gjithashtu më 21 mars 1990 Kosova ishte e qetë në aspektin e helmimeve të reja. Askund as në Podujevë nuk pati helmim. Të trazuar dhe të shqetësuar ishin nxënësit, dhe prindërit, farefisi i fëmijëve të helmuar të shkollës së mesme "Gjuro Gjakoviq". Me gjasë data 21 mars 1990, për organizatorët e helmimit ishte caktuar si ditë për analizën e procesit të helmimit, dhe marrjes së vendimeve për vazhdimin e helmimeve me përmasa të gjera në tërë Kosovën. Analiza e efikasitetit të helmimit për projektuesit e këtij krimi "doli pozitive" dhe e "suksesshme". Faktori ndërkombëtar nuk u trazua shumë. Serbia dhe organet e ish - pushtetit nuk u akuzuan për helmim. Ndërsa paniku, psikoza e frikës për të cilën këta ishin të interesuar, ishte tepër e madhe. Ankthi dhe brenga e shqiptarëve, pasiguria në shkolla ishte shtuar pa masë. Me një fjalë ajo që ishte paraparë ishte realizuar dhe ishte e përputhshme me idenë morbide të organizatorëve të helmimit. Më 21 mars, me siguri pas analizës në detaje të helmimeve të bëra në puktin e parë, në shkollën e mesme "Gjuro Gjakoviq" në Podujevë merret vendim formal për vazhdimin e helmimit. Më 22 mars 1990 ditë e enjte me helm do të atakohen nxënësit dhe qytetarët e 13 qyteteve të Kosovës, ky tani është helmimi më masiv i bërë. Viktima të helmimit masiv

ishin nxënësit, qytetarët, fëmijët, studentët e Ferizajt, Prizrenit, Gjilanit, Obiliqit, Fushë Kosovës, Podujevës, Vushtrrisë, Mitrovicës, Skënderajt, Klinës, Malishevës, Pejës dhe të Deçanit. Kjo është dita më e kobshme për shqiptarët e Kosovës. Veturat oshëtinin nëpër rrugët e Prishtinës duke ngarendur me shpejtësi të madhe për të shpëtuar viktimat e atakuara me helme kimike të luftës. Populli shqiptar ishte i nemitur. Nuk dinte çka të bënte. E vetmja gjë që i mbeti ishte që secili, aq sa kishte mundësi, të ndihmonte të rinjtë dhe të rejat shqiptare që ata sa më parë të vendoseshin nëpër spitale. Tanimë nuk kishte dilemë. Ishte e qartë se ky ishte helmim masiv. Spitalet ishin të mbushura me të rinj dhe të reja. Prindërit ishin në vrap drejt spitaleve. Të shqetësuar dhe të trazuar kërkonin dhe pyetnin për fëmijët e tyre. Solidariteti ishte i madh. Të gjithë ata që posedonin automjete ishin në shërbim të qytetarëve dhe të rinjve të helmuar.

Intensiteti i helmimit shtohet më 23 mars 1990. Këtë ditë helmimi shtohet edhe në qytete të tjera. Me helmim këtë ditë përfshihen edhe Gjakova, Vitia, Shtimja dhe Lipjani. Në Gjakovë me helmim përfshihen edhe fëmijët e edukimit dhe të arsimit parashkollor në çerdhen e fëmijëve "*Emin Duraku*". Në këtë çerdhe helmohen shtatë fëmijë. *Azem Lekaj*, i lindur më 1985, *Jasmina Lokaj* e lindur më 1986, *Igor Gashiqi*, i lindur me 1987 (me përkatësi nacionale malazeze), *Liridona Kusari*, e lindur më 1986, *Valbona Hoti* e lindur më 1986, *Kreshnik Hoti*, i lindur më 1986, dhe *Driton Haraqia* i lindur më 1986.

Me qëllim të studimit të fenomenit të helmimit është përpiluar kalendari i hedhjeve të helmeve, të cilin po e paraqesim në këtë tabelë.


Kalendar i helmimeve në Kosovë gjatë vitit 1990

Muaj	Ditët							Gjithsej
	H	M	M	E	P	SH	D	
Mars	19	20	21	22	23	24	25	5
	26	27	28	29	30	31	X	3
Gjithsej	2	2	1	1	1	1		8
Prill							1	-
	2	3	4	5	6	7	8	6
	9	10	11	12	13	14	15	6
	16	17	18	19	20	21	22	4
	23	24	25	26	27	28	29	3
30								
Gjithsej	3	4	3	4	3	2		19
Maj		1	2	3	4	5	6	-
	7	8	9	10	11	12	13	5
	14	15	16	17	18	19	20	4
	21	22	23	24	25	26	27	4
	28	29	30	31				3
Gjithsej	3	3	4	3	3			16
Qershor					1	2	3	2
	4	5	6	7	8	9	10	4
	11	12	13	14	15	16	17	
Gjithsej		1	1		2	2		6
TOTAL	8	10	9	8	9	5		49

Muaj	Ditët							Gjithsej
	H	M	M	E	P	SH	D	
IX					1	2	3	
	4	5	6	7	8	9	10	
	11	12	13	14	15	16	17	
	18	19	20	21	22	23	24	2
	25	26	27	28	29	30		1
Gjithsej	1			2				3
XII					1	2	3	1
	4	5	6	7	8	9	10	
	11	12	13	14	15	16	17	
	18	19	20	21	22	23	24	
	25	26	27	28	29	30		
Gjithsej	1			2				1
TOTAL	1		1	2				4

Nga tabelat e sipërme mund të konstatohet se helmimi në periudhën 1989-1990 ka zgjatur 55 ditë, prej tyre 2 (dy) ditë në vitin 1989, dhe 53 në vitin 1990. Studimi i kalendarit të helmimit dëshmon se ky ishte një helmim shumë i balancuar, kur projek-

Paratitja grafike e ditëve të helmimit sipas muajëve



tuesit deri në detaje kanë menduar për optimalitetin e resurseve si dhe ndarjen dhe bashkërenditjen e harmonishme dhe të balancuar si të resurseve ashtu edhe të ngarkesës së balansuar, si gjatë ditëve të javës, ashtu edhe gjatë muajve.


Analiza e këtij grafikoni tregon qartë se helmimi ishte realitet. Mendimi se mund të aktohet 53 ditë, dhe me një distribuim të këtillë është i paqëndrueshëm. Në grafikon shihet qartë, se ky distribuim edhe pse nuk i përgjigjet një shkapërderdhjeje normale është shumë e përafërt me të. Kjo shkapërderdhje nuk ka mundur assesi të jetë rezultat i veprimit të faktorëve të pakontrolluar. Përkundrazi, distribuimi është rezultat i një plani dhe skenari të përgatitur në mbështetje të studimeve operationale dhe të planifikimit dinamik dhe iterativ. Siç mund të konstatohet helmimi në mars fillon pas realizimit të kërkesës për segregacion. Së dyti, më 21 mars askund në Kosovë nuk pati helmim. Pastaj, ky vazhdon me intensitet të shtuar deri më datën 24 mars 1990. Të dielën, më 25 mars nuk ka pasur helmim. Intensiteti më i madh i helmimeve bëhet më datën 22 dhe 23 mars 1990, më 24 mars intensiteti i helmimit fillon të zvogëlohet. Kjo dukuri e vërteton supozimin se në skenar kanë punuar ekspertë, se plani ka qenë i kontrolluar dhe i drejtuar mirë. Intensitetin e helmimit gjatë muajit mars e paraqesim në grafikonin vijues.

Datat e helmimit gjatë muajit mars

Paraqitja grafike e numrit të qyteteve të përfshira me helmim, po ashtu e vërteton tezën e helmimit të planifikuar dhe të dirigjuar me metoda bashkëkohore. Njëherit ky grafikon tregon se helmimi u bë me një precizitet të lartë. Gjatë muajit janë planifikuar pauzat - pushimet me të cilat përmes lidhjes reverzibile (feed beack-ut),

janë analizuar efektet, dhe në mbështetje të kontrollit të këtillë kibernetik janë ndërmarrë akcionet e tjera për vazhdimin e helmimit. Një element me rëndësi për marrjen e vendimit për vazhdimin ishte që hedhësit e helmeve nuk u "zunë" dhe nuk u identifikuan. Distribrimi i helmimit nëpër qytete anon drejt një distribrimi normal. Gjasimi i këtillë shihet në grafikonin vijues.

Paraqitja grafike e qyteteve të përfshira ne helmim sipas datave gjatë muajit mars 1990



Një balancim dhe një harmoni e madhe hetohet edhe gjatë ditëve të javës, në të cilat u bë helmimi. Kjo shumë qartë ilustruhet me grafikonin vijues, (shih fq.94).


Në muajin prill helmimi fillon më datën 2 (ditë e hënë). Objekt helmimi gjatë prillit ishin qytetet dhe fshatrat e Kosovës, të cilat kishin qenë të atakuara me helme gjatë muajit mars 1990. Gjatë këtij muaji helmimi zgjati 19 ditë.

Pasqyrë e helmimeve sipas ditëve të javës

Muajt	Ditët						Gjithsei
	H	M	M	E	P	SH	
III	2	2	1	1	1	1	8
IV	3	4	3	4	3	2	19
V	3	3	4	3	3	-	16
VI	-	1	1	-	2	2	6
IX	1	-	-	2	-	-	3
XII	-	-	1	-	-	-	1
Gjith.	9	10	10	10	9	5	53

Gjatë prillit helmim pos të dielave nuk kishte më datën 18,28,29 dhe 30 prill. Më 18 prill është bërë analiza konform së cilës janë ndërmarrë aksionet e tjera pasuese. Për shkak se ishte festë, në javën e parë të muajit maj 1990, nuk kishte helmim. Atakimi me helme kimike të luftës fillon në javën e dytë të këtij muaji. Helmimi i rinisë dhe qytetarëve kryesisht shqiptarë, gjatë muajit maj fillon më 7 dhe zgjat deri më 31 maj të vitit 1990. Brenda kësaj kohe helmimi nuk u bë ditëve të shtuna, të dielave dhe më 21 dhe 29 maj.

Pasqyra tabelare e numrit të ditëve të javës në të cilat u bë helmimi



Në muajin qershor intensiteti i helmimeve fillon të bjerë. Gjatë këtij muaji helmimi zgjat vetëm 6 ditë, dhe përfundon më 9 qershor kur bëhet helmimi në dy shkolla fillore të komunës së Suharekës: "Vëllazërim-Bashkim" dhe "Boro e Ramizi" në Mohlan. Në këtë ditë në shkollën fillore "Vëllazërim-Bashkim" helmohen: *Agim Gashi, Arieta Berisha, Mimoza Berisha, Hamza Daka, Suzana Mazreku, Fatmire Kokollari, Vjosa Fetiu, Luljeta Bytyqi, Ismet Haziri dhe Ardian Kabashi*. Në shkollën fillore "Boro e Ramizi" janë helmuar këta nxënës: *Minire Morina, Flora Daka, Hatixhe Kabashi, Hasime Kabashi, Hasime Kokollari, Melihe Daka, Fahrie Kabashi, Lindita Morina, Mevlude Morina dhe Hasime Morina*. Në muajin shtator, siç mund të konstatohet nga tabela nr. 8, helmimi bëhet vetëm në Fushë-Kosovë, kur helmohen: *Elmaze Makolli* (18 shtator dhe më 21 shtator 1990), *Visar Sylejmani, Valbona Maloku, Maliqe Shala dhe Laura Konjuha*.

Helmimi përfundon më 6 dhjetor (ditë e mërkurë) 1990, kur në Mitrovicë helmohen nxënëset e shkollës së mesme të mjekësisë: *Sami Musliu, Valbona Hamiti, Melihate Islami* etj.

Me qëllim të studimit të fenomenit të helmimit dhe të rekonstruimit të skenarit është aplikuar teknika e planifikimit rrjetor, teknikë e cila bën pjesë në kërkimet operacionale dhe të planifikimit interativ dhe dinamik. Për këtë qëllim e kemi konstruktuar diagramin rrjetor: Metoda e rrugës kritike-Critical Path Method, apo shkurtimisht CPM)¹. Diagrami rrjetor është hartuar në mbështetje të kalendarit të hedhjes së helmeve. Analiza e strukturës së DRR, tregon se helmimi në periudhën 1989-1990 është bërë në 20 qytete të Kosovës. Të 20 qytetet kanë qenë të atakuara gjatë muajit mars 1990, ndërsa në disa qytete të Kosovës helmimi është bërë edhe gjatë muajve: prill, maj, qershor, shtator dhe dhjetor, (shih shtesën nr.1 - diagrami rrjetor).

1) Metodat e planifikimit rrjetor janë zhvilluar për herë të parë në SHBA më 1957. Janë dy metoda kryesore. E para është Metoda rrugës kritike-CPM dhe e dyta PERT metoda, zakonisht aplikohen kur duhet kryer dhe realizuar projekte të komplikuara dhe me shumë aktivitete.



Drugëtimi i helmimeve në Kosovë

Diagrami rrjetor ka mundur të shërbejë edhe për analizë më të thellë të strukturës, ashtu edhe për analizën e kohës, por konsiderojmë se rikonstruimi i procesit të helmimit nuk është i domosdoshëm e as i nevojshëm.

Prej diagramit rrjetor mund të konkludohet se relacioni kryesor apo rruga kritike ka qenë: Podujevë- Prishtinë, Lipjan- Shtimje, Shtimje-Ferizaj, Ferizaj- Viti, Viti- Gjilan, Gjilan- Kamenicë. Në këtë relacion është shënuar edhe numri më i madh i të helmuarve. Po në këtë relacion në Shtimje ndahet marshuta: Shtime-Duhël, Duhël-Malishevë dhe Duhël-Suharekë; Suharekë-Prizren; Prizren-Zhur. Relacionin e tretë e përbën marshuta: Prishtinë-Fushë- Kosovë- Pejë-Deçan dhe Gjakovë dhe relacionin apo marshutën e pestë e përbën relacioni: Prishtinë-Obiliq, Vushtri-Mitrovicë- Skënderaj dhe Klinë.

DËSHMITË DHE PROVAT E TJERA PËR HELMIMET

Për helmimet e viteve 1989 e 1990 në Kosovë ka dëshmi dhe prova të shumta, të cilave do t'u referohemi në vazhdim, me qëllim që të hiqen të gjitha dyshimet dhe skepsat. Duke pasur parasysh këtë përcaktim do të shqyrtohen këto aspekte të helmimeve:

- struktura e viktimave të helmimeve,
- dëshmitë e dëshmitarëve,
- natyra e helmeve dhe simptomatologjia dhe
- reagimet dhe veprimet e policisë.

Sa dhe cilat ishin viktimat e helmimit?

Viktima të helmimit ishin fëmijët, nxënësit, studentët, punëtorët, amviset dhe qytetarët e tjerë të Kosovës, kryesisht shqiptarë. Në mesin e të helmuarve kishte edhe qytetarë e nxënës të Banjës së Siarinës, të Preshevës, Bujanocit, Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Strugës dhe të Malit të Zi. Ishin këta kryesisht nxënës të shkollave të mesme dhe studentë që jetonin dhe mësonin në Kosovë.

Numri i saktë i viktimave ende nuk dihet. Gjatë gjurmimit janë konstatuar dhe identifikuar 7.421 viktima të helmimeve. Mirëpo, ky numër, sipas të gjitha gjasave, është më i madh. Sipas indikacioneve që kemi në dispozicion viktima të paignifikuar të

helmimeve ka në Prishtinë (rreth 15 veta), Viti, Lipjan, Vushtrri (18) dhe në Pejë.

Gjatë vitit 1994 janë identifikuar edhe 4 raste. Pavarësisht nga rastet e paidentifikuara deri më tash, supozohet se nuk mund të ketë pasur më shumë se 7600 viktime.

Struktura e të helmuarve është shumë variabile dhe heterogjene si nga mosha, ashtu edhe nga përgatitja shkollore, por edhe nga ajo profesionale. Homogjeniteti më i madh është në aspektin e strukturës nacionale.

Strukturën e viktimave sipas moshës e paraqesim në tabelën vijuese:


Pasqyra tabelare e të helmuarve sipas niveleve të shkollimit dhe profesioneve

Nr.	Nivelet e shkollimit - profesionet	Të helmuar	
		Numri	%
1	Edukimi dhe arsimi parashkollor (fëmijë)	7	0,1
2	Edukimi dhe arsimi fillor (nxënës)	2.046	27,2
3	Arsimi i mesëm (nxënës)	4.148	50,1
4	Arsimi i lartë (studentë)	152	2
5	Gjithsej të helmuar në institucione arsimore	6.343	84,2
6	Punëtorë në fabrika	384	5,1
7	Institucione kulturore (halla e sporteve)	94	1,2
8	Oytetarë	708	9,4
	Total	7.529	

Nga kjo tabelë mund të nxirren konkluzione shumë relevante të cilat janë dhënë si hipoteza të mundshme në kaptinat e mëparshme të këtij studimi. Pra objekt kryesor atakimi kanë qenë nxënësit e shkollave të mesme. Kjo dëshmohet me faktin se prej 7421 të helmuarve, 4170 apo 56% kanë qenë nxënës të shkollave të mesme. Qëllimi i një atakimi kaq intensiv me helme kimike të luftës në arsimin e mesëm ishte në funksion të shkatërrimit të kësaj hallke të zinxhirit të sistemit të arsimit shqip në Kosovë. Me shkatërrimin e arsimit të mesëm do të bëhej i pamundshëm arsimimi

në gjuhën shqipe i shqiptarëve, sepse pa arsimim në gjuhën shqipe në shkollat e mesme nuk është i arsyeshëm e as funksional arsimi fillor në gjuhën amtare. Në anën tjetër, pa arsim të mesëm në gjuhën shqipe as që mund të flitet për arsimim universitar në gjuhën amtare. Me një goditje do të realizoheshin dy qëllime, ndërsa me këtë do të bëhej i realizueshëm synimi fundamental dhe dëshira shumëvjeçare e Sërbisë për shkatërrimin dhe rrënimin e arsimit shqip në Kosovë. Sa dhe në ç' masë janë goditur me helmim nivelet e caktuara të arsimit dhe struktura profesionale e tyre shihet qartë në grafikonin vijues.

Paraqitja grafike e të helmuarve sipas niveleve arsimore



Nga paraqitja grafike shihet qartë se, pas arsimit të mesëm më të atakuar me helmim kanë qenë nxënësit e shkollave fillore, pastaj vijnë kategoritë e tjera të profesioneve, siç janë punëtorët në tri ndërmarrje prodhuese (Gjakovë në fabrikën e Tekstilit) "*Emin Duraku*", në Suharekë, në fabrikën "*Ballkan*" dhe në Vushtrri në fabrikën "*Polet*", si dhe spektatorët e koncertit që mbajtur në hallën e sporteve në Ferizaj, mandej amvise, kalimtarë të rastit etj. Numri më i vogël i të helmuarve është në kategorinë e fëmijëve parashkollorë (vetëm 7 fëmijë apo 0,1%, të gjithë në komunën e Gjakovës).

Nga tabela e paraqitur më lart mund të konkludohet se me helmim kanë qenë të përfshirë 20 qytete, 11 fshatra (Kabashi, Pozharani, Radivojci, Polaci, Sllatina, Juniku, Zhuri, Prelepi, Mohlani, Krusha dhe Pirana). Këto fshatra kanë qenë kryesisht të pastra etnikisht, andaj dhe helmimi ka qenë më lehtë të kryhet, ndërsa në qytete, siç është paraqitur në këtë studim, organizatori i helmimit ka dashur të aplikojë segregacionin dhe aparteidin. Nga aspekti i numrit të të helmuarve më i atakuari ka qenë Ferizaj me 931 të helmuar, pasojnë Peja, Prishtina, Podujeva, Gjakova etj. Pasqyrën e të helmuarve, sipas komunave, e paraqesim në tabelën, fq.102.

Analiza e numrit të të atakuarve me helm, sipas komunave e vërteton qartë konstatimin se helmimi është bërë në bazë të një plani dhe skenari të përgatitur mirë nga ekspertë, të cilit e kanë njohur strukturën demografike për nga përkatësia nacionale, në një anë, dhe parametrat statistikorë të numrit të nxënësve dhe të institucioneve të Kosovës, në anën tjetër. Me fjalë të tjera, helmimeve u ka prirë një studim multidimensional.


Në Ferizaj, atakimi aq masiv me helme është bërë për shkak se ky qytet ka pasur një tendencë të shtimit shumë të madh të nxënësve shqiptarë. Në anën tjetër, Ferizaj gjendet në një qendër

Pasqyra e numrit të të helmuarve sipas komunave

Nr.	Komuna	Institucionet - struktura e të helmuarve												
		Ed.parash.		Ars. fill.		Ars. mesëm		Ars. lartë		Gjiitisei		Të tierë		
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	T.
1	Ferizai	-	-	225	24,2	605	64,9	7	0,7	837	90	94	10	931
2	Gjakovë	7	1,1	169	27,1	161	25,9	-	-	337	54	287	46	624
3	Prizren	-	-	196	46,2	228	53,8	-	-	424	100	-	-	424
4	Suharekë	-	-	33	10	267	72,5	-	-	300	81	68	19	368
5	Shtëmie	-	-	37	69,8	16	30,2	-	-	53	100	-	-	53
6	Lipian	-	-	45	78,9	12	21,1	-	-	57	100	-	-	57
7	Viti	-	-	67	36,4	117	63,6	-	-	184	100	-	-	184
8	Gjilan	-	-	83	18,7	273	61,5	17	3,8	373	84	71	16	444
9	Kamenicë	-	-	52	42,3	58	47,1	-	-	110	89	13	11	123
10	Prishtinë	-	-	117	16,1	511	70,4	59	8,1	687	95	39	5	726
11	Obiliq	-	-	67	54	34	27,4	-	-	101	81	23	19	124
12	F.Kosovë	-	-	147	89,6	-	-	-	-	147	90	17	10	164
13	Podujevë	-	-	278	41,8	374	56,3	-	-	652	98	13	2	665
14	Vushtrri	-	-	70	10,7	257	39,5	-	-	327	50	324	50	651
15	Mitrovicë	-	-	-	-	399	77,2	21	4,1	420	81	97	19	517
16	Skënderaj	-	-	157	53,9	117	40,2	-	-	274	94	17	6	291
17	Klinë	-	-	47	34,8	74	54,8	-	-	121	90	14	10	135
18	Malishevë	-	-	-	-	131	95	-	-	131	95	7	5	138
19	Pejë	-	-	226	27,4	461	55,8	31	3,7	718	87	81	13	799
20	Decan	-	-	30	27,1	53	47,7	7	6,3	90	81	21	10	111
	Gjithësi	Nr	7	2046		4148		152		6343	1186			7529
		%	0,1	27,2		50,1		2		84,2	15,8			

të përshtatshme të trafikut, mes Shkupit dhe Prishtinës. Në rastin e helmimeve organizatorët kanë pasur për qëllim, që popullata shqiptare të atakohet në ato mese ku shqiptarët janë të dy konfesioneve - katolike dhe islame, me qëllim që në një rast eventual të fajësohet njëra nga këto kategori për helmim. Kjo në të vërtetë ashtu ndodhi. Për helmim në Ferizaj u fajësua kisha katolike. Kjo, siç u tha, u bë nga ana e mjeteve të informimit në gjuhën serbe.

Paraqitja grafike e numrit të helmuarëve (në %) sipas komunave



(gazetat "Jedinstvo", "Politika" dhe "Nin-i" si dhe Qendra e Sigurimit në Ferizaj) (33:91). Në bazë të këtij kriteri u bë helmimi në Janjevë, Gjakovë, Klinë, Viti dhe Pejë. Me helmim, për shkak të popullatës së madhe të nxënësve shqiptarë u atakua edhe qyteti i Prishtinës. Helmimi u bë edhe në bazë të kriterit të homogjenitetit kombëtar. Ishte krejt e qartë se në aspektin e organizimit të helmimit, më së lehti do të ishte që ky të bëhej në qytete dhe fshatra

të pastra etnike. Për këtë qëllim objekt helmimi ishte: Podujeva, Skënderaj, Malisheva, Suhareka, Vitia. Mirëpo për ta kamufluar këtë parim, në disa qytete helmimi bëhet edhe në ato me përkatësi të përziera nacionale. Kjo u bë me qëllim që të shtohet urrejtja në mes të popullatës shqiptare dhe të nacionaliteteve të tjera. Kështu në mbështetje të këtij parimi helmimi u bë në Fushë- Kosovë, Obiliq, Mitrovicë etj. Në seleksionimin e vendbanimeve për helmim, rol me rëndësi kishin edhe interesat strategjike të qyteteve dhe të vendbanimeve. Në bazë të këtij kriteri u helmua komuna e Podujevës. Kjo komunë bën pjesë ndër komunat që shumë shpesh ishte nën atakimin e helmeve kimike të luftës. Në këto qytete helmimi zgjati 29 ditë të plota (Podujeva me ndarje administrative pas vitit 1992 do të reduktohet në aspektin e pushtetit - organet ekzekutive gjyqësore do të transferohen në Kurshumli). Në bazë të këtij parimi është bërë helmimi në F.Kosovë, Obiliq, Vushtrri, Mitrovicë, etj. Disa qytete etnikisht të pastra shqiptare nuk u atakuan me helme. Ka shumë shpjegime dhe argumente pse këto qytete si p.sh. Gllogovci, Kaçaniku, Dragashi, Rahoveci si komuna homogjene etnike, nuk ishin objekt helmimi. Një nga faktorët kryesorë ishte aspekti i kamuflimit. Fjala është për strategjemë.

Do të ishte shumë transparente që me helmim të atakohen të gjitha komunat e pastra etnike shqiptare. Thënë shkurt, kjo pati efekt, se një kohë e gjatë u desh që të argumentohej se pati helmime dhe se këtë e bëri pushteti i ish-Jugosllavisë, kryesisht ish- APJ-ja.

Me helmin ishin të përfshira shumë institucione arsimore, objekte të tjera prodhuese, por pati raste që me helmim të atakohen edhe objekte kulturore sportive (halla e sporteve në Ferizaj). Me qëllim të vërtetimit të hipotezës gjenerale, të cilën e parashtruam në fillim të gjurmimit se do të analizojmë edhe strukturën e institucioneve të atakuara me helm.

Pasqyra e institucioneve të përfshira me helmime

Nr.	Komuna	Institucionet							Total
		P.sh.	Sh.f.	Sh.m.	Sh.l.	Gjithsej	Smarr-kult	Nder.pro.	
1	Ferizai	-	4	4	1	9	1	-	10
2	Giakovë	1	2	1	-	4	-	1	5
3	Prizren	-	4	3	-	7	-	-	7
4	Suharekë	-	2	1	-	3	-	1	4
5	Shtimie	-	1	-	-	1	-	-	1
6	Lipian	-	2	1	-	3	-	-	3
7	Viti	-	3	1	-	4	-	-	4
8	Giilan	-	1	2	1	4	-	-	4
9	Kamericë	-	1	1	-	2	-	-	2
10	Prishtinë	-	4	5	-	9	-	-	9
11	Obiliç	-	1	1	-	2	-	-	2
12	F. Kosovë	-	3	-	-	3	-	-	3
13	Podujevë	-	4	2	-	6	-	-	6
14	Vushtri	-	4	1	-	5	-	-	5
15	Mitrovicë	-	4	3	-	3	-	-	3
16	Skënderaj	-	3	1	-	4	-	-	4
17	Klinë	-	1	1	-	2	-	-	2
18	Malishevë	-	-	1	-	1	-	-	1
19	Deçan	-	1	1	-	2	-	-	2
20	Pejë	-	3	4	-	7	-	-	7
	Gjithsej	1	44	34	2	81	1	2	84


Nga kjo tabelë mund të konstatohet se me helmim në periudhën 1989-1990, në Kosovë janë përfshirë gjithsej 86 institucione. Prej tyre vetëm një institucion është i edukimit parashkollor, 44 janë shkolla fillore, 34 shkolla të mesme, 2 shkolla të larta, 1 institucion kulturor dhe 4 ndërmarrje ekonomike prodhuese. Nga 86 institucione të atakuara me helme kimike, 78 apo 95% janë institucione edukativo-arsimore, ndërsa vetëm 5 apo 4% janë institucione kulturore dhe ndërmarrje ekonomike prodhuese.

Në edukimin dhe arsimin parashkollor prej 25 institucioneve edukative arsimore sa ishin atë kohë në Kosovë vetëm në çerdhen

për edukimin parashkollor në Gjakovë është bërë helmimi i fëmijëve. Me fjalë të tjera 4% të institucioneve ishin përfshirë me helm nervore. Në shkollat fillore shkalla e institucioneve të përfshira me helmim, krahasuar me edukimin parashkollor shtohet dukshëm si në aspektin e institucioneve të përfshira me helmim ashtu edhe në aspektin e nxënësve. Në aspektin e institucioneve me helmim u përfshinë 41 shkolla fillore prej gjithsej 385 shkollave amë sa ishin në Kosovë në vitin shkollor 1989/90 (apo 10,9%). Kurse në edukimin fillor janë përfshirë me helmim 1903 nxënës, krahasuar me numrin e nxënësve shqiptarë në vitin shkollor 1989/90 atëherë del se nga numri i përgjithshëm i fëmijëve shqiptarë me helm u atakuan 7%. Në edukimin dhe arsimin e mesëm shkalla e përfshirjes së shkollave, ashtu edhe të nxënësve është më e madhe. Prej 55 shkollave sa ishin në vitin shkollor 1989/90, me helm u atakuan nxënësit e 34 apo 62% të shkollave të mesme. Intensitetin e helmimit sipas shkallëve të shkollimit dhe të lëmenjve punonjës e paraqesim në grafikonin, fq-107.

Grafikoni paraqet qartë qëllimin dhe mllëfin e Serbisë ndaj arsimit shqip. Nga kjo shihet se objekt kryesor i helmimit ishte arsimi dhe institucionet arsimore. Prej numrit të përgjithshëm të institucioneve të atakuara me helmim, 96% ishin institucione arsimore. Kjo njëherit tregon jo vetëm frikën e pushtetit serb nga shkolla shqipe, por edhe vërteton tezat dhe mendimet serbe, të cilat në shumë raste me deklaratata publike shprehin jo vetëm urrejtjen ndaj arsimit shqip në Kosovë, por edhe kundër shkollës dhe arsimimit të shqiptarëve të Kosovës. Sa për ilustrim do t'i përmendim vetëm mendimet e Vasa Pelagiqit, intelektual dhe ideolog i shquar serb, dhe të akademik Milosh Crnjanskit. Në vitin 1923 Nikola Pashiqi u thotë shqiptarëve të *"Xhemitit"*. *"Pranoj që xhandarmëria dhe kontrolli të përbëhet nga shumica shqiptare, që shqiptarët të inkuadrohen nëpunës në organet e shtetit, por kurrë*

Paraqitja grafike e numrit të institucioneve të përfshira me helmim



nuk pranoj që ju shqiptarët të mësoni në gjuhën shqipe. Po të pranoja këtë të fundit, atë çast do të vë piramidën dhe do t'ju uroj shtetin tuaj" (cit. sipas: 33.15).

Milosh Crnjanski, akademik serb, me rastin e themelimit të Universitetit të Kosovës, në vitin 1970, pat deklaruar: *"Mirë, të gjitha i kuptoj, por nuk mund të kuptoj përse hapni fakultete në Prishtinë. Çdo shqiptar i shkolluar është një armik më shumë për Jugosllavinë"* (20:16).

Nuk mund të ketë asgjë më makabër, më morbide dhe më çnjerëzore sesa të helmosh fëmijët e moshës trevjeçare, vetëm e


vetëm pse janë të këtij apo të atij kombi. Helmimi i shikuar në këtë aspekt mund të kuptohet vetëm si një vazhdimësi e një histerie patologjike të urrejtjes së nxitur dhe të programuar të ideologëve dhe të idelogjisë serbe ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

Struktura e të helmuarve sipas përkatësisë kombëtare

Projektuesit e këtij akti të krimit në skenar e kishin parashikuar që helmimi të bëhet kundër popullatës shqiptare në Kosovë, mandej edhe e kishin menduar që për këtë qëllim të bëhej ndarja e popullatës shqiptare nga kombet dhe etnikumet e tjera, në ato mjedise dhe institucione ku kjo ishte e përzier. Për realizimin e këtij qëllimi ishte parashikuar aparteidi dhe segregacioni, për të cilat u bë fjalë në faqet e përparme të këtij studimi. Mirëpo, përkundër përgatitjeve dhe elaborimeve deri në detaje, kjo në praktikë nuk u realizua ashtu siç e kishin menduar "kalorësit e apokalipsës". Me helme u atakuan edhe popullata serbe, malazeze, turke, myslimane dhe rome. Është e mundshme që me projekt të jetë parashikuar që me helme të atakohet edhe një numër i vogël i popullatës tjetër, qoftë me qëllim, qoftë pa qëllim. Po që se me skenar ka qenë i parashikuar atakimi me helme kimike të luftës edhe një pjesë e vogël e popullatës joshqiptare, kjo atëherë është bërë për arsye kamuflimi, përkatësisht me synim që helmimi të vishet me velin e misteriozitetit. Kjo bëhet me qëllim që eventualisht, në rast të konstatimit dhe vërtetimit se ky është helmim, atëherë helmosja e popullatës serbe do të "shfajësonte" pushtetin se kjo ishte "autore" e krimit të këtillë. Po që se popullata joshqiptare është atakuar pa qëllim, kjo atëherë është rezultat i veprimit të faktorëve të pakontrolluar, të cilët me siguri janë marrë parasysh nga projektuesit e dënimit për vdekje të ngadalshme, por sipas

mendimit të tyre të sigurt, të popullit shqiptar në Kosovë! Strukturën e të helmuarve, sipas përkatësisë kombëtare e paraqesim në grafikonin vijues:

Paraqitja grafike e numrit të të helmuarëve sipas përkatësisë nacionale



Grafikoni në mënyrë evidente dëshmon se helmimi nuk është plotësisht njëncional, siç kishin planifikuar agjentët e Beogradit. Aparteidi nuk mundi "t'u sigurojë" dhe "t'u garantojë" serbëve dhe malazezve se nuk do të helmohen. Ka shumë indikacione se numri

i serbëve dhe i malazezve të helmuar është shumë më i madh sesa dihet ky numër që është prezentuar në këtë tabelë. Serbët edhe kur paraqiteshin te mjeku, kryesisht kontrolloheshin nga mjekët serbomalazez. Këta me kohë kishin marrë instruksione që të mos u shënohej diagnoza e vërtetë. Për këtë dëshmon edhe rasti i pacientes serbe *D.S.* nga Obiliqi, e cila paraqitet te mjeku me të njëjtat simptome si të helmuarit shqiptarë. Mirëpo, mjeku serb Mihailoviq këtë e transferon në pavionin tjetër me pretekst se është e sëmurë nga zorra qorre. Në faksimilin e paraqitur lexojmë edhe këtë konstatim: "*... në momentin e bisedës me të, erdhi një pacient i nacionalitetit serb*".

Helmimi - një hallkë më shumë në zinxhirin e terrorit shtetëror mbi shqiptarët

Trajtimi shkencor i fenomenit të helmimit nuk mund të bëhet, nëse helmimin nuk e analizojmë në kuadër të dhunës së përgjithshme të pushtetit serb mbi popullatën shqiptare. Është evidente se helmimi i viteve 1987 -1990 është pjesë e pandarë e terrorit shtetëror. Në studimin e deritashëm është vërtetuar se helmimi ishte kryesisht i drejtuar kundër rinisë shqiptare. Shtrohet pyetja se ku qëndron kjo urrejtje ndaj të rinjve shqiptarë të Kosovës. Në këtë pyetje do të bëjmë përpjekje të japim një përgjigje të argumentuar.

Së pari, ky atakim monstruoz në rininë shqiptare ishte dhe është pasojë e ndjenjës paranoike nga gjoja nataliteti i madh i shqiptarëve. Së dyti, helmimi paraqet një vepër klasike gjenocidi në kuptimin e shfarosjes biologjike të shqiptarëve me mjete bashkëkohore kimike luftarake. Në shkallëzimin e krimeve kundër një etnikumi autokton dhe me traditë të lashtë qytetëruese, kjo është shkalla më e lartë dhe kulmi i piramidës së terrorit shtetëror, i cili

është i programuar dhe në funksion të krijimit të kushteve për zhdukjen definitive të shqiptarëve nga ky territor. Me realizimin e këtij qëllimi realizohet dhe aspirata e kahmotshme serbe për "përtërirjen e Mbretërisë së mbretit Dushan", si dhe të materializimit të ideve të Ilia Garashaninit, Vasa Qubriloviqit, Ivo Andriqit, Qosiqit, Sheshelit, Milosheviqit e shumë të tjerëve për Kosovën e pastër etnike serbe, pa shqiptarë. Në këtë aspekt helmimin objektivisht duhet kuptuar si njërën ndër hallkat e fundit të zinxhirit për realizimin e këtyre qëllimeve pas pastrimeve etnike, kolonizimeve, djegieve të fshatrave të tëra, masakrimeve, të kampeve të përqëndrimit të filluara në Nish dhe Leskoc, pas burgosjve, rrahjeve, maltretimeve, përjashtimeve nga puna, pas mbylljes së shkollave, aplikimit të segregacionit dhe të aparteidit, izolimeve, djegies së librave në gjuhën shqipe, konvertimit të dhunshëm të shqiptarëve në ortodoksë, ndalimit të përdorimit të gjuhës shqipe, ndërrimit të dhunshëm të toponimeve deri te vrasjet e programuara duke filluar nga fëmijët 6-vjeçarë deri te pleqtë 70-vjeçarë, etj.). Helmimi paraqet veprën më morbide dhe më kundërthënëse ndaj njerëzimit. Me fjalë të tjera, helmimi është bërë për qëllime politike dhe është në konceptet dhe në idetë fashisoide të Vasa Qubriloviqit, të epigonëve dhe të trabantëve të tjerë të tij antishqiptarë.

Në këtë aspekt helmimi paraqet vijimësi historike të dhunës dhe të terrorit serbo-malazez mbi popullatën tjetër. Në periudhën 1989-90 të atakuar me helme kimike të luftës të identifikuar janë 7469, (prej tyre 33 të helmuar kanë qenë në Klinë, në vitin 1989, 15 nxënës në shkollën e mesme të mjekësisë "*Boro dhe Ramizi*" në Prizren), ndërsa në vitin 1990 - 7421 janë të helmuar. Në këtë numër nuk janë llogaritur 28 nxënës të shkollës fillore "*Abaz Ajeti*", prej të cilëve 21 nxënës dhe 2 arsimtarë kanë qenë të shtrirë në spitalin e Fakultetit të Mjekësisë ("*Bujku*" f.5 dt. 22 mars, 1996)

(33.5). Nëpër spitalet e Kosovës dhe në ambulancat shëndetësore kaluan mbi 7400 të helmuar. Vetëm në komunën e Vushtrrisë, në periudhën 23 mars 2 prill të vitit 1990, në Shtëpinë e Shëndetit të këtij qyteti ndihmë mjekësore kërkuan 578 persona. Kjo shifër e të helmuarve, është konfirmuar nga komisioni i mjekëve të Shtëpisë së Shëndetit, të lëshuar më datën 2.4.1990. Nga ky numër i të helmuarve mbi 1650 kanë qenë të helmuar rëndë dhe janë shëruar me javë e muaj, bile edhe vite të tëra nëpër spitalet e Kosovës, Zagrebit, Lubjanës, Austrisë, Zvicrës, Francës dhe të Gjermanisë. Në pamundësi që të prezantohet lista e të gjithë të sëmurëve që kaluan nëpër spitalet e sipërpërmendura (kjo çështje është për një studim të veçantë) në vazhdim po prezantojmë një listë të vogël të nxënësve dhe të arsimtarëve të hospitalizuar në Spitalin e Prishtinës.

Pasqyra tabelare e disa prej nxënësve të helmosur të shtrirë në Spitalin e Prishtinës.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Ditët e kaluara në spital	Vend	Vërejtiet
1	Liamie Kadriu	Shumë ditë	Mitrovicë dhe Prishtinë	Vdiq
2	Enver Gashi	7 ditë	Prishtinë	
3	Petrit Ibrahim	30 ditë	Prishtinë	
4	Suleiman Sinani	24 ditë	Prishtinë	
5	Naser Breznica	23 ditë	Prishtinë	
6	Bairam Mulliqi	22 ditë	Prishtinë	
7	Avdush Tahiri	Shumë ditë	Zagreb	
8	Arlinda Vilasaku	Shumë ditë	Prishtinë	
9	Nerxhivane Xheladini	12 ditë	Prishtinë dhe Lubiane	Vdiq
10	Nazmi Bairami	14 ditë	Prishtinë	
11	Vehbi Zeqiri	10 ditë	Prishtinë	
12	Vešel Demi	Shumë ditë	Gjilan dhe Prishtinë	Vdiq

Të helmuarit të cilit u shëruan nëpër spitale janë edhe një dëshmi e cila përgënjeshton tezat serbe për gjoja teatralizëm kolektiv.

NUMRI I TË HELMUARVE SIPAS KOMUNAVE

Nga 28 komuna, sa ishin në vitin 1990 në Kosovë, 20 prej tyre apo 71% u përfshinë me helmim. Numri më i madh i të helmuarve, siç u tha, ishte në komunën e Ferizajt. Natyrisht, kjo shihet në tabelën dhe në grafikonin e paraqitur. Me qëllim të paraqitjes sa më objektive të helmimit në vazhdim do të prezentohen rezultatet e studimit dhe të gjurmimit të numrit të të helmuarve sipas komunave duke filluar nga komuna e Ferizajt.

Helmimi në komunën e Ferizajt

Ferizaj është një ndër komunat me numër më të madh të nxënësve dhe të banorëve në territorin e Kosovës. Në aspektin gjeografik është karakteristike sepse Ferizaj paraqet një qendër të rëndësishme të lidhjes së Kosovës me Maqedoninë, (përmes Shkupit me Bullgarinë, Turqinë dhe Greqinë, përmes Prishtinës me Serbinë jugperëndimore, ndërsa përmes Gjilanit me Serbinë juglindore përkatësisht me Kosovën verilindore (Preshevë etj). Është qytet i ri. Banorët e tij me shumicë absolute janë shqiptarë edhe pse nëpër fshatra ka disa enklava të vogla serbe. Me helmim, pos qytetarëve në këtë komunë, u përfshinë edhe këto institucione, pasqyrën e të cilave po e japim në vazhdim.

Pasqyra e institucioneve të komunës së Ferizajt të përfshira me helmim

Nr	Emërtimi i institucioneve	Të helmuar	
		Numri	%
1	Sh.f. «Peko Tepavceviq»	81	8.7
2	Sh.f. «25 Maji»	91	9.8
3	Sh.f. «G. Tërbeshi»	18	1.9
4	Sh.f. «Tefik Canga»	35	3.8
	Gjithsej	225	24.2
5	OAMO «Josip B. Tito»	215	23.1
6	Sh.m. ekonomike «Moshë Piiada»	254	27.2
7	Sh.m. «Zenel Hajdini»	108	11.6
8	Oendra teknike «N. Tesla»	28	3
	Gjithsej	605	64.9
9	Oendra e Arsimit të Lartë	7	0.7
10	Halla e Sportit - koncert	94	10.1
	Total	931	100

Që të mund të informohej opinioni për veprën gjenocide të helmimit, u penguan edhe mjetet e informimit. Sipas të gjitha gjasave, në pajtim me skenarin e hartuar me kohë, në Ferizaj ishte inskenuar «dëmtimi» i antenës së Radiostacionit lokal më 22 mars 1990.

Si duket, ky dëmtim ishte bërë me qëllim që lajmi për helmimin të mos publikohej me të, por përmes gazetës në gjuhën serbe «Jedinstvo». Të gjithë të helmuarit në ditët e para u paraqitën dhe kërkuan ndihmë mjekësore në Shtëpinë e Shëndetit, ndërsa rastet më të rënda në Spitalin e Prishtinës, Shkupit, Zagrebit, e Zyrihut... Ndër rastet e rënda ishte ai i të riut *Dushan Damjan Dajiq*. Për këtë të sëmurë është incizuar edhe videokaseta. Në komunën e Ferizajt qytetarët u helmuan edhe në sallën e sporteve me rastin e një koncerti me këngë dhe valle popullore. Këtyre të helmuarve (shumica e qytetarëve të helmuar, ndër ata 94, janë të helmuar në sallën e sporteve) ndihmë të pakursyer u dha mjeku serb Milan

Milosheviq, i cili veproi në pajtim me kodeksin e mjekut dhe me porosinë e Hipokratit. Ky nuk iu bind urdhresave të policisë që të ndalte ndihmat ndaj të helmuarve. Dr. Milani, jo vetëm që e kundërshtoi, por edhe «e përzë» policinë, e cila turrej t'i maltretonte të helmuarit dhe ta pengonte ndihmën e mjekut. (33:71). Pos këtij, ndihmë të pakursyer dhanë edhe mjekët e tjerë serbë si Dushan Nikoliqi dhe Slavica Stojanoviqi.

Për emisionin në gjuhën shqipe të Radio-Zagreb

Hamburg, 26 qershor 1990

Rasti i helmimeve të të rinjve shkollarë të Kosovës, nga pushteti serbo-sllav, punëtorët tanë me punë dhe qëndrim të përkohshëm në shtetet e Evropës Perëndimore i pikëlloi shumë. Për këtë me nisativën e Frrok Kristajt e të *Shaban Bërbatovcit*, arsimtarë të shkollës me mësim plotësues në gjuhën shqipe «*Fan Noli*» të Hamburgut, u ndërмор aksioni për grumbullimin e mjeteve që t'u dilet në ndihmë të helmuarve, por edhe punëtorëve të RTV të Prishtinës dhe punëtorëve të ndërmarrjes ndërtimore «*Ramiz Sadiku*» po ashtu në Prishtinë.

Kështu, në lokalin hotelier të *Gjon Markajt* në Wiensen Luche (afër Hamburgut) u mbajt tubimi i hotelierëve shqiptarë të Hamburgut, të cilët hapën kuletat dhe grumbulluan 45 mijë DM, për ilaçe kundër helmimeve, pastaj për punëtorët e RTV të Prishtinës u grumbulluan 25 mijë DM dhe për punëtorët e «*Ramiz Sadikut*» - 10 mijë DM. Shumën më të madhe të mjeteve e dhanë *Gjon Berisha, Gaspër Bisaku, Gjon Markaj, Pjetër Markaj, Gjon Tuniqi, Tush Bisaku, Engjëll Spaçi, Daniel Berisha, Zef Karaçi,*

Xhelil Musa, Pal Buçaj, Riza Kurteshi, Xhemali Beadini, Ali Morina e të tjerë, por edhe anëtarët e klubit shqiptar «Kosova» të Hamburgut.

Me mjetet e grumbulluara për ilaçe kundër helmimeve u blenë medikamente dhe të njëjtat iu dërguan shoqatës bëmirëse humanitare «*Nëna Tereze*» të Kosovës, por iu dorëzuan Kishës Katolike në Binçë të Vitisë së Kosovës. Ndërkaq, mjetet për punëtorët e «*Ramiz Sadikut*», në formë të materialit ushqimor iu dorëzuan organeve të kësaj ndërmarrjeje, kurse mjetet për RTV e Prishtinës, për shkak se pushteti policor serb e kishte okupuar këtë institucion, nuk u dorëzuan, por të njëjtat, me pëlqimin e donatorëve, u orientuan në Fondin e LDK-së në Aachen të Gjermanisë.

Kumtesë e klubit shqiptar "Kosova" në Hamburg

Në komunën e Ferizajt, si në komunat e tjera, pas krimit të gjenocidit të bërë përmes helmimit, lajmi mori dhenë dhe u përhap në botë. Sipas skenarit, në skenë paraqitet policia serbe, e cila, pas datës 23 mars, fillon të pengojë të helmuarit të shkonin nëpër spitale, ndërsa ata që ziheshin dërgoheshin në stacionet policore dhe maltretoheshin në mënyrë brutale. Policia serbe jo vetëm që pengonte ndihmën mjekësore për të helmuarit, por maltretonte të gjithë ata të cilët ofronin ndihmë. Kështu, në komunën e Ferizajt për shkak të «fajit» se ishte i helmuar: «...edhe vetë (...) merret në shqyrtim nga policia dhe maltretohet brutalisht» *prof. Fahredin Haxhimusa*!!! (32:71). Pas datës 23 mars 1990, policia nuk lejon të helmuarit të vendosen në Prishtinë, por vetëm në Shkup (cit.sip.32:71).

Në komunën e Ferizajt, ndër rastet më të rënda ishin rastet e *Hanife Salihut* (është shëruar në Zvicër dhe Gjermani), *Hazbije*

Ratkocerit, Dushan Damjan Dajiqit etj. Pos këtyre, rastet më të rënda kaluan nëpër spitalet dhe ambulancat shëndetësore të Kosovës, Zagrebit, Lubjanës, Zyrihut, Frankfurtit, në spitale të improvizuara, në kishat katolike në Ferizaj dhe Binçë. Mbi 900 të helmuar, kryesisht nxënës, studentë dhe qytetarë shqiptarë, u shtruan nëpër spitale, ambulanca të improvizuara, etj.

Ndihmë të pakursyer në shërimin e të helmuarve, në zbutjen e dhëmbjeve të mëdha dhe të padurueshme dhanë edhe atdhetarët dhe humanitarët e kishave të përmendura katolike, misionarët dhe zoti Dom Lush Gjergji, dhe kapelani i kishës së Ferizajt Lucian Augustini. Më 4 gusht 1990 Augustini vjen nga Lucerni i Zvicrës në Ferizaj me një sasi barnash, me lejen e Këshillit Ekzekutiv Federativ dedikuar varfënjakëve dhe të helmuarve. Me të marrë vesh policia serbe e Ferizajt, përkundër dokumentacionit që e kishte në rregull, me shpejtësi e bastis kishën dhe i merr barnat. Për këtë shkak më 9 gusht 1990 merret në polici në bisedë informative. Pos bastisjes së kishës katolike në Ferizaj, bastiset edhe kisha katolike në Binçë. Ndihmë të madhe të helmuarve u japin edhe Jela Anxheliq, Mirjana Gojeviq, Dile Gega, Sofije Kola, Melanie Cvrtak, Dobroslava Eriq (33 : 91).

Për shkak të ndihmës së ofruar, shtypi serb organizon një fushatë të madhe kundër humanitarëve dhe misionarëve të kishave katolike në Binçë dhe në Ferizaj. Për këtë luftë të ndytë dhe të panjerëzishme mediale dhe për shkak të raprezalieve policore ndaj misionarëve katolikë reagojnë ashpër ipeshkvi z. Nikë Prelaj dhe kardinali Franjo Kuhariq. Kuhariq, pos tjerash, shkruan: «*A është krim ofrimi i ndihmës njerëzve të sëmurë? Të bësh mirë a do thotë të bësh keq. Çfarë është ai civilizim dhe çfarë është ajo politikë?*» (cit. sip. 33:91).

Në komunën e Ferizajt, në institucionet e përmendura, nëpër spitale, nëpër spitalet e improvizuara në Binçë dhe në Kishën

Katolike në Ferizaj kaluan: *Adelinë Bejta, Agim Miftari, Avni Rrustemi, Arjeta Shabani, Burim Qorolli, Blerim Mehmeti, Besim Salihu, Bukurie Elezi, Edi Dërguti, Elizabeta Aliu, Fevzije Ademi, Feti Jashari, Fikrije Ademi, Flutur Bilalli, Florie Qalaj, Fahrije Tasholli, Fitnete Bajrami, Hanife Salihu, Hanmije Gashi, Hazbije Kryeziu, Hamide Rexhepi, Kadire Pireva, Kefsere Ukshini, Lulëzim Isufi, Mirvete Sahiti, Merrushe Halili, Mejreme Berisha, Manushaqe Reçica, Mysere Hoxha, Melvedete Osmani, Mimoza Berisha, Merishahe Qerkini, Nexhmije Matoshi, Qefsere Mehmeti, Refik Sadriu, Sakibe Qerkini, Sizan Ismajli, Shpresa Bibaj, Shpresa Hajdini, Vlora Bajraktari, Vlora Ferati, Valbona Beqiri, Vahide Rrustemi, Valbona Hakiu, Valdete Nebihu, Zanfina Ahmeti, Zyrafete Ahmeti, Arife Tërstena, Arben Retkoceri, Antigona Sopa, Afërdita Maloku, Bujar Zaskoku, Bekim Maloku, Flora Mumini, Kumrije Hyseni, Kumrije Salihu, Lavdim Hasani, Lutfi Zuka, Magbule Bytyqi, Melihate Ymeri, Merita Hajdini, Mejreme Bislimi, Nyredin Alijaj, Sevdije Ibrahim, Ramadan Dushica, Vjollca Ymeri, Xhylije Rudari, Zylfije Hajdari, Zele Ibrahim, Miradije Murtezi, Avni Hajdari, Naim B. Sahiti, Naim M. Sahiti, Shpresa Shahini, Ali Krasniqi, Avni Kashtanjeva, Bahrije Ramadani, Bekim Musliu, Besa Uruqi, Driton Sojeva, Florije Dërguti, Ganimete Rexhepi, Hidajete Hajdari, Hamdije Ahmeti, Hidajete Ahmeti, Kujtime Papazi, Luljeta Musliu, Lavdim Hasani, Lendita Shabani, Magbule Arifi, Myrvete Rushiti, Makfire Sulejmani, Merita Qerimi, Merita Abdullahu, Merita Rafuna, Nyzifete Neziri, Ragip Sahiti, Shyhrete Hajrullahu, Shqipe Tahiri, Sherafedin Topalli, Valdete Ahmeti, Vjollca Baliu, Valbona Aliu, Ylber Ramadani, Xhylsime Rexha, Xhylsime Azemi, Zyhra Sadiku, Zyrafete Ahmeti, Ajshe Tërshana, Nysret Ibrahim, Hajriz Rexhepi, Artan Luri, Astrit Shabani, Blerim Bucaliu, Bujar Zariqi, Behar*

Mehmeti, Bukurie Aliu, Erton Hoxha, Hyrije Murseli, Refije Bytyçi, Kumrije Shemsiu, Liridon Jakupi, Lumnije Bajçinca, Mevlude Hajdari, Merita Bajrami, Nexhat Sejdiu, Nazmije Bajrami, Melihate Osmani, Syzana Bajrami, Sead Rushiti, Xhafer Hajdari, Arlinda Tërshana, Afërdita Hysenaj, Burim Tërshana, Balvana Aliu, Besa Hajdari, Fitore Ramadani, Florijeta Bega, Fatmir Musa, Flamur Bugolli, Luljeta Aliu, Lumnije Jakupi, Mirvete Aliu, Nebahate Selimi, Nazmi Uksmajli, Learta Ajeti, Selvije Halimi, Selmane Tafili, Teuta Shkodra, Valdet Osmani, Zyrije Hajdari, Agron Uksmajli, Agron Zhitia, Ajshe Kçiku, Azem Murati, Bekim Govori, Bedri Beqiri, Besnik Elezi, Besim Braha, Bekim Maloku, Basri Bilalli, Bajram Rama, Dushan Dajiq, Danush Bega, Esat Zymberi, Enver Hashani, Enver Galiqi, Ebdije Isufi, Emin Arifi, Feriz Ferizi, Florije Ajeti, Fikri Kurteshi, Fitim Salihu, Fikrije Topalli, Fadil Tasholli, arsimtarët: Habib Bucalieu, Halime Zymberi, Hajdin Rexhepi, Hajrulla Qosa, Hamit Zariqi, Hajdin Qamaj, Imrane Sfarça, Jeton Bega, Minaver Goga, Muhabi Osmani, Milaim Muhaxheri, Muhamet Xhemajli, Murtez Salihu, Munipe Berisha, Nazmi Qerimi, Nexhat Dalipi, Nijazi Topalli, Nazmi Nushi, Nazmi Dema, Nehat Myrseli, Ramush Uka, Rejhane Halili, Ruzhdi Azemi, Rifadije Aliti, Sabrije Dugolli, Safete Mehmeti, Safete Haliti, Sejdi Neziri, Sheride Shabani, Vël-laznim Nimani, Valdet Raçi, Xhevahire Sahiti, Xhemile Avdiu, Xhafer Bajrush, Merita Sallahu, Xhezide Shala, Gyltene Krasniqi, Jeta Ibrahim, Nerimane Selimi, Afërdita Hysenaj, Vjollca Salihu, Drita Shabani, Arlinda Hasimi, Zyrje Hajdari, Teuta Dalipi, Bahrije Fejza, Luljeta Uka, Mexhide Murseli, Florijeta Bega, Vjosa Beqiri, Shpresa Uka, Lumnije Tafolli, Fikrije Ferati, Nazlije Curri, Sanije Musliu, Selvete Dugolli, Selvije Asllani, Ariana Zejna, Faton Aliu, Senada Ahmeti, Mehreme Duga, Njomëza Maloku,

Lëndita Stublla, Imrane Bilalli, Syrije Qerimi, Minire Sefa, Shqipe Bega, Besa Sejdiu, Silvana Halili, Luljeta Maloku, Teuta Shkodra, Magbule Bega, Lumnije Jakupi, Florineta Maliqi, Lirije Haziri, Teuta Asllani, Shqipe Abazi, Fatmire Musa, Zyrafete Halili, Arijeta Avdiu, Albana Salihu, Shqipe Tahiri, Makfire Hasani, Feime Toshi, Rukije Hashani, Zyrafete Maloku, Shkëndije Ramadani, Arijeta Ramadani, Afërdita Aliu, Nazmije Uksmajli, Lendita Tafolli, Afërdita Beqiri, Merita Ibishi, Emine Ibishi, Shukrije Kurti, Jalldyze Aliu, arsintare, Bukurije Aliu, Ganimete Salihu, Merita Hashani, Bahrije Retkoceri, Ilir Salihu, Zylbehar Misini, Sevdije Idrizi, Valbona Bislimi, Ferdine Emine, Fiza Bytyçi, Selvere Baraliu, Bukurije Bajrami, Shefkije Bytyçi, Igballe Bytyqi, Kefsere Demiri, Përparim Osmani, Elvira Haxhiu, Teuta Rifati, Sebahate Azemi, Leonora Avdiu, Ardonika Xheladini, Fetihe Jashari, Mimoza Prekadini, Fisnik Bytyqi, Ganimete Topalli, Sadbere Jashari, Valbona Sahiti, Lendita Ajeti, Lumnije Buçinca, Lendita Hajrullahu, Teuta Hoxha, Zyrafete Shala, Vlora Tahiri, Valbona Fetahu, Arben Sahiti, Nazmije Vrella, Ganimete Huruglica, Leonora Avdiu, Xhemile Sahiti, Valbona Sadiku, Nazmije Buçinca, Blerim Hoxha, Besim Arifi, Shqipe Bajrami, Sheribane Ahmeti, Arijana Qelaj, Lendita Ramadani, Zylfije Shabani, Valdete Hamiti, Sindyze Buçinca, Nadije Islami, Hazbije Retkoceri, Shyhrete Cakolli, Selvete Xhemajli, Agron Aliu, Mexhide Sefedini, Shahe Jashari, Feride Abdyl, Zejnepe Fuga, Blerim Buçinca, Elgedaf Ramushi, Afërdita Rrustemi, Drita Nuhiu, Kumrije Shemsiu, Agron Mehmeti, Bekxhizare Misini, Sibavere Fetahu, Selvere Hamiti, Shukrije Ratkoceri, Shpresa Ramadani, Valbona Ratkoceri, Bahtije Sopa, Melihate Osmani, Xhafer Hajdari, Elvira Llugiqi, Burim Berisha, Teuta Asllani, Albana Salihu, Shqipe Tahiri, Fitnete Rexhepi, Teuta Qalaj, Vlora Bajraktari, Shqipe

Tafaj, Lendita Musa, Lendita Tafolli, Afërdita Beqiri, Shqipe Abazi, Merita Hasani, Ganimete Sylva, Arbëresha Dabinovci, Kefsere Ukshini, Afërdita Aliu, Syrije Qerimi, Zyrafete Shala, Hazbije Kryeziu, Fatime Mehmeti, Fatmire Hashani, Lendita Miftari, Shpresa Murati, Flora Ferati, Hamide Hashani, Hamide Rexhepi, Shpresa Bajraktari, Valbona Beqiri, Selvete Rexhepi, Ganimete Salihu, Shpresa Murati, Besa Babinovci, Bedrije Bilalli, Adriana Qorolli, Hydajete Bytyçi, Valbona Isufi, Venera Isufi, Sahadete Limani, Vlora Zeqa, Ibadete Bekteshi, Arsim Haliti, Havushe Kurti, Kefsere Lekiqi, Lulëzim Emërllahu, Shpresa Ahmeti, Shemsije Januzi, Ilirjana Maloku, Lumturije Reçica, Kadire Reçica, Hilkiye Shala, Leonora Sojeva, Florije Haliti, Elmije Haziri, Vlora Haxhimusa, Afërdita Beqiri, Ilirjana Berisha, Lirije Ahmeti, Myrvete Sahiti, Lulëzim Emërllahu, Bafta Fejzullahu, Adem Hasani, Jetish Rrafshi, Florije Sadiku, Fitnete Haliti, Florije Ademi, Xhevahire Prushi, Jasere Abdullahu, Violeta Xhaferi, Valbon Rusi, Arjeta Qerkini, Dëshire Sulejmani, Lirije Sulejmani, Sanije Grainca, Valbona Ademi, Mursel Ismaili, Nerxhivane Sejdiu, Afërdita Jakupi, Ibadete Berisha, Leonora Tafolli, Igballe Sallaj, Njomëza Maloku, Lulëzime Kryeziu, Milikije Ismaili, Hyrmete Rushiti, Vahide Rrustemi, Nexhmije Matoshi, Lendita Hyseni, Enver Sadriu, Ridvan Hasani, Fevzije Ademi, Melihate Imeri, Fitore Musa, Valdet Shehu, Zyhrije Rrahmani, Leonora Ibrahim, Njomëza Fejzullahu, Pakize Mehmeti, Valbona Sallahu, Besim Ismaili, Merushe Halili, Mejreme Berisha, Lutfije Misini, Hatixhe Bucaliu, Fikrije Topalli, Imrane Miftari, Zija Neziri, Agron Ratkoceri, Arijeta Zharku, Bashkim Guta, Qamile Salihu, Melihate Mehmeti, Vjosa Mehmeti, Kimete Rexhepi, Kadrije Shattrolli, Valbona Rexhepi, Ilire Sadiku, Ibadete Begisholli, Lumturije Murati, Xhemile Lekaj, Esat Zymberi, Arbënore Qazimi,

Sebahate Kurtaliqui, Shpresa Neziri, Haxhere Metaj, Feti Ramadani, Merita Halili, Rufkije Bakolli, Shqiponja Qorolli, Sevdije Mustafa, Milikije Qorolli, Myrvete Jetishi, Valbona Hoxha, Naim Shkodra, Selvete Musliu, Lendita Lelolli, Valbona Guri, Vjollca Zeqiri, Elife Shala, Bahrije Sejdiu, Fatime Sahiti, Afërdita Shabani, Valdet Hyseni, Ekrem Salihu, Sebahate Lika, Valbona Rushiti, Valdete Hasani, Merita Berisha, Bukurije Nishori, Shqipe Ratkoceri, Fatbardha Muharremi, Ibadete Dardhishta, Razire Ismajli, Fevzije Hashani, Igballe Gashi, Hidajete Gashi, Zyrafete Ismaili, Mevlyde Sojeva, Leonora Bajraktari, Hamdije Hamza, Afërdita Rrahmani, Drita Topalli, Hanife Ahmeti, Kujtime Papazi, Nafije Qallaj, Vlora Rexhepi, Luljeta Qerimi, Dhurata Meha, Valdete Meha, Kosovare Meha, Bedri Sejdiu, Hidajete Kqiku, Violeta Muhaxheri, Ibadete Isufi, Luljeta Hajdini, Avdije Nebiu, Vlora Murati, Arjeta Dauti, Teuta Shabani, Leonora Reçica, Shukrije Rexhepi, Nysret Ibrahimimi, Ganimete Kashtanjeva, Arben Rexhepi, Afërdita Sulejmani, Drita Qamili, Kefsere Qerimi, Izajete Bucaliu, Luljeta Osmani, Afërdita Gashi, Lendita Sojeva, Hanife Reçica, Shyhrete Hajrullahu, Mehdije Shabani, Kimete Bekteshi, Ganimete Rexhepi, Dashurie Syla, Kujtime Arifi, Merita Rexha, Florije Krasniqi, Violeta Prushi, Nebahate Hyseni, Behare Sadriu, Nebahate Selimi, Fehmi Sulejmani, Violeta Beqiri, Laura Sopa, Arta Luri, Teuta Delolli, Fatime Cakoli, Bukurije Selimi, Xhyle Salihu, Dashurije Mërseli, Teuta Nikolla, Elife Ademi, Shehize Topalli, Gyltene Abdyli, Vlora Salihu, Xhemajl Asllani, Luljeta Baliu, Osman Osmani, Lebibe Krasniqi, Violeta Avdiu, Besa Miftari, Merita Isufi, Elife Buçinca, Elife Ramusa, Ilirjana Bejtullahu, Lumturije Hyseni, Kimete Rexhepi, Mevlude Ramiqi, Leonora Gjergji, Nyzefete Neziri, Ylber Zeqiri, Hamdi Lipovica, Nexhmedin Ajvazi, Agron Salihu, Val-

bona Dervishi, Sebahate Rexha, Fatmire Beka, Suzan Musliu, Shpresa Ibrahim, Valbona Musliu, Basri Ibrahim, Lendita Hashani, Safet Haziri, Shyqrie Reshani, Avdije Beqa, Afërdita Xhemshiti, Safete Shkodra, Imrane Salihu, Bashkim Sadiku, Faton Qerimi, Ejup Goga, Valbona Hoxha, Ilirjana Zejna, Baftije Haziri, Hanumshahe Rexha, Xhylsime Rexha, Syndyze Maloku, Qefsere Gashi, Zejnije Hashani, Luljeta Mehmeti, Drita Grainca, Ismet Krasniqi, Antigona Tahiri, Fatmire Sadiku, Ymrane Sfarça, Havushe Arifi, Hatixhe Ahmeti, Halime Lubova, Nurije Gashi, Vlora Sahiti, Kimete Zeqiri, Drita Latifi, Xhylberte Rexhepi, Zarife Terziu, Selvije Sahiti, Hivzi Haliti, Haxhere Rexha, Naile Goga, Arife Tërstena, Afrije Fejzullahu, Emine Kashtanjeva, Xhevahire Rexhaj, Lutfije Ramusholli, Lule Shabani, Heset Fejzullahu, Naim Shabani, Nazlije Ahmeti, Lendita Shabani, Ruzhdi Halili, Sadije Sejdiu, Avni Kashtanjeva, Atifete Nuhiu, Drita Abdyli, Kimete Shatrolli, Melihate Rrahmani, Shqipe Marevci, Fikrije Mehmeti, Valdete Hoxha, Avni Berisha, Arben Demiri, Bujar Avdiu, Fadil Mani, Hazbije Syla, Nexhmije Shabani, Ymrane Avdiu, Merita Abdullahu, Makvire Nazifi, Merita Abazi, Sanije Goga, Jasmina Stublla, Hanumshahe Halimi, Hidajete Hajdari, Melihate Shabani, Minavere Hasani, Nebahate Shabani, Nerimane Stublla, Florije Lohaj, Fatime Lohaj, Sahadete Mulliqi, Zylfije Bytyqi, Kemajl Demiri, Bukurije Lutfiu, Ervahe Veliu, Sevdail Abdullahu, Afërdita Rama, Sebahate Prekadini, Suzana Slishani, Afërdita Aliu, Afërdita Maloku, Emine Maloku, Mejreme Mehmeti, Valbona Sadiku, Suzana Bajrami, Dashurie Agushi, Ardijan Sadiku, Mirlinda Musa, Igballe Cakolli, Ibadete Topalli, Ibadete Salihu, Gafurr Kashtanjeva, Shukrije Kurti, Zyfer Berisha, Lumnije Aliu, Sevdije Veseli, Ibadete Ymeri, Hazbije Ramadani, Lendita Haliti, Letafete Lohaj, Zylfije ..., Bashkim Beqiri, Bedrije Ratkoceri, Lirije

Haziri, Lirije Mustafa, Lirije Qalaj, Mexhide Topalli, Adnan Sadiku, Florim Osmani, Naim Nuhaj, Mejreme Bislimi, Hazbije Beka, Florineta Maliqi, Lëndita Musliu, Sebahate Bajrami, Sheride Sadiku, Veli Ibrahim, Shqipe Gashi, Burim Isufi, Fadil Kadriu, Safete Ramadani, Blerim Mehmeti, Shkurte Sadriu, Shpresa Halimi, Luljeta Mjaku, Veli Ibrahim etj.

Për traumat e shumë familjeve shqiptare, fëmijët e të cilave u helmuan dëshmon edhe kjo deklaratë e prindit Shukri Ratkoceri.

- Ishte muaji mars kur në vendin e punës më informuan se vajza ime Hazbija ishte helmuar në shkollë bashkë me disa shoqe të tjera të klasës së saj. Menjëherë qytetarët e kishin dërguar në ambulancë, ku kishin marrë udhëzimin për në Prishtinë, por përpjekja për të hyrë në spital kishte qenë e kotë, sepse policia, jo vetëm që s'ka lejuar, por e kishte rrëmbyer për flokësh dhe e kishte përplasur për tokë, duke e akuzuar se po teatronte. Si mund të teatrojë dhe të gënjejë një fëmijë fillorist...Gjatë shtatë rasteve të tjera të hedhjes së helmit në shkollën fillore «25 Maj», ku nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit kishin parë të hidhnin helmin një herë një ushtar, dy herë policë serbë, dy herë nxënëse të vogla serbe, një herë arsimtari i gjuhës serbe dhe një herë tjetër shtëpiakun tjetër serb të shkollës. Sa herë ishte hedhur helmi në shkollë, oborri i saj ishte i mbushur me policë serbë. Që të 7 herat e sëmundjes së vajzës sime në shkollë qytetarët e kishin dërguar në ambulancë dhe në kishën e Binçës. Sipas pohimeve të mjekëve dhe incizimeve filmike supozohet se vajza ime është më e dëmtuara ndoshta në Kosovë. Recidivet e helmeve në vajzën time kanë vepruar aktivisht nga 20 minuta deri edhe në 6 orë të plota të alivanosjes. Në dy muajt e parë kohëzgjatja e helmit ka qenë dy herë në javë me nga tri orë, pastaj në 4 muajt e tjerë përsëritjet janë bërë për çdo ditë me kohëzgjatje nga një orë ndërsa në 6 muajt e mëvonshëm përsëritjet janë bërë edhe me nga dy deri në katër herë në ditë.

Para sëmundjes vajza zakonisht e parandien atë dhe kërkon prej nesh që ta shoqërojmë dhe t'i bëjmë një masazhë për një kohë të caktuar. Në rastin e alivanosjes ajo shkul flokët, i skuqet fytyra, qet shkumë nga goja, klith me zë të lartë dhe me fuqi të trishtueshme, bën lëvizje të mëdha të duarve dhe të këmbëve me forcë të madhe sa 3 veta mezi e mbajmë (pastaj i shfaqet lemëza, shtangohet dhe i dridhet trupi, gjëmon dhe qan me zë të lartë që nuk mund të përshkruhet. Jam ushqyes i nëntë anëtarëve, pa pagë kurse vajza ka nevojë për ushqim korrekt që vështirë ia siguroj. Sipas supozimit të mjekëve gjendja e saj mund të jetë e tillë afërsisht edhe 5 jet (cit. sipas 33: 78-79).

Shukri Ratkoceri,

12.3.1992

Rr. «Jeremije Zherajiq», nr. 11, Ferizaj

Helmimi në komunën e Gjakovës

Gjakova është komunë në pjesën jugore të Kosovës. Popullata e saj është kryesisht shqiptare, me një numër simbolik serbësh dhe malazezësh. Kjo komunë ishte një ndër komunat në të cilat helmimi u bë me një intensitet dhe masivitet tejet të madh gjë që mund të konstatohet edhe nga tabela vijuese.

Pasqyra tabelare e numrit të helmuarve në komunën e Gjakovës sipas institucioneve

Nr.	Emërtimi i institucioneve	Të helmuar	
		Numri	%
1	Oendra për Edukimin Parashkollor	7	1.1
2	Sh.f. «Vojo Llakeviq»	118	18.9
3	Sh.f. «Boro e Ramizi»	51	9.3
	Gjithsei në shkolla filllore	169	27.1
4	Sh.m. «Hajdar Dushi»	161	25.9
5	Fabrika «Ermin Duraku»	249	39.9
6	Të tjerë	38	4.8
	Total	624	100

Në aspektin e helmimit komuna e Gjakovës dallon nga shumica e komunave të tjera, sepse në këtë komunë helmimi është bërë edhe në Qendrën për Edukimin Parashkollor. Me atë rast janë helmuar shtatë fëmijë të moshës nën shtatëvjeçare. Meqë këta fëmijë të helmuar paraqesin një specifikum, do t'i shënojmë jo vetëm emrat, por edhe datëlindjen si dhe përkatësinë kombëtare. Fëmijët e helmuar në institucionin parashkollor janë: 1. *Jasmina Lokaj*, e lindur më 1986, (shqiptare), *Igor Gashiq*, i lindur më 1987 (malazez), *Liridona Kusari*, e lindur më 1986 (shqiptare), *Valbona Hoti*, e lindur më 1986 (shqiptare), *Kreshnik Hoti*, i lindur më 1986 (shqiptar) dhe *Driton Haraqia* i lindur më 1986 (shqiptar). Siç mund të konstatohet, nga shtatë fëmijët e helmuar të moshës 3-4 vjeçare, 6 janë shqiptarë e një malazez. Malazez është *Igor Gashiqi*, fëmijë 3-vjeçar. Ky fëmijë ishte më i riu me moshë nga 7421 të helmuarit e identifikuar. Më i vjetri është *Alush Beqiri* nga Mitrovica, i cili ishte 66 vjeç.

Është me interes të shtrohet pyetja: Pse vetëm në komunën e Gjakovës u helmuan fëmijët e institucionit parashkollor. Kjo me gjasë u bë për shkak të përbërjes së strukturës kombëtare të qytetarëve të Gjakovës, ku mbi 99% të banorëve janë shqiptarë. Ky fakt është, në aspektin statistikor, irelevant, sepse gjasat për të pësuar ndonjë fëmijë i nacionalitetit serb ishin të vogla dhe silleshin rreth 1%. Mirëpo, siç ndodh shpesh herë, edhe në përqindjet statistikisht të parëndësishme, është dashur të realizohej mu ajo që nuk është parashikuar. Pikërisht kjo ndodhi në këtë institucion. Të gjithë fëmijët e helmuar u hospitalizuan në Spitalin e Gjakovës, në mesin e tyre edhe fëmija malazez *Igor Gashiqi*.

Gjakova ka edhe një karakteristikë tjetër, e cila këtë e dallon nga komunat e tjera, me përjashtim të Suharekës dhe të Vushtrrisë. Në komunën e Gjakovës u helmuan edhe punëtorët e ndërmarrjes

«Emin Duraku». Në këtë ndërmarrje u helmuan 259 punëtorë. Komisioni Ndërkombëtar i përbërë prej dr. Çarls Grejvs (Komisioni Ndërkombëtar i Punëtorëve Shëndetësorë për të Drejtat Shëndetësore dhe të Njeriut), Zonja Irene Graf (Lidhja Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë e Popujve) dhe dr. Zhan Zhak Kirkijarian (Lëvizja kundër Racizmit dhe për Miqësinë mes popujve), i cili vizitoi Kosovën në korrik të vitit 1990, me ftesën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në Prishtinë. Në raportin e tyre dërguar OKB-së, jo vetëm se kërkojnë që misioni i ekspertëve me autorizimin e Komisionit mbi pengimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e pakicave të dërgohet në Kosovë, për të shqyrtuar të gjitha elementet në dosjet dhe për të intervistuar të gjitha viktimat. Gjatë vizitës në Gjakovë, ata konstatojnë, dhe në raport shënojnë edhe këtë: «*Një punëtorë e helmuar, një grua 25 vjeçe, dëshmoi para nesh. Ajo ndjeu kundërmimin në orën 10:30 minuta, disa punëtorë ranë përtokë, shumë të pafuqishëm. Qëndruam në spitalin e Gjakovës pesë ditë.*

Tashmë ishte ftuar pesë herë në polici. Shpesh duhej të priste me orë të tëra para marrjes në pyetje. Ajo tha se 40 të tjerë në fabrikën e saj «Emin Duraku» ishin sëmurë dhe dyshojnë se diç helmuese ka mundur të hidhej në punëtorinë e tyre derisa ishin në pauzë për mëngjes». Këta anëtarë të komisionit në raport për Gjakovën shënojnë edhe këtë: «Shikuam videokasetat në të cilat ishin regjistruar ngjarjet e 23 marsit, në orën 13, në këtë qytet. Prej viktimave, 187 ishin punëtorë të fabrikave, me 7 fëmijët e tyre të moshës 2,5-5 vjeç, të cilët atë ditë ishin në çerdhen e fabrikës. Mjeku, i cili ishte kujdesur për fëmijët, poashtu ishte helmuar për shkak të kontaktit me ta», («Zëri», f.17).

Në Gjakovë, në mesin e të helmuarve ishin edhe:

Azem Lokaj, Jasmina Lokaj, Igor Gashiq, Liridona Kusari, Valbona Hoti, Driton Haraqia, Kreshnik Hoti, Albina Shehu,

Arbërore Osmani, Mirë lindë Harbuti, Antoneta Kryeziu, Diamant Krasnqi, Sebahate Bajrami, Anda Valla, Laura Skenderi, Leonora Gashi, Melinda Radoniqi, Albina Della, Suzan Uka, Albina Bytyqi, Elida Baçaj, Mirlinda Gaxha, Afërdita Lasku, Përparim Koci, Isni Tahiraj, Argjentina Hajdari, Hatixhe Morina, Mimoza Mullaibrahimi, Merimane Brahushi, Arbërore Zogu, Elida Meta, Arbërore Berisha, Liljana Gashi, Saranda Sahiti, Valentina Zogu, Erëmira Morina, Ardiana Kadriu, Vlora Morina, Dafinë Pozhegu, Mimoza Abdullahu, Saranda Della, Shpresa Hasani, Venera Kadriu, Dafina Beci, Florentina Abrashi, Valentin Pjetri, Laura Pllana, Arlinda Asllani, Furtuna Kërshi, Roza Malësori, Luljeta Rugova, Lëndita Lumi, Shpresa Elezi, Lulëzim Batusha, Mentor Ferizi, Vesna Obradoviç, Lëndita Gavrani, Antigona Krasniqi, Vera Gjokaj, Shpresa Azemaj, Xufe Zheli, Lëndita Mehmetaj, Razië Krasniqi, Margarita Doçi, Jehona Hasanaj, Dile Gjokaj, Marie Dushaj, Valon Zeka, Roland Gojani, Skender Rexhepi, Hatixhe Iseini, Lulëzime Iseini, Miranda Della, Florie Morina, Shkëndije Buza, Miranda Begolli, Violeta Thaqi, Hatixhe Kelmendi, Servete Morina, Leme Kabashi, Adelina Kumnova, Leonora Bobani, Alltane Rrustemi, Shaindere Hoxha, Shpend Rrustemi, Marie Prenk-olnikaj, Venera Beqiraj, Vlora Beqiraj, Xhejrone Humaj, Driton Beqa, Saranda Arllati, Arbënesha Hoxha, Iliriana Nushi, Samile Noci, Mirë lindë Zatriqi, Brikenda Tafarshiku, Pranvera Koburja, Venera Dylazeka, Sakibe Ballanica, Shkëndie Lushaj, Ariana Milla, Valbona Morina, Arbnore Hana, Mirëdita Curri, Merita Mërtezi, Merita Mustafa, Adelina Boshnjaku, Rrahime Paqarizi, Valentina Petershani, Drita Kelmendi, Selemete Asllanaj, Hake Thaqi, Merita Krasniqi, Vlora Canhasi, Antigona Halilaj, Valbona Haziraj, Donika Xharra, Nekibe Qollaku, Margize Qollaku, Arbënore Deva, Merita Sada, Besnik Bardhi, Shpresa Muhaxhiri,


Lëndita Berisha, Mirlinda Dërguti, Shqipe Hakaj, Dijane Xhoci, Arbene Humaj, Filloreta Daci, Zize Gjocaj, Blerta Abrashi, Mirëllinda Sina, Laura Grezda, Anita Radogoshi, Valbona Krasniqi, Agnese Maloku, Leonora Gashi, Arditë Hasi, Ardian Gjevukaj, Ajshe Llapaqi, Mimoza Kaqi, Valentina Sylmetaj, Drita Kastrati, Liranda Rrahmani, Edita Çarkaxhiu, Anita Lluhani, Arietë Gjevukaj, Sanije Borniku, Drita Musliu, Vlora Shala, Shenxhan Mustafa, Shkurte Zenuni, Dashnor Zyberi, Xhevdet Shijaku, Vjollca Doli, Xhavit Dervishi, Shemsi Mehmeti, Ajlinda Asllani, Filloreta Kumnova, Kristina Gjokaj, Petrit Mulliqi, Dashurie Pruthi, Sevdije Miftari, Hyrema Nushi, Bisine Morina, Florie Tuzi, Valentina Kurti, Saranda S.Sahiti, Shkëndije Buçinca, Fortuna Kërleshi, Dafine M.Pozhegu, Sofije Jakupi, Laura Z.Grezda, Ardiana Juniku, Venera Sh. Mehmeti, Mejreme Bytyqi, Vjollca Brovina, Sadije M.Berisha, Vesna Jakov Grgiq, Rifat Berisha, Ferdeze Hoxha, Shemsije Kumnova, Behije Qollaku, Dile Gjokaj, Dafinë, Kënduesi, Sevdije R. Hoti, Haxhi S. Kurtaj, Bajram Peja, Elida A.Meta, Mirëllinda Rudi, Violeta N.Menxhuka, Antoneta Hoti, Bajram Qela, Skender Kastrati, Bekim Leti, Servete Zogaj, Marije Gj.Kolndrecaj, Vitore Gojani, Nora Nushi, Anitë Llulani, Halit Shabani, Arbnore Smajlaj, Dushe Simonaj, Mehmet Shoshi, Behigje Rrahmani, Florentina Alushi, Leon Shalaj, Blerim Bardhi, Zeki Lloqani, Lonik H.Rexha, Alida A.Meta, Venera Sh.Mehmeti, Hedije Dërmishi, Hysnije Myrtezaj, Silvije Gj.Degani, Edmond Bokshi, Ferdeze A.Hana, Merita A.Krasniqi, Melihate Y. Halili, Halime Xërxa, Hysen Sadiku, Nexhmije Zoga, Adelina Peja, Ibadete Halilaj Rifat Kastrati, Dushe Nikaj Skënder Hoxha, Vezir Mazreku, Gëzim Mala, Afërditë Domi, Dritë Krasniqi, Bahtishe Morina, Zejnije Gashi, Avni Bistradhini, Slavica Juniku, Latif Berisha, Valdete Lokaj, Selman Seferaj, Xije Musa,

Nashire Gjellili, Violetë Bruqi Degani, Ardiana Kadri Kadria, Halil Gashi, Bekim Kelmendi, Ardian Pozhegu, Ismail Selmani, Ibadete Halilaj, Shkëmbije Hoxha, Avni Krasniqi, Marije Tune Kolndrecaj, Arijeta Spahija, Valentin Sylmetaj, Faton Kabashi, Shpresa Xharra, Nerimane Brekushi, Muhamet Morina, Afërdita Grezda, Resmije Ali Beqrami Arijetë Spahija, Mirëllinda Morina, Afërditë Delija, Flore Zhaveli, Meritë Kukiqi Afërdita Pren Laski, Afërditë Delia, Anita Nesheti Shqipe Hana, Saranda Delija, Miranda Bajra, Vahide Fahri Izdini, Hatixhe Hysen Morina, Sakibe Bellanica, Kimete Berisha, Alberta Markaj, Rudina Faruk Podrima, Agim Stoja, Ramë Rexhep Binakaj, Diana Curri, Shkelzen Hasi, Mirëllinda Abdullah Sina, Elamaze Sali Kamberi, Violeta G.Mehmeti, Lirie A.Hana, Xhemile L.Hoti, Arbënore Sh. Zogu, Blerta S.Abrashi. Nexhat Jakup Zenunaj, Ganimete Kryeziu, Isuf Haxhi Zenuni, Mustafë Hasan Jetishi, Mirëllinda B.Morina, Servete R.Kusari, Laura Zherka, Shkëlzen Doqaj, Mirëllinda Agim Gaxha, Mirjeta Islam Rugova, Riza Besim Malsori, Kastriot Idriz Sylja, Sadet Halimi, Valbonë Mustafë Kazazi, Afërditë Masar Doli, Fakete Vonji, Fitore Selim Bahtiri, Shkumbim Lluka, Valentina Isaj, Lumnije Kelmendi, Aurora B. Kyçyku, Zyrafete Sh. Neziri nga Kaçaniku etj.

Helmimi në komunën e Prizrenit

Komuna e Prizrenit ishte po ashtu shumë e atakuar me helmim. Këtu helmimi është bërë edhe në fshatrat përreth. Nga ato fshatra më së shumti pësoi Zhuri, i cili në vitin 1989 edhe është masakruar nga ekspeditat policore serbe, nga të cilat humbën jetën nxënësit dhe të rinjtë: *Ajrim Badallaj* (13), u vra më 28 mars 1990 kur u mor me dhunë nga policia serbe. Po këtë ditë nga kjo ekspeditë

policore u vranë edhe *Zylbear Badallaj* (23) dhe *Xhemshit Badallaj* (25). Më 6 prill të vitit 1989 nga ndërtesa e Sekretariatit të Punëve të Brendshme hidhet i gjallë apo i vdekur profesor *Xhemajl Berisha*. Në Prizren, në vitin 1989, për shkak të ndryshimeve kushtetuese me dhunë në komunën e Prizrenit vriten edhe të rinjtë: *Muhamet Ymeri*, (19), nga fshati Dushanovë, u vra më 28 mars 1989, *Vetim Shala*, (31), nga Prizreni, u vra më 27 mars 1989.



Xhemajl Berisha, më datën 6.4.1989, hudhet nga kati III, nr.33 i ndërtesës së SPB-së në Prizren

Helmimit të të rinjve shqiptarë u paraprinë rrahjet, maltretimet dhe plagosjet e vitit 1989. Në raportin e Komisionit ndërkombëtar, i cili e vizitoi Prizrenin në korrik të vitit 1990, thuhet: «*Të njëjtën ditë ekipi ynë vizitoi Spitalin e Prizrenit, ku intervistuaam urologun kryesor, ndihmësit e tij dhe një oftomolog. 240 viktimat e helmimeve të 23 marsit ishin vendosur në lokalitetet përreth dhe në të gjitha sektorët e spitalit, mirëpo punëtorët shëndetësorë nuk*

Vushtrria ishte karakteristike nga aspekti i helmimit, sepse me helme u përfshinë edhe disa pjesëtarë të nacionalitetit serb, në mesin e të cilëve edhe tre policë dhe Lubisha Stojanoviç, 40-vjeçar nga Prilluzha e Vushtrrisë, të cilin në Klinikën e Kirurgjisë Ortopedike në Prishtinë e sollën më 23 mars 1990, në orën 11:15, me autoambulancën e Vushtrrisë me diagnozë: helmim. "Këtë diagnozë mjekët Stojanoviçit ia dhanë në Vushtrri. Në ambulancën e atjeshme Stojanoviçit u ankua për po të njëjtat mundime, si edhe të helmuarit e tjerë të asaj dite në Vushtrri (kokëdhembje, dhëmbje dhe djegie në stomak, vjellje, dridhje trupi). Ngjashëm me këtë Stojanoviçit i deklaroi edhe infermieres kujdestare të repartit të pranimit të Klinikës së Kirurgjisë dhe të Ortopedisë në Prishtinë dhe me siguri do t'u tregonte edhe të gjithë të tjerëve, sikur mjeku

kujdestar në repartin e pranimit, dr. Rade Gërbiq (i cili shih për rastin e Stojanoviqit e ndërpreu ndejën dhe pijen) të mos e përkujtonte se ishte i rrahur». Për më tepër, ky i fton «ekipin e TVB, gazetarin dhe fotoreporterin e «Jedinstvos» për t'u treguar shembullin konkret të serbit që është rrahur dhe maltretuar e pastaj dërguar në spital me diagnozën «helmim» (18:f.9).

Dr Rade Grbić, lekar na Ortopedskoj klinici u Prištini

Doveli čoveka iz Vučitrna, Srbina. Kažu - otrovan. A on "otrovan" od žestokih batina

Tih dana u svetskim medijuma, koji su koliko toliko hteli da budu objektivni, počelo je da se postavlja pitanje, kako taj otrov truje samo albansku, a ne i srpsku decu, iako zajedno idu u škole. Da bi dokazali da nije tako, organizatori ove svojevrsne farsе od trovanja nisu birali sredstva. Ispricao vam samo jedan slučaj, rekao je za "Telegraf" dr Rade Grbić, lekar sa Ortopedske klinike u Prištini.

- Bio sam dežurni. Dovedoše jednog dosta teško povređenog pacijenta, za koga rekoste da je iz Vučitrna, da je otrovan kao i albanski daci i da je tako otrovan pao i razbio se. Naravno, sve to rekli su i novinarcima. Međutim, kada sam ga detaljnije pregledao, video sam da povrede nisu od pada, nego od batina, a u njegovoj krvi molekuli nije bilo nikakvih znakova trovanja. To je, uostalom, on sam i potvrdio kada je došao k sebi. A, o čemu se zapravo radilo? Bilo je to krajem marta 1990. godine. U Vučitrnu se odvijao scenarij navodnog trovanja. Taj čovek, po nacionalnosti Srbin, prisao je trafici da kupi novine. To je glasno rekao prodavcu, a sve je slušao milicioner



Isprebijanog Srbina na kliniku dovezli kao "dokaz": dr Rade Grbić

Albanac. Pozvao je učesnike navodnog trovanja, oni su ovog Srbina isprebijali do besvesti i dovezli ga kod nas kao "dokaz" da se "eto, i Srbi truju". Međutim, čovek je ostao živ i sve to ispricao i nama lekarima, ali strani novinari, kojima je takođe hteo to da potvrdi, nisu hteli da ga saslušaju!

Edhe një përpjekje për të «demantuar» helmimin

Kjo gënjeshtër serbe nuk mbaron me kaq; gazetarët serbë shtojnë se «*ky është therur me thikë*». I vetmi që nuk pa asgjë si duket mbeti vetëm spec. dr. Ymer Aliu, mjeku kujdestar në Klinikën e Kirurgjisë dhe të Ortopedisë, i cili, siç na deklaroi, edhe pasi ia hoqi fashot Stojanoviqit, në ballin e tij nuk vërejti «asgjë» (18:9)...Trillimi i gjërave megjithatë nuk pengoi zhvillimin e skenarit deri në fund. Stojanoviqi, pasi më parë iu grisën disa prej dokumenteve (udhëzimi i mjekut nga Vushtrria dhe lista e temperaturës me terapi të shënuar) me kërkesë personale lirohet në shtëpi. Ky proces do të marrë përfundim të paparë dhe që mendja e njeriut nuk mund ta kapë. Atë të nesërmen e vizitojnë Mihal Kertes, Milomir Miniq dhe Tomislav Trajkoviq (të gjithë organizatorë të mitingjeve serbe në të cilat kërkoheshin armët për t'i shfarosur shqiptarët (*vërejtje e H. Hysenit*), ndërsa një ditë më pas atij i dërgohet edhe helikopteri, i cili, si rast të rendit të parë të urgjencës (!) bartet për në Beograd. Ky bëhet «shkas» për suspendimin e milicisë (sepse deklaroi se e kanë rrahur 200 terroristë, përderisa dy milicë shqiptarë e kanë mbajtur për dore) së pari në Vushtrri e më pastaj edhe tërë policinë dhe shëndetësinë kosovare. (18:9). Kuptohet nuk ishte vetëm kjo gënjeshtër dhe vetëm ky rast «shkas». Kishte me mijëra gënjeshtër të këtilla, të cilat Serbia i mori për shkas si për rrënimin e autonomisë së Kosovës, ashtu edhe për t'i «fshehur» gjurmët e helmimit.

Në Vushtrri, në mesin e të helmuarve ishin edhe: *Ilmije Caka, Fitore Halimi, Luljeta Maloku, Musa Mustafa, Elhame Hyseni, Ferdane Hyseni, Sadete Sallahu, Qefsere Sylja, Besim Xhaferi, Bedri Neziri, Albert Muzaqi, Elfere Latifi, Ardian Kryeziu, Bukurie Mulaku, Shefkije Mulaku, Shqipe Gashi, Rukije Ibishi, Sahare Krasniqi, Nadire Sylja, Valbona Krasniqi, Afërdita Neziri, Fatime Pllana, Fikrie Mehmeti, Albana Miniq, Makfirete Zymberi, Valbona Xhemajli, Kumrije Hasani, Kumrije Xhemajli, Hidajete*

Cakaj, Hikmete Maloku, Muharrem Syla, Valdete Pllana, Fadil Hyseni, Muhamet Cakaj, Hafiz Muzaqi, Arben Merovci, Mehmet Halili, Nijazi Kurti, Rrahim Syla, Idriz Krasniqi, Ferat Gashi, Naim Syla, Nexhmie Parduzi, Sebahate Halili, Enver Mehmeti, Avni Istrefi, Labert Novolani, Nuredin Rrustemi, Fetah Xhakolli, Shaban Muli, Ardian Maqestena, Haki Shala, Lulëzim Beqiri, Valdet Maxhuni, Ajet Bunjaku, Ferdane Uka, Bukurie Sokoli, Shehrie Feka, Bashkim Bunjaku, Florie Hoxha, Florie Sinani, Mevlude Ahmeti, Rukie Bajrami, Hatixhe Halili, Rukie Shabani, Lumnie Nuredini, Shefkie Manovi, Ferdane Bejtullahu, Avni Islami, Lumnie Kamerolli, Kimete Zhushi, Zahide Muharremi, Fikrie Ademi, Fitore Rashica, Antigona Rashica, Shqipe Rashica, Fikrete Grabovci, Hyrie Sahiti, Valbona Behrami, Kimete Mehmeti, Ajshe Nuredini, Nerxhivane Nekiqi, Jakup Rashica, Hanife Latifi, Fetic Kamberi, Bashkim Pllana, Shefki Azemi, Ymer Rexha, Xhevdet Abazi, Hidajete Hetemi, Rejhane Syla, Ahmeti Ismajli, Suzana Shaqiri, Vjollca Morina, Fatmire Tërnavë, Muharrem Gashi, Besim Halili, Nazmie Jashari, Arbie Saraqi, Vlora Mulaku, Fikrije Islami, Xhevdet Hoxha, Elheme Tahiri, Fetic Hyseni, Fatmire Xhafa, Arsim Llapashtica, Irfan Nika, Florie Ademi, Bashkim Mustafa, Shpresa Halili, Nazlie Bjellopoja, Sebahate Tahiri, Merita Kamerolli, Iliesa Mulaku, Mursel Latifi, Valbona Kadriu, Bahrie Bllaca, Suzana Maxhuni, Hadie Kosumi, Selvet Tërnavë, Filiza Prishtina, Nebahate Isa, Fikrete Krasniqi, Bekim Klinaku, Behrame Avdyli, Merita Grabanica, Zylfie Shaqiri, Fitnete Fazliu, Bukurie Ymeri, Valdete Hasani, Vjollca Jashari, Nermine Rashica, Nazmie Qela, Ajshe Behrami, Rukie Ferizi, Nazlie Behrami, Lumnie Pllana, Teuta Salihu, Metie Fejza, Vlora Beka, Naser Rexhepi, Florie Mehmeti, Florim Mehmeti, Besim Krasniqi, Safete Ymeri, Xhevdet Shabani, Suzan Feka, Fazli Jashari, Ferat Gashi, Kimete Zahiti, Shemsie Latifi, Fixhrie Syla,

Lumnie Zeneli, Faton Dallku, Venera Morina, Fatmire Jashari, Bukurie Mehmeti, Behare Ferizi, Musa Kosumi, Bedrie Hyseni, Shpresa Maxhuni, Safete Osmani, Hanife Pllana, Shpresa Saraçi, Arsim Dallku, Bahrie Saraçi, Halide Smakolli, Antigona Zekiqi, Habib Halili, Enver Xheladini, Lirie Rama, Blerim Azemi, Vlora Sylja, Natyre Maloku, Vjollca Shabani, Besim Salihu, Nerxhivane Zahiti, Luljeta Xhafa, Sadete Xhafa, Sadete Mejzini, Merita Osmani, Nerxhivane Sarraçi, Nuhi Kovaçi, Avdi Kosumi, Nerxhivane Osmani, Fevzije Jonuzi, Iliriana Kryeziu, Valbona Zahiti, Violeta Ferati, Vjosa Mulaku, Abit Nura, Lutfi Ukiqi, Fatime Sogojeva, Selime Sogojeva, Feti Kadriu, Shefkie Shaqiri, Shpresa Merovci, Zana Spahiu, Selvete Mulaku, Sebahate Ismajli, Afërdita Pllana, Minire Shabani, Sanie Qeza, Shukrie Sfarça, Kimete Mustafa, Shpresa Sejdiu, Fatmir Behrami, Fatime Tahiri, Lumturie Ilazi, Selvie Pllana, Sanie Miftari, Xife Krasniqi, Vjollca Salihu, Merita Xhaferi, Faton Rrustemi, Fatmire Muzaqi, Luljeta Shabani, Habibe Jashari, Vehat Caka, Skënder Hyseni, Fatmire Abazi, Agim Bunjaku, Adile Sadikaj, Besa Perçuku, Merita Pllana, Naim Bajrami, Florie Qungulla, Hysni Kamerolli, Bedrie Salihu, Suzana Kasumi, Merita Berisha, Kumrie Sadiku, Aida Dërguti, Ferki Aliu, Lumturie Galica, Afrim Hyseni, Sebahate Shabani, Shukrie Mikullovc, Luljeta Cakaj, Fatmire Bilalli, Haxhi Vojvoda, Sheribane Ahmeti, Lumnie Dragusha, Agim Islami.

Helmimi në komunën e Mitrovicës

Mitrovica nga nëntori i vitit 1988 bëhet poligon dhune dhe masakre serbe mbi popullatën shqiptare. Në nëntor të këtij viti, kur minatorët vihen në mbrojtjen e subjektivitetit kombëtar të Kosovës, Serbia sjell forca të mëdha policore. Para ndryshimeve të dhunshme kushtetuese minatorët e «Trepçës», për shkak të

shkeljes së të drejtave kombëtare të shqiptarëve dhe rrënimin të autonomisë së Kosovës e fillojnë grevën e thellë në nëntokën e minierës së «Trepçës». Këta i përballojnë urisë e dhunës. Kërkojnë që ndër të tjera (pika 2 e kërkesave të minatorëve) të tërhiqej nga procedura e miratimit të ligjit për pensionimin e parakohshëm të shqiptarëve. Me minatorët solidarizohet tërë populli shqiptar. Studentët solidaritetin e tyre e shprehin me grevën e urisë të mbyllur në hallën e sporteve në Prishtinë në muajin shkurt 1989. Si edhe më parë edhe tani minatorët dhe populli shqiptar mashtrohen nga premtimet e dhëna. Udhëheqja e atëhershme e Kosovës në krye me Rrahman Morinën publikisht deklarojnë se i pranojnë kërkesat e minatorëve në mesin e të cilëve ishte edhe dorëheqja e tij. Pasi minatorët dolën nga zgafella, të rraskapitur dhe të lodhur, në vend të realizimit të kërkesave të premtuara, 6000 minatorë përjashtohen nga puna, ndërsa një pjesë e mirë e tyre burgoset. Dhunën në komunën e Mitrovicës në vitin 1989 dhe 1990 e ilustron edhe numri i të vranëve: *Bedri Hasanaj* (21), u vra në Mitrovicë më 27 mars 1990, *Hakif Bislimi* (33), u vra në Leposaviq më 27 mars 1989, *Behar Sumiqi* (50), u vra më 27 mars 1989, *Ramadan Zeqiri* (54), u vra më 27 mars 1989, dhe *Abaz Ibrahim* (18) u vra më 1 mars 1989 (4:18-24).

Komuna e Mitrovicës nuk i shpëtoi helmimit. Numrin e të helmuarve në këtë komunë po e paraqesim në tabelën vijuese.

Pasqyra tabelare e numrit të të helmuarve në komunën e Mitrovicës sipas institucioneve

Nr.	Emërtimi i institucioneve	Të helmuar	
		Numri	%
1	Shkolla e Mesme Ekonomike	157	30.4
2	Gjimnazi «Silvira Tomazini»	131	25.3
3	Shkolla e Mesme e Mjekësisë	111	21.5
	Gjithsej	399	77.2
4	Studentë	21	4.1
5	Të tjerë	97	18.8
	Total	517	100

Në këtë komunë në mesin e të helmuarve ishin edhe: *Ferdane Miftari, Hadie T. Kelmendi, Sebahate Ademaj, Ajshe Hasani, Remzije Mulliqi, Shpresa Sejdiu, Leonora Ramiqi, Fixhrije Beqiri, Arjeta Shkreli, Bahrie Sadiku, Ferdie Voca, Suzana Tahiri, Valbona Peci, Jeton Bejtullahu, Valbona Hyseni, Albana Pllana, Vjollca Jashari, Vlorë Beqiri, Elfete Ibrahimimi, Blerim I. Shala, Hanife Jashari, Merita Rama, Shukrie A. Bajrami, Valbona Xhaka, Luljeta Xh. Ibrahimimi, Sevdije Zeka, Vildane Beqiri, Vjollca Q. Jashari, Sabri J. Jusufi, Arsen J. Talaj, Naime Selmani, Arta Z. Shala, Vjollca Z. Alidemaj, Nerxhivane A. Mulliqi, Afërdita B. Azemi, Sadete I. Avdiu, Lutfie S. Asllani, Fatmir Xh. Zeneli, Ilir M. Asllani, Nexhmie Sh. Bajraktari, Astrit F. Asllani, Fikrie L. Salihu, Shyqrie Rr. Hasani, Nazmie J. Binaku, Lendita A. Peci, Afërdita R. Sadiku, Sabri I. Ibishi, Myrvete I. Hasani, Afërdita R. Emini, Arbenita J. Xhaka, Samir I. Peci, Gyltene Krasniqi, Vjollca J. Hajdari, Zyrafete Y. Avdiu, Lamie Kadriu (1974-1991) vdes nga pasojat e helmimit (shih faksimilin). Ymer A. Rrustemi, Lëndita M. Kavaja, Minire, S. Ymeri, Leonora Oruqi, Hajrie H. Muzlijaj, Esmat T. Beqiri, Bahrije I. Ibrahimimi, Have M. Bunjaku, Shahe Sh. Maliqi, Selvete A. Shala, Bahtie Fetahu, Afërdita E. Ibrahimimi,*

**NE SPITALIN E PRISHTINES NGA PASOJAT E HELMIMEVE
VDIQ E REJA LJAMIE KADRIU**

Më 11 shtator në orën 12.45 minuta të mesdites nga pasojat e helmimeve vdiq Ljamie (Mehmet) Kadriu e lindur më 1974 në Mitrovicë, nxënëse e vitit të dytë në Gjimnazin e Mitrovicës. Sipas informatave që morëm nga Keshilli për të Drejtat e Njeriut në Mitrovicë, Ljamia ishte e shtetësi shqiptare dhe e semurë që nga viti 1990 nga pasojat e helmimit, kur që helmuar së bashku me shumë nxënës të tjerë shqiptarë. Pasi keqësimi të gjendjes ajo u dërgua në Spitalin e Prishtinës, por nuk mund të bëjë ballë pasojave të sëmundjes e munde.

Y. DURMISHI

Lajmi në gazetë për vdekjen e Ljamie Kadriut (1974-1991)

Selvete I. Braha, Kadrie F. Dobрева, Vildane R. Abazi, Lendita Xh. Lyta, Afërdita Y. Bekteshi, Kimete S. Jashari, Vjollca A. Tahiri,

Emrane Z. Miftari, Nazire Ibrahim, Mevlude A. Rama, Vjollca Dobërlluka, Avni Meha, Fatime Ismaili, Sheribane Musliu, Sulejman B. Rushiti, Sami A. Maliqi, Valdet S. Fejza, Leonora A. Kastrati, Vlora Z. Asllani, Ekrem Syla, Besim Osmani, Shkurte Rr. Mulliqi, Basri Hyseni, Shkurte Veseli, Zothane Beka, Antigona Qubrelli, Sheribane Voca, Bukurie Kajtazi, Selvie Abdullahu, Bashkim Rexhepi, Luljeta Voca, Enise Hoxha, Fikret Ymeri, Enita Jusufi, Sebahate Kolludra, Mybera Kuçi, Ajshe Hoxha, Lirie Sahiti, Mirlinda Idrizi, Myrvete Jusufi, Fatmire Istrefi, Vjollca Beqiri, Elhame Peci, Kimete Abazi, Firdane Miftari, Halime Jusufi, Gjezide Peci, Mirishahe Selmani, Kimete Beqiri, Sadie Selmani, Albert Demaku, Lëndita Voca, Hanife Jashari, Blerim Behrami, Nazlie Voca, Afrone Kaçaniku, Lumnie Zeneli, Ibadete Nuhui, Vlora Ramadani, Arbresha Meholli, Kumrie Kelmendi, Sanie Salihu, Fetie Sadiku, Qefsere Mehmeti, Suada Ombashi, Miradie Tahiri, Selvete Rexhepi, Valdete Zeqiri, Melihate Muzhiqi, Sheribane Beshiri, Eleonora Miftari, Besa Kumnova, Zyhra Sadanjeva, Valbona Hasani, Sevdije Hajredini, Cyme Mehmetaj, Mirvete Jusufi, Besa Ismajli, Emine Tahiri, Shukrie Meholli, Valbona Sulejmani, Teuta Rexhepi, Resmie Mehmeti, Sadie Azemi, Fetie Mehmeti, Ganimete Tahiri, Berkide Fetahu, Ajshe Hasani, Fitnete Kelmendi, Azize Fejza, Arjeta Aliu, Fatbardha Gjokolli, Leonora Berani, Nebahate Aliu, Antigona Avdiu, Have Veseli, Selvete Syla, Rukie Ismajli, Bekime Mëziu, Lindita Behrami, Florie Zeneli, Nerimane Gërgjاليu, Besa Hasani, Nazmie M. Voca, Sami Musliu, Valbona Hamiti, Melihate Islami, Luljeta Ismajli, Shqipe Kelmendi, Ferdane Ibishi, Behrie Hajdini, Luljeta Hetemi, Skënder Arifi, Suzana Krasniqi, Adelina Qorolli, Armanda Tahiraj, Ganimete Krasniqi, Igballe Qeliqu, Kimete Mehmeti, Feride Rrustemi, Esat Sahiti, Ganimete Shabani, Luljeta

Haziri, Vjollca Dvorani, Fitor Bahtiri, Fahrie Ahmeti, Qefsere Ferizi, Naim Gashani, Gazmend Osmani, Remzie Jashari, Valdet Kasumi, Lumnie Kalludra, Hasime Zeneli, Hyrije Ismajli, Ardiana Ramadani, Luljeta Krisa, Merita Basholli, Sadie Krasniqi, Valbona Basholli, Violeta Krasniqi, Fikrie Ahmeti, Fahrie Kelmendi, Fidaim Grepri, Dinore Aliçkaj, Sadie Fejza, Burhan Maxhuni, Hajdin Hajrizi, Vesel Bajraktari, Abedin Ibrahimimi, Alush Beqiri (1929), Zeta Hajdini, Bukurie Bajrami, Elmaze Tahiri, Vjollca Shala, Ismet Gjoshaj, Ismet Mala, Enver Latifi, Fahri Pllana, Xhemajl Ismajli, Shqipe Hyseni, Sheribane D. Voca, Myrvete Hajrizi, Elfete Zeqiri, Asim Stafaliu, Fikrie Mehmeti, Taibe Beqiri, Lume Bimbashi, Adile Sadiku, Hadie Voca, Ylfete Bajrami, Sabrie Xhemajli, Vlora Beka, Xhavit ...? (student), Abdullah Meha, Merita Kamerolli, Shaban Bytyçi, Suzana Hasani, Sadete Dobrani, Vlora Maloku, Sofie Dobrani, Nexhat Koludra, Abdurrahman Uka, Deli Maliqi, Nazmi Istrefi.

Helmimi në komunitat e Skënderajt, Malishevës dhe të Klinës

Këto tri komuna, siç mund të shihet në hartë, janë tri komuna fqinje. Komuna e Skënderajt është e pastër etnikisht. Numri i banorëve të nacionaliteteve të tjera është fare simbolik. Komuna e Malishevës është plotësisht e pastër etnikisht. Është e banuar vetëm me shqiptarë. Klina, si komunë është po ashtu, etnikisht e pastër edhe pse në këtë komunë ekzistojnë banime dhe lagje të vogla dhe me numër të vogël të banorëve malazez dhe serbë. Ky numër tani silllet rreth 2%. Si komuna homogjene në aspektin etnik, përherë kanë qenë objekt represioni dhe dhune shtetërore serbe. Kështu ishte edhe gjatë viteve 1981-1990. Kështu është edhe sot.

Në komunën e Skënderajt, në fshatin Prekaz herët në mëngjes kordonet policore, në vitin 1988, rrethojnë shtëpinë e *Nebih Mehës*. Gjatë tërë ditës, pas një lufte të madhe, vriten *Tahir* dhe *Nebih Meha*, ndërsa shtëpia e tij rënohet. Në periudhën 1989 -1990 në këto tri komuna nga policia serbe vriten: *Din Paçarizi* (11), nga fshati Dragobil, komuna e Malishevës, u vra më 5 prill 1989, *Arsim Paçarizi* (11) nga i njëjti fshat, u vra të njëjtën ditë nga i njëjti ushtar i ish-armatës së Jugosllavisë, *Hilmi Kajtazi* (34) nga Skënderaj, u vra më 27 mars 1989, *Ali Din Kryeziu* (28), nga Malisheva, u vra më 30 janar 1990, *Arsim Abdullah Mazreku* (17), u vra më 30 janar 1990 (4:18/24). Më 19 mars 1989, në shkollën e mesme «*Luigj Gurakuqi*» në Klinë helmohen 33 nxënës shqiptarë. Është ky testimi i helmeve, të cilat do të aplikohen një vit më vonë masovikisht në tërë Kosovën.

Pasqyra tabelare e të helmuarve në komunat e Skenderajt, Klinës dhe të Malishevës sipas institucioneve

Nr.	Komuna	Nr. Emërtimi i institucioneve	Të helmuar	
			Numri	%
1	Skenderaj	1. Sh.f. «18 Nëntori»	97	11.3
		2. Sh.f. «Milladin Popoviq»	29	10
		3. Shkolla f. Runik	31	10.6
		Gjithsej	157	53.9
		4.OAMO «Ramiz Sadiku»	117	40.2
		5.Të tierë	17	5.9
	TOTAL	291		
2	Klinë	1. Shkolla fillore (1)	47	34.8
		2. Sh.m. «Luigj Gurakuqi»	74	54.8
		3 Të tierë	14	10.4
		TOTAL	135	100
3	Malishevë	1. Gjimnazi «Abdul Frashëri»	131	94.9
		2. Të tierë	7	5.1
		TOTAL	138	100

Në këtë rajon siç mund të konstatohet nga tabela e sipërshtuar, nga 564 qytetarë 204 apo 36% prej tyre janë nxënës të shkollave filllore, 319 apo 57% nxënës të shkollave të mesme dhe 41 apo 7,2% të tjerë. Në mesin e të helmuarve ishin: *Rrahim M. Mehulli, Lëndita B. Fazliu, Ajmane Bytyçi, Valbona Xh. Spahiu, Sahare H. Bislimi, Rrahman Mehulli, Luljeta Miftari, Sadete Zejnullahu, Minire Bajraktari, Fatmir Avdiu, Xhytferie Hoti, Ismajl Dobra, Mirëdita Dobra, Mirëdita Salihu, Nazlie B.Haxhiu, Sadbere Bislimi, Behxhet Kani, Bastri Lushtaku, Haxhi Rreci, Hatixhe B. Koci, Bedri R.Zejnullahu, Ardita F.Thaqi, Sadik Ymeri, Afërdita B.Sadiku, Drita Gashi, Bekim Gashi, Shkurte H.Deliu, Fehmi Rreci, Minire Fazliu, Sadbere Shaqiri, Drita V.Delolli, Sadie Lushtaku, Agoll Bislimi, Fahrie Salihi, Mërgime Spahiu, Luljeta Zeneli, Lumnije Sylejmani, Hajrije Smakiqi, Shkurte Aliu, Sabile Lushtaku, Alije Hyseni, Myrvete Bajra, Xhyle Musliu, Fahrie Musliu, Shyqri Zejnullahu, Dinore Miftari, Xhevat Nebihu, Shkurte Sh. Veseli, Fatime Berisha, Atife Z.Beka, Sanie Fazliu, Bukurie Z.Kuliqi, Lumnie Sulejmani, Mehdi Avdiu, Avni Xh. Dujaku, Feriz Zeqiri, Miftar Dobra, Ardita B.Sahiti, Merita Çollaku, Samire M.Rushiti, Nebahate Bahtiri, Zahe Geci, Violeta Veliqi, Myrvete Q.Kadriu, Fehmi Fazliu, Ganimet Zeqir Koci, Valdet H.Gucati, Merita K.Fazliu, Jehona S. Salihu, Merita Xh. Jashari, Violeta B.Sahiti, Afërdita Alickaj, Violeta H.Veliqi, Fatime B.Berisha, Besa S.Veliqi, Shpresa H.Veliqi, Shemsie J. Jusufi, Sadie S. Selimi, Valbon A. Osmani, Shehrie H. Latifi, Ejup R. Zejnullahu, Elhame I.Zyhami, Sanie H.Berisha, Xhemajl Zejnullahu, Enver Koshutani, Afërdita F. Lushtaku, Hadie Xh. Çollaku, Lëndita Bajram Fazliu, Shemsie F.Durmishi, Hajrie M. Gashi, Afie Beka, Luljeta S. Veliqi, Merita Gashi, Miradie Kadriu, Zoja Veliqi, Zelfije Istogu, Violeta Veliqi, Mirvete M. Ajeti, Melihate Selimi,*

Drita H.Gashi, Resmie A.Xani, Agron Dujaku, Lëndita Shala, Shkurte Shala, Lëndita S. Spahiu, Ferdeze Meholli, Besa Veliqi, Mirëdita Kadriu, Bukurie Gashi, Ekrem Bobaj, Florie Uka, Miradie Bimbashi, Armendie Rreci, Sadie Kadriu, Fahrie H.Selimi, Valbon N.Ferizi, Esat Oruçaj, Luljeta Gecaj, Mirvete M.Ajeti, Valdete A. Rrustemi, Mirëlinda I. Lushtaku, Lumnie Haziri, Maliq Bunjaku, Lirie Hyseni, Mehmet Mula, Arlinda Miftari, Mirëdita Hyseni, Lule A.Miftaraj, Fatmire H. Dërguti, Mehmet M. Mani, Igballe A. Maloku, Shukrie R.Rexhepi, Hilmie I.Dudi, Avdie Maloku, Valbona Potera, Burbuqe Ahmeti, Afërdita A. Latifi, Afërdita Z.Namani, Afërdita I.Ferati, Fakete Sh. Idrizi, Naim Rr. Mehanja, Ganimete B, Behluli, Selvete A.Ajeti, Arben T.Rekaliu, Nexhmie T.Hoxha, Kimete B. Sefa, Fatmire H. Avdyli, Luljeta L.Babatinca, Shukrie F.Kapella, Valdet A.Selimi, Zejnie M.Ymeri, Kasum M.Abazi, Faik Dobra, Leonora Veliqi, Fatmire Koca, Merita Xani, Minire Xani, Ajmane Veliqi, Makfire Veliqi, Florie Koca, Hidajete Veliqi, Bahije Veliqi, Selvete Kerolli, Ilir Gucati, Resmie Xani, Afërdita Koca, Shefkije Kabashi, Shpresa Veliqi, Ekrem Gashi, Zejnie Veliqi, Isa Xani, Sulltane Makolli, Driton Xani, Nuredin Kabashi, Mehreme Kerolli, Kimete Veliqi, Fatime Gashi, Mihrije Gucati, Kimete Xani, Fatime Gashi, Ajete Gruda, Qamil Koca, Ardita Veliqi, Lumnie Makolli, Baki Koca, Hata B.Koca, Lirie G.Gruda, Makfire Veliqi, Resmie Xani, Ardita Veliqi, Ajmane Veliqi, Afërdita Koca, Shpresa Veliqi, Bahrije Gashi, Hafije Veliqi, Dinore Dobra, Hidajete Veliqi, Zade Veliqi, Abdyl Kabashi, Fetije Xani, Shqipe Xani, Adile Veliqi, Shkurte Veliqi, Qamil Dobra, Fatmire Koci, Ardita J.Dobra, Sulltane M. Makolli, Sulltane Kabashi, Nexhmie Koca, Zejnie Veliqi, Shefkije Kabashi, Fatmir Sh.Koca, Zahide S.Veliqui, Ajtene Gruda, Adnan Dobra, Hidajete U.Haliti, Vjollca Gashi, Valbona V.Dobra,


Bukurie R.Dobra, Hidajete M.Kerolli, Merita M.Veliqi, Ganimete Beka, Valbona Krasniqi, Valbona Berisha, Leonora Mrijaj, Ganimete Morina, Sadete Bojaj, Bahtije Krasniqi, Sabrije Dauti (Bokshiq), Feride Berisha (Qeskovë), Sadie Shala (Ujmir), Besa Gashi (Ujmir), Shukrie Desku (Siqevë), Violeta Berisha (Siqevë), Ajnishahe Morina, Mexhide Thaqi, Hidajete Ademi, Feride Bojaj, Nexhad Prekadini, Lajde Palucaj, Ardita Morina, Suzana Thaqi, Fahrie Ahmetgjekaj, Teuta Elezi, Fitnete Rraci, Afërdita Mustafa, Rezmije Bacaj, Feride Krasniqi, Sahadete Krasniqi, Shqipe Foniqi, Marie Marku, Drita Morina, Salie Shala, Teuta Marku, Rabie Thaqi, Bedrie Thaqi, Sylë Abdyli, Remzie Prekadini, Sadete Elezi, Vjollca Foniqi, Binak Gashi, Shpresa Kuçi, Burbuqe Rraci, Besa Raci, Shqipe Mërmullaku, Faze Dushi, Skënder Skeli, Shpresa Zeqa, Sevdie Shala, Mihrije Millaku, Minire Krasniqi, etj.

Helmimi në rajonin e Pejës dhe të Deçanit

Peja dhe Deçani, për shkak të resurseve turistike, tokës pjellore, afërsisë gjeografike me Shqipërinë, përherë kanë qenë objekt dhune dhe terrori shtetëror. Ky terror nga viti 1981 shtohet gjithnjë më shumë duke arritur kalimin në vitet 1989-1990. Megjithatë, në këto vite nuk përfundon dhuna dhe presioni. Përkundrazi, në arsim ato do të shtohen edhe mes viteve 1990-1996. Në këto komuna brenda viteve 1989-90, pos vrasjeve dhe plagosjeve masive të shqiptarëve nga policia serbe bëhet edhe helmimi masiv i rinisë shkollore. Brenda viteve 1989-90 në këto dy komuna vriten: Ismet Qorraj (21), në Deçan u vra më 28 mars 1989, *Ali Hadërgjonaj* (31), u vra në Deçan më 28 mars 1989, *Agim Kukleci* (31) Deçan, u vra më 28 mars 1989, *Mujë Mehmetaj* (46), Deçan, u vra më 28 mars 1989, *Ragip Brahim Hasanmetaj* (23), Deçan, u vra më 30

janar 1990, *Rasim Moliqaj* (47), Pejë, u vra më 31 janar 1990, *Sylë H.Ukëhaxhaj*, (49), Deçan, u vra, më 30 janar 1990, *Fatmir Hazir Ukaj*, (18), Pejë, u vra më 31 janar 1990, *Gani Mal Daci*, (22), Pejë, u vra më 31 janar 1990, *Ali Niman Hasvukaj* (19) Deçan, Isniq, u vra më 13 janar 1990, *Qamil Sylë Morina* (19) Pejë, Loxhë, u vra më 31 janar 1990, *Osman Vokshi*, (66), Pejë, u vra më 16 shkurt 1990 (4:18-24).

Dhuna dhe terrori shtetëror në këto dy komuna vazhdon edhe pas vitit 1990, por me një intensitet të shtuar. Në komunën e Deçanit, në vitin 1992, pas maltretimeve brutale fizike, vdes drejtori i shkollës *Haki Pavataj*, në vitin 1992 në protestat e qeta policia ia shkul veshin *Sabrije Rexhepit*, ndërsa në vitin 1994 *Arian Currit* policia, pas rrahjes brutale në duar, në gjoks ia shkruan katër shkronjat «C» (që do të thotë "*Samo Sloga Spasava Srbiju*"- vetëm pajtimi shpëton Serbinë) shih fotoset:



Haki Pavataj, drejtor i Sh.f. «Bajram Currit» në Strellc, mbytet në zyret e policisë serbe.



Sabrije Rexhepi, viktimë e policisë serbe, së cilës ia shkëputen veshin.



Arian Curri, të cilit policia serbe me thikë ia shkruan kryqin me kater «C», «Samo Sloga Serbina Spasava» - vetëm pajtimi serbin e


Numrin e të helmuarve sipas institucioneve në këto dy komuna po e paraqesim në tabelën vijuese.

Pasqyra tabelare e të helmuarve në komunat e Pejës dhe të Deçanit

Nr.	Komuna	Nr. Emërtimi i institucioneve	Të helmuar	
			Numri	%
1	Pejë	1. Shkolla fillore (3)	226	27.4
		2. Shkolla e mesme (4)	461	55.8
		3. Studentë	31	3.7
		4. Të tierë	108	
		TOTAL	826	100
2	Decan	1. Shkolla fillore - Prilep	30	27.1
		2. Sh. f. «V. Frashëri»	53	47.7
		3. Studentë	7	6.3
		4. Të tierë	21	18.9
		Total	111	100

Në mesin e të helmuarve në këto komuna ishin edhe: *Sulltane Krasniqi, Florie Arifaj, Burbuqe Qetinaj, Belinda Ukella, Myrvete Berisha, Lirie Dobroshti, Mimoza Polluzha, Besa Muriqi, Emine Kelmendi, Rajmond Berisha, Leonor Azizukaj, Laura Demaj, Isa Smajlaj, Gjyle Gashi, Gjejlane Kelmendi, Hanife Selmani, Hasime Nimanaj, Sherie Krasniqi, Xhenete Podrimçaku, Bekim Mehmetaj, Luan Brahimi, Dashnore Shala, Jashar Goga, Paluze Doçiqi, Zeke Berisha, Mentor Berbati, Bukurie Nikçi, Luljeta Mekaj, Violeta Zekaj, Shpresa Ramaj, Tone Nikçi, Zelihe Gashi, Arieta Dervishaj, Arieta Podrimçaku, Shpresa Shabani, Shpëtimtare Shala, Suzana Ukella, Myvedete Zariqi, Lëndita Gashi, Violeta Deçani, Nurie Rexhaj, Hajrie Bytyçi, Valbon Shala, Besnik Qetinaj, Afërdita Bytyqi, Enver Mullaalia, Vidane Qeku, Mihrie Kelmendi, Dardane Krasniqi, Asdren Kukleci, Fedrike Nrecaj, Anton Berisha, Dafina Ukella, Arita Muhaxheri, Valdet Shoshi, Aida Demaj, Sahadete Blakaj, Afërdita Hajdarjakupi, Agron Alia, Elida Shala, Laura*

Lonçari, Medine Fejza, Ardian Kuçi, Leonora Xhocaj, Ajete Shala, Antigona Ibraj, Ardiana Kelmendi, Sali Berisha, Xhafer Tafaj, Jeta Laçi, Arieta Rexhaj, Afrim Harbuzi, Merita Katanolli, Drita Beqiraj, Besnik Mujaj, Pranvera Sylaja, Ardiana Shala, Laura Domeniku, Leonora Musaj, Anita Gërguri, Besa Biba, Lëndita Teslica, Marijeta Hoxha, Emine Alijaj, Ganimete Krasniqi, Sherife Nikçi, Shpresa Mujaj, Violeta Sadikaj, Shane Frakaniqi, Lume Muriqi, Antoneta Lushi, Vlora Nallbani, Sheqere Kukaj, Hajredin Feratoviq, Mentor Bërlajolli, Drita Berisha, Ernest Kasapi, Myrvete Daci, Valbon Avdiaj, Mentor Ibraj, Jeton Lajçi, Zuke Ukaj, Ndue Kamaj, Fahrije Shala, Manushe Mulliqi, Laura Mala, Ylfete Haziraj, Bajram Lajçi, Ferasete Gashi, Afërdita Shabanaj, Resmie Ademaj, Besnik Krasniqi, Florentina Lekaj, Nafije Daci, Gëzim Spahija, Arsim Spahija, Fatmir Fejzullahu, Edmond Shabani, Fetije Hasanaj, Sali Brahimaj, Shqipe Lokaj, Diana Zaraj, Naser Geqaj, Arbëresh Zeka, Flakran Metaj, Melihate Mustafa, Fikrete Berisha, Flori Berisha, Avdi Rexhaj, Muhamet Ibërdemaj, Zyrafete Thaqi, Ernest Shala, Lëndita Mermullaku, Besarta Blakaj, Shqipe Hatashi, Muhamet Lajçi, Veronik Maliqi, Emine Ferizi, Fadil Shabaj, Lulavere Shatri, Pakize Lajçi, Mirvete Thaqi, Shpresim Balaj, Arieta Nimanaj, Vahide Nimanaj, Elzane Rexhepi, Eleonora Gegaj, Berlinda Shkreli, Vezire Berisha, Argjentina Qarkaxhiu, Gëzim Brahaj, Hane Gashi, Merita Zabeli, Have Berisha, Vlora Balaj, Dardane Krasniqi, Emine Nikçi, Arbëresha Bojku, Hasime Muriqi, Besa Krasniqi, Valbona Koça, Mane Krasniqi, Majlinda Dreshaj, Ajete Shala, Muzafere Haxhijaj, Rejhane Hamzaj, Laura Mala, Afërdita Ahmetxhekaj, Adnan Xhikolli, Xhavit Lipa, Emine Murina, Musli Llukaj, Myvedete Zatriqi, Sabrije Beqiraj, Lumturie Kelmendi, Agim Balaj, Muhamet Blakaj, Muhamet Berisha (profesor), Bislim Shabanaj,



*Mujë I. Manxholli, rrahur më 12.10.1992,
nx. i Sh.m. «Luigj Gurakuqi» në Klinë*

*Haki Zekaj, Lulavere Kolenoviq, Teuta Balaj, Sevdie Haxhijaj,
Faruk Dervishaj, Segjat Xhikollaj, Fatmire Bakraqi, Blerta De-
maj, Qefsere Mumxhiu, Fatos Goranci, Nexhmije Sadrijaj, Ha-
sime Shpata, Lumturie Hoti, etj.*

DËSHMITË E DËSHMITARËVE

Për fenomenin e helmimit të qytetarëve të Kosovës, më së miri dhe në mënyrën më objektive dëshmojnë ata të cilët këtë krim e përjetuan në lëkurën dhe mbi supet e veta. Për këtë qëllim anketuam dhe intervistuam një numër të konsideruar të nxënësve dhe të arsimtarëve, të prindërve dhe të drejtorëve të shkollave të cilët me sytë e vet i panë skenat ose e përjetuan llahtarinë e tmerrshme. Sipas deklaratave të anëtarëve, atë tmerr nuk do ta harrojnë sa të jenë gjallë.

Dëshminë e parë, e fillojmë me deklaratën e *Halime Abazit*, nxënëse e shkollës së mesme «*Gjuro Gjakoviq*» të Podujevës.

Ajo deklaron:

«*Si çdo ditë, edhe më 22 mars 1990 në mëngjes u nisa për në shkollë. Pasi hyra në klasë ndjeva një erë që ma zinte frymën. Këtë e hetuan edhe shoqet dhe shokët e klasës. Dy nxënës u SHTANGUAN në klasë, ndërsa 20 të tjerë në oborrin e shkollës. Në oborr më kapluan DRIDHJE, KOKËDHËMBJA dhe VËSHITËRËSITË në FRYMËMARRJE. Pas tre - katër minutash e kam HUMBUR VETËDIJEN dhe më nuk di çka ka ndodhur me mua. Në SPITAL kam parë motrën pranë vetes. Mundimet që i kam pasur nga ky helmim i rëndë nuk mund t'i harroj kurrë.»*

Dëshmitarja e dytë është *Afërdita Ahmetgjekaj*, nxënëse e gjimnazit «*11 Maji*» në Pejë. Lidhur me helmimin ajo deklaron:

«Mësimin e vijonim me rregull, edhe pse kishim pengesa të mëdha. Atë ditë shkova në shkollë me disa shoqe. Ishte ora 12.30. Pasi hyra në klasë hetova një ERË, një KUNDËRMIM, I CILI MA ZURI frymën. Më kaploi një frikë e madhe. Ishte ky rasti i tretë që ndihej ky KUNDËRMIM. Dolëm jashtë së bashku me kujdestarin e klasës Demë Nikçin. Duke zbritur shkallëve, ndieja lodhje. Këmbët nuk më mbanin. Erdhi një shoqe të më ndihmonte. Në atë moment kam humbur VETËDIJEN. Shqetësimi në familje ishte i madh, sidomos kur pasojat na ishin të panjohura. Gjendja ime keqësohej gjithnjë më shumë. Kisha SHTRËNGIME të MËDHA. Koka më DHIMBTE shumë. Dhembjet ishin të padurueshme; nga dhëmbjet e mëdha të kokës humbja kontrollin. Në spital nuk jam shtrirë për shkak të situatës (pengesave të policisë, vr. e autorit). Prindërit e thirrën mjekun në shtëpi. Merrja barna dhe infuzion. Kjo gjendje ka zgjatur afro dy muaj e gjysmë. Pas dy muajve e ndieja veten më mirë. Tani jam studente e vitit të parë në SHLP-dega e mësimin klasor. Pasojat nga helmimi i ndiej edhe tash. Kam dhëmbje të shpeshta koke. Jam shumë e shqetësuar» (5.V).

Përjetimet e veta për helmimin që ndodhi në Prishtinë i shpreh edhe *Shqipe Gashi*, studente e vitit të dytë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Lidhur me përjetimet e veta kjo deklaron: «Ishin ditët e fundit të vitit shkollor 1989/1990. Ato ditë kurrë nuk do t'i harroj. Helmimi kaploi edhe klasën IV-4 të gjimnazit filologjik «Eqrem Çabej» në Prishtinë. Ishte 16 maji i vitit 1990, ora 15¹⁰. Nga oborri i shkollës ktheheshin në klasë nxënësit që kishin dalë në pushim të gjatë. Sapo hymë në klasë erdhën disa nxënës që mbanin në duar dy shoqe të klasës sonë. DRIDHESHIN, kishin SHTRËNGIME nënofullën e poshtme, në këmbë dhe në duar.

Kur pamë çka pamë, lajmëruam profesorët dhe menjëherë i çuam shoqet në spital. Të nesërmen, gjatë orës së dytë të mësimin,

një grup nxënësish filluan të qeshnin pa kurrfarë shkak. Në mesin e tyre isha edhe unë. Pas mbarimit të orës së mësimit kisha lodhje. Kur dola në oborr të shkollës HUMBA VETËDIJEN. Kur m'u kthye, isha mjaft e molisur. U qetësova pasi mora në spital një injeksion. Pesë ditë me radhë kisha dhëmbje në gjoks, në kokë dhe në qafë. Rasti më është përsëritur disa herë brenda muajve qershor dhe korrik.

Më humbte forca sa që nuk mund të lëvizja pothuaj asnjë pjesë të trupit, por kisha vetëdije. Pas intervenimit mjekësor, mundimet më kalonin, por kisha dhëmbje në nofullën e poshtme» (NM, VII). Prindi i vajzës Ljamie Kadriu, e cila pësoi nga helmimi, në deklaratën gojore, të cilën e dha më 23.IX.1991 në prani të dëshmitarëve Ali Bejta, Haki Berami dhe Ibrahim Bala, tha:

«Ljamie Mehmet Kadriu, e lindur më 16.10.1974 në Mitrovicë, nxënëse e Shkollës së Mesme Ekonomike. Ditën e parë të helmimit në Mitrovicë, më 22.III.1991, nuk kam qenë e helmuar, por atë ditë i kam ndihmuar dy shoqet e mia të klasës, të cilat ishin helmuar rëndë. Ato i kam përcjellur dhe jam kujdesuar për to edhe në spital. Të nesërmën jam helmuar edhe unë. Më kanë dërguar në Spitalin e Mitrovicës, ku kam qëndruar disa ditë. Pas daljes nga spitali jam sëmurë disa herë dhe jam dërguar për shërim në Spitalin e Prishtinës. Atje kam qëndruar disa ditë. Edhe pas qëndrimit në Spitalin e Prishtinës shumë herë jam sëmurë në shkollë dhe në shtëpi. Edhe gjatë ditëve të pushimit veror jam sëmurë disa herë. Kohëve të fundit kam qenë shumë e demoralizuar në jetë».

Profesori i gjuhës shqipe në shkollën e mesme «8 Nëntori» në Podujevë, deklaroi:

«Isha në shtëpi duke u përgatitur për mësim. Papritmas më erdhi lajmi se nxënësit ishin helmuar. Shpejt shkova në oborrin e shkollës së mesme «8 Nëntori». Pashë me sytë e mi llahtarinë

tmerruese. Nxënës të SHTANGUAR, PA VETËDIJE, prindër të përlotur, varg veturash që bartnin të helmuarit dhe i dërgonin në spital. Ishte paradita e 22 marsit 1990. Vetëm dy ditë më parë na u helmua punëtori teknik i shkollës. Në vendin ku kishte bërë pastrimin në korridor gjetëm PLUHUR të bardhë të gurëzuar. E morën punëtorët e Entit Higjenik të Kosovës, por për të kurrë asgjë nuk u kumtua! S'ka dyshim se nxënësit na i helmuan kriminelët profesionistë».

Arsimtari i helmuar i shkollës së mesme «8 Nëntori», korrespondentit të së përditshmes «*Veçernji list*» të Zagrebit i dha këtë deklaratë:

«Kur i pashë me sytë e mi masivisht duke u rrëzuar nxënësit në dysheme më kaploi një ndjenjë, të cilën kurrë në jetë nuk e kam përjetuar. Pas intervenimit mjekësor, edhe pse nuk isha plotësisht i shëruar, u ktheva në mësim».

Drejtori i shkollës teknike «19 Nëntori» në Prishtinë, lidhur me helmimin e nxënësve të shkollës së tij na dha këtë deklaratë:

«*Helmimi në shkollën e mesme teknike «19 Nëntori» në Prishtinë ndodhi më 3 prill 1990, në orën e parë të ndërrimit të dytë në klasën II. Në lokalet e klasës ndihej një ERË e rëndë. Ndihmë mjekësore kërkuan 12 nxënës, kryesisht vajza. U krijua tollovi. Ishim të shqetësuar. Filloi bartja e nxënësve për në spital. POLICIA e ARMATOSUR qëndronte në hyrje të shkollës. Edhe qytetarët na dolën në ndihmë. Gjashtë nxënës u ndalën në spital.*

Në shkollë mësimi u ndërpre, brenda hyri policia. Kërkonte shënime për nxënësit «IMITATORË», si i quajtën ata, dhe emrat e arsimtarëve që i dërguan nxënësit në spital. M'u kërcënuan mua që si drejtor lejova «IMITIMIN».

Disa herë ndodhi helmimi në shkollën tonë. Disa nga nxënësit u shëruan në spitalet e Prishtinës, Lubjanës, Zagrebit si dhe jashtë

/ në shtetet e Evropës Perëndimore /. Por, pati edhe të tillë, të cilët nuk arritën të shërohen. POLICIA atë ditë i mori shënimet dhe iu kërcënua arsimtarëve: *Afrore Berishës, Zijadin Ibrahimit, Vaxhid Beqirit, Vasfi Dokës, Haqif Kadriut, Hajdar Binakut, Qazim El-shanit, Shaban Gashit dhe Ragip Gjatës.*

Zonja Mara Gjoroviq, në deklaratën që e dha, ndër të tjera, tha: «*Helmimet ndaj shqiptarëve ishin të vërteta*». Edhe kjo vetë pësoi keq nga helmimi. Dhëmbjet e saj ishin të padurueshme. Kishte pengesa në frymëmarrje, dhëmbje koke e gjoksi.

Dëshmitë autentike të të helmuarve, jo vetëm që vërtetojnë se helmimi ishte realitet, por japin informacione për simptomet e helmimit, për sjelljen e policisë serbe, për kohën e helmimeve dhe kështu pasqyrën e helmimeve e bëjnë më të plotë këto deklarata:

"Në Zhur, më 22.3.1990 me të hyrë në klasë dy nxënës m'u ankuan se kishin dhëmbje koke. I dërgova në shtëpi. Kur u ktheva në klasë, një numër i nxënësve ishte alivanosur dhe kishin rënë në dysheme. Në klasë ndihej një kundërmim i rëndë, erë e padurueshme. Kërkova ndihmë nga kolegët. Por, edhe në klasët e tyre ishte një gjendje e tillë. Pa humbur kohë lajmëruam fshatarët dhe me traktorë e automjete të tjera i dërguam në spitalin e Prizrenit. Nxënësit kishin dhëmbje të kokës, pengesa në frymëmarrje, dhëmbje në stomak dhe shtrëngime në këmbë dhe në duar. Pas pak edhe unë ndjeva dhëmbje koke dhe ngërçe në stomak. Nxënësit e helmuar 10-20 ditë qëndruan në Spitalin e Prizrenit. Disa nga ata u dërguan edhe në Zagreb dhe në shtete perëndimore".

Mustafa Bislimaj:

"Atë ditë, derisa e bojkotonim mësimin, për shkak të helmimit të nxënësve të Podujevës, erdhi drejtori i shkollës dhe na tha: «Hyri në klasë!». Ishte ora e dytë. Në klasë hetuam një kundërmim - një erë. Pak nga pak, mua më filluan dhëmbje në stomak dhe në

kokë. Disa shoqe filluan të shtriheshin në dysheme, në korridore, e disa të tjera edhe në oborr. Më vonë humba vetëdijen. Isha i shtrirë në spital. Pas dy ditësh policia e kishte rrethuar spitalin. Ditën e tretë na larguan. Duke zbritur poshtë pashë dy motrat e mia të alivanosura. Pas disa muajsh, sëmundja m'u përsërit. Babain aso kohe e kisha në burg. Kur u kthye nga burgu më dërgoi në mjekim në Zagreb, më 13.11.1990. Në Spitalin e Zagrebit kemi qëndruar disa ditë. Më dhanë barna për qetësim. Pasi u kthyem në shtëpi pata përsëritje të sëmundjes. Babai më dërgoi në Zvicër. Atje kam qëndruar dy muaj. M'i kanë dhënë dy injeksione në qafë. Tani ndihem më mirë. Edhe motra ime e madhe ishte në mjekim në Zvicër.

Ende kam dhëmbje në kokë dhe të PARIT MË DOBËSOHET. Kjo po më nevrikos tepër".

Jalldyze Bunjaku, Gjilan:

"Si prind jam tepër e shqetësuar dhe e brengosur. Në kohën kur ka ndodhur helmimi kam qenë në burg. Tri vajzat më janë helmuar. Njëra është helmuar në shkollë, kurse dy të tjerat në spital. Jalldyzën, sipas të gjitha gjasave, e sulmoi helmi nervor".

Sabri Bunjaku, prindi i vajzave të helmuara: Jalldyze, Shukrie dhe Ramize Bunjaku:

"Ngjarja ka ndodhur më 22 mars 1990, në Gjilan. Ora 10 e paraditës. Dëgjoja radiorevistën 212. Në Kosovë situata ishte tepër e rëndë dhe e tensionuar. Për një moment ndërpritet muzika në valët e radios. Reporteri nga Podujeva jep lajme rrëqethëse. «E tërë Podujeva është ngritur në këmbë, janë helmuar mijëra nxënës». Me të dëgjuar lajmin i ftova shokët që kisha besim në ta dhe i informova për çdo gjë. Vendosiëm të organizonim një protestë për këtë veprë antinjerëzore dhe anticivilizuese.

Ashtu vepruam. Ndalëm edhe nxënësit e paraditës dhe u bëmë bashkë në një klasë më të madhe. Drejtoresha e shkollës, Radmilla

Sharac, kërkon udhëheqësit e protestës. Në zyrë shkuam tre veta-
kërkuam që drejtoresha t'u drejtohej nxënësve shqiptarë. Kërkuam
që ajo që ka ndodhur në Podujevë të mos ndodhte në shkollën tonë.
Vendosëm që të mos e vijoje mësimin, derisa nga Podujeva të
marrim informata më të qarta dhe më të sigurta. Pas urdhrit për
mësim, nxënësit filluan të ngjiteshin në kate mësimi. Nxënësit e
klasës së parë të Shkollës së Mjekësisë, me të arritur në katin e
dytë përplasen përtokë; piskama e tyre ishte e tmerrshme.

Marr vesh se një veturë me regjistrim të Vranjës ishte vërejtur
para oborrit të shkollës, dhe pas helmimit ajo ishte larguar.

Të shtoj edhe këtë: gjatë protestës katet 2,3 dhe 4 kanë qenë të
zbrazëta, andaj elemente të dyshimit kishte mjaft. Rastet e para të
helmimit, 70-80 veta, kanë kaluar pa probleme nga policia, ndërsa
organet e sigurimit, të ftuara nga drejtoresha, shumica shqiptarë
(hyzmeqarë të politikës serbe) arrijnë në shkollë. Me ARDHJEN
E INSPEKTORËVE U VËSHTIRËSUA BARTJA E TË
HELMUARVE. ÇDOKUSH që bartte të helmuar ishte në shën-
jestër e sidomos profesorët e shkollës.

Të gjithë të helmuarit u dërguan menjëherë në spital. Për
ndihmë të helmuarve u inkuadrua edhe një numër i madh i prak-
tikantëve. Masa e njerëzve ishte mbledhur para spitalit dhe pritnin
informata për fëmijët e tyre.

Aty rreth orës 19 vërejmë inspektorë të sigurimit së bashku me
policë të armatosur deri në dhëmbë. Në hyrje policia legjitimonte
dhe kontrollonte çdo njeri. «Vizita» e inspektorëve ishte e shkurtër.
Një inspektor e kishte fëmijën e vet të helmuar, ishte në hall të madh
e nuk guxonte të tregonte.

Natën e parë rasti më i rëndë nga të helmuarit ka qenë ai i
Sahide Sahitit, nxënëse e klasës IV/11, e cila ka qenë e shtrirë në
repartin e internos. Kjo nxënëse shembullore luftonte për jetë a

vdekje, ngërçe që nuk e lëshonin fare, kokëdhëmbje, temperaturë shumë të lartë. Kjo paciente, pas 3-4 muajve, shkon për t'u shëruar në Austri. Mjekët austriakë pranojnë se kishin të bënë me helmim. Është shëruar plotësisht. Tani është studente në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në gjendje tjetër të rëndë ishin edhe Mirishahe Limani, Burbuqe Klaiqi, motrat Valbona dhe Flora Hysniu, Nafije Isufi, Valdete Sherifi e shumë të tjera. Të nesërmën, më 23 mars 1990, policia kishte bllokuar tërë spitalin. Pas katër ditësh u largua nga spitali, sepse nuk e linte policia. Natën e dytë tre kolegë tanë u morën në polici. Në bisedë informative u morën edhe Musa Sabedini, Basri Kçiku, Ilir Matoshi, Visar Morina, Shqipe Agushi, Nexhat Buzuku dhe Nail Kçiku. Në bisedë informative m'u bënë shumë pyetje provokative si: «A e pranoni ju vlerësimin e Akademisë Ushtarake të Beogradit se në Kosovë nuk ka pasur helmime»? Kësaj pyetjeje iu përgjigja se më i rëndësishëm është vlerësimi i mjekut francez Baren Koenit, i cili pat deklaruar se për të konstatuar se a ka pasur apo jo helmim në Kosovë duhet të kalojnë së paku 6 javë. Më shtruan pyetje se kush i ka organizuar helmimet, si është bërë skenari, sa të holla i keni marrë për «teatrim» etj. Më janë kërcënuar me burgosje, me ndërprerje të shkollimit".

Një mospërgjegjësi të madhe kanë treguar atë kohë dekanati i Fakultetit të Mjekësisë, institutet dhe labororet, të cilat nuk ishin sa duhet syçelë. Me dinakëri politika serbe arriti ta heshtë helmimin e me këtë të heshtur sikur u pajtuan edhe shkencëtarët tanë. Populli mban mend shumë, dhe rastin nuk bën ta harrojmë kurrë, andaj ia kemi borxh kësaj popullate, qoftë me botimin e një libri shkencor apo në formë tjetër, që këtë të vërtetë ta plasojmë sa më parë në tërë botën (*Musa Sabedini, student i F. Mjekësisë në Prishtinë*).

Dëshmitë dhe deklaratat autentike të të helmuarve, të prindërve, të nxënësve, të arsimtarëve dhe të drejtorëve të shkollave janë argumente, para të cilave vlerësimet cinike serbe për gjoja teatralizëm kolektiv të mbi 7000 shqiptarëve dhe të dhjetëra të tjerëve të nacionaliteteve të tjera joshqiptare dalin jo vetëm joserioze, por edhe paditëse për ata që i dhanë këto vlerësime. Ja, këto janë dëshmi se ata që i dhanë këto vlerësime i dhanë jo pse nuk ishin të informuar, por pse kishin instruksione të drejtpërdrejta që kështu të deklaronin. Me këtë dëshmohet se këta janë bashkëpjesëmarrës në krimin e gjenocidit dhe si të tillë duhet të ndiqen para së drejtës dhe të gjyqit ndërkombëtar.

Natyra e helmeve dhe mënyra e helmimit

Natyra e helmeve dhe mënyra e helmimeve ishte një kohë të gjatë enigmë. Kjo enigmë, helmimin e mbështolli me velin e misteriozitetit. Shërbimet tona profesionale, gjendja e rëndë politike, presionet e përhershme serbe mbi institucionet e Kosovës, bënë që fëmijët e atakuar me helmim, që nga viti 1987 në komunën e Gjilanit, jo vetëm të mbesin nën «harresë» siç shkruan këto ditë Elviana Berani, por që edhe pakkujt t'i shkojë mendja që fjala është për helmim me helme kimike të luftës, të bërë nga vetë shteti. Për fëmijët e sëmurë të shkollës fillore «Abaz Ajeti» të Gjilanit në «Rilindjen» e 29 marsit të vitit 1987 shkruante se «mjekët nuk po mund të konstatojnë shkakun e sëmundjes». Sipas asaj, mjekët vënin në dukje se sëmundja nuk është ngjitëse, se ajo manifestohet me marramendje dhe alivanosje në kohëzgjatje prej disa sekondash, se të sëmurit në disa momente e humbasin vetëdijen. Thuhej, gjithashtu se pati raste që nxënësit edhe pas lëshimit nga spitali, të dërgohen për së dyti aty ngase nuk ndiheshin mirë (3;4. dt. 22 mars 1996).

Për gjendjen e rëndë të nxënësve të helmuar shkruajnë edhe mjetet e informimit në gjuhën serbe në të cilat theksohej: «...*simptomet e sëmundjes më shumë i gjasojnë neurozës, por se për shkaktarin e njëmendtë të saj nuk mund të thuhet asgjë pa arritur rezultatet e analizave të gjakut, të dërguara më parë në Institutin Toksikologjik në Novi Sad*». Në gazeta shkruante se «...*Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Gjilanit kishte mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme dhe kishte marrë vendim që përkitazi me këtë enigmë të papritur të niset procedura hetimore nga organet kompetente*». Mirëpo, as organet e hetuesisë e as rezultatet e analizave të gjakut asnjëherë nuk u komunikuan. Moskomunikimi i rezultateve të analizës së gjakut dhe të rezultateve të hetuesisë janë dëshmi se shteti kishte dorë në këtë helmim (3:4 dt.24 mars 1996).

Për natyrën dhe llojin e helmeve me të cilat u atakuan nxënësit shqiptarë të shkollës së mesme «*Luigj Gurakuqi*» të Klinës nuk u dhanë rezultatet e analizës së gjakut, edhe pse nxënësit u shtrinë në Spitalin e Prishtinës dhe të cilët atë kohë i vizitoi edhe dr. *Muhamet Bicaj*, tani ministër i Arsimit, Kulturës dhe Shkencës së Kosovës. Deklarata e dhënë e drejtorit të atëhershëm të Entit për Mbrojtjen Shëndetësore të Kosovës se «*supozohet se sëmundjen e shkaktoi avullimi i formalinës dhe se për shkaktarët e njëmendtë të kësaj sëmundjeje, që u shfaq papritur tek afro 60 nxënës do të dihet vetëm atëherë kur «Inkosi» bënë matjen e përbërjes së ajrit*». (3:5 dt.22 mars 1996). Siç del nga shkrimi i Elviana Beranit, dyshimi në formalinë buron ngase «*shumica e nxënësve të prekur nga sëmundja vijonin mësimin në laborator ku gjendeshin enët e qelqta, ku ish-in të konservuara pjesët e ndryshme të organeve të njeriut e të kafshëve*» (po aty: 3:5). Mirëpo, sa dihet ndër të sëmurët aso kohe kishte edhe nxënës që nuk kishin dëgjuar mësim në laborator. Dyshimin në organet e hetuesisë dhe në organet e

atëhershme kompetente të cilat ose nuk guxonin ta thonin të vërtetën, ose nuk guxonin të bënin analizat dhe të konfirmonin se fjala është për helme kimike të luftës, apo nuk ishin profesionalisht të përgatitur (që është pak e besueshme), e shton fakti se në kulmin e shkollës, pas një kontrolli që bëhet nga arsimitari i kimisë i kësaj shkolle dhe i cili shkruan: *«Në kulmin e ndërtesës ndihmëse të shkollës gjeta një shishe me substancë të panjohur... Ishte mbrëmje dhe avullimi ishte i vogël, por të gjithë (pjesëmarrësit e kontrollit të shkollës, ndienim dhëmbje koke, djegie sysh, dhe shtangim muskujsh me veprime të kohëpaskohshme. Shishen e dërguam për analizë në Prishtinë»*, shkruan z. Alush Duraku. Pas dy ditësh, përmes shtypit Enti Higjienik i Kosovës e publikon informatën se në shkollën e mesme *«Luigj Gurakuqi»* në Klinë, është gjetur një shishe me etiol! Në letrën e tij z. Alush Duraku shkruan në vazhdim: *«Unë dhe shokët e mi të profesionit ndiheshim edhe më të fyer. Thuajse kurrë nuk kishim ndier erë etioli, substancë, kjo të cilën e njeh edhe çdo qytetar i rëndomtë. Siç po shihni zbulimi i Entit të përmendur na kushtoi shumë shtrenjtë»* (3:5).

Natyrë e helmeve nuk u zbulua, as me rastin e testit të tretë eksperimental në shkollën e mesme të mjekësisë *«Boro dhe Ramizi»* në Prizren, arsimtarët e së cilës shkollë mostrat e gjetura ia kishin dërguar Entit Higjienik të Kosovës, por përsëri ky institucion e bëri veshin të shurdhër. Ky rast nuk është i fundit. Enti Higjienik i ish-in dërguar mostrat e gjetura edhe në shkollën e mesme *«8 Nëntori»* në Podujevë. Lidhur me këtë profesori i gjuhës shqipe i kësaj shkolle më deklaroi: *«Vetëm dy ditë më parë na u helmua punëtori teknik i shkollës. Në vendin ku kishte bërë pas-trimin në korridor gjetën pluhur të bardhë të gurëzuar. E morën punëtorët e Entit Higjienik të Kosovës, por kurrë asgjë s'u kumtua»* (15,8 *«Shkëndja»* dt. 10 shtator 1991).

Në raportin e konsorciumit të mjekëve, të formuar nga dekani i Fakultetit të Mjekësisë, në përbërje: prof. dr. *Izedin Osmani*, prof.dr. *Ymer Koçinaj*, prof. dr. *Stevan Balosheviq*, prof. dr. *Orhan Kubati*, prof. dr. *Voja Trajkoviq* dhe prof. dr. *Sasha Dobriçanin*, të mbajtur më datën 22 mars 1990 në orën 15 thuhet: «*Etiologjia e kësaj simptomatologjie do të përcaktohet pas analizës së gjakut, urinës dhe të përmbajtjes së tugës vjellëse, të cilat do të analizohen në laboratorët gjegjës toksikologjikë*». Konstatime klinike me simptomatologji janë evidencuar në historinë e të sëmurëve. Siç ngjau me rastet e mëparshme, ndodhi edhe me këtë deklaratë verbale. Asnjëherë nuk u publikua as etiologjia e kësaj simptomatologjie e as rezultatet e analizës së gjakut e as të urinës e as të përbërjes së vjelljes (tugës).

Gjatë muajit mars të vitit 1990 në Kosovë vjen mjeku i njohur dr. *Bernar Benedeti* i cili në Paris sollti mostra të gjakut të fëmijëve nga Kosova dhe i dha për analizë në dy laboratorë të Parisit. Në të dy vendet u zbuluan molekula kloroorganike - pohon dr. *Bernar Benedeti*. (5:22), i cili pohon: «*Herën e parë i pata marrë drejtpërdrejt në Spitalin e Prishtinës, në kushte mjaft të vështira. Kosovarët që ishin me mua atëherë këtë e dinë. Duhej të hynim fshehtas natën në spital dhe të marrim gjak nga fëmijët në mënyrë të fshehtë. Kam sjellë në Francë për afërsisht 150 epruveta me gjak që i kam marrë vetë dhe jo që mi kanë sjellë personat tjerë. Dhe ky gjak përmbante një përqindje të konsiderueshme, modifikime shumë domethënëse të helmit që gjendej në stigmatin e agjentit toksik në organizëm dhe në të njëjtën kohë tregonte ekzistimin e një molekule që nuk ishte identifikuar, por që ishte një molekulë që i gjasonte një substance toksike dhe e cila ishte dashur të identifikohet, punë e cila nuk ishte bërë më vonë. Në planin biologjik, hulumtimet që janë bërë kanë treguar ekzistimin e një helmi*» (21:20).

11 - MIJEK FRANCEZ PËR HELMIMIN E FEMIJEVE NË KOSOVË

«HELMIMIN E BËNË AGJENTËT E BEOGRADIT»

— i deklaroi dr. Bernard Benedeti korrespondenti të Agjencisë bulgare

SOAIF. — Në Kosovë gjatë pranverës me qëllim janë helmuar 3.000 njerëz me gaz deri më tash të përditshëm, i deklaroi korrespondenti të agjencisë bulgare BTA nga Parisi dr. Bernard Benedeti. Këtu demarsoi të publikoi origjinal i Partisë Socialiste «Duma».

Mjeku francez, i cili punon në spital në Ajçja, qëndroi në Kosovë në mars dhe në korrik të këtij viti. Në bashkëpunim me agjencinë BTA, deklaroi në transmeton gazeta «Duma», ky mjek bëri mostra të gjakut të fëmijëve nga Kosova dhe i dha për analizë në dy laboratore (d Parisi). Një të dy vendet u zbuluan me lloje të kloroformit - pëson Benedeti.

Mjeku francez i deklaroi gjithashtu korrespondenti të agjencisë BTA se - ka shikuar dokumentet: videot, filmat, xhirime e materiale të tjera, të cilat dëshmojnë se - ky krim është bërë nga agjentët e Beogradit me siguri agjentë ushtarakë. «Publikimin e këtyre dokumentave e ka ndaluar censura jugosllave» shkruan gazeta «Duma».

Benedeti përkujtoi se ai është bërë «helmimi»: - Shkollave u afroheshin automjetet nga të cilat nëpër ditare të çomave të mësimit hidheshin fishekë me gaz, elektik helmues i të cilëve ndjehej pas disa ditësh. Helmimi është bërë në 20-25 qytete të Kosovës, me ç'rast përjashtohet mundësia e incidentit të rastësishëm. I deklaroi mjeku francez korrespondenti të agjencisë bulgare BTA nga Parisi, Svetoslav Rezhevliu, (Tanjug) 20.4.90

Dëshmi e mjekut Bernard Benedeti për helmimin në Kosovë

Kosova, veçmas spitali, në atë kohë ishin nën kontrollin e policisë serbe, andaj një pjesë e punëtorëve shëndetësorë duke e ditur se organet e sigurimit shtetëror të Serbisë do t'i zhdukin jo vetëm dokumentacionin por edhe ekzemplarët e gjakut dhe të urinës, u detyruan që përmes kanaleve sekrete t'i qesin jashtë mostrat e gjakut për analizë në laboratorët ndërkombëtarë, por edhe në laboratorët e Lubjanës dhe të Zagrebit. Në këtë mënyrë u dërguan 40 mostra të gjakut. Me ftesën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë vjen një komision ndërkombëtar i përbërë nga dr. *Çarls Grejvs*, Komisioni Ndërkombëtar i Punëtorëve Shëndetësorë dhe të Drejtat Shëndetësore dhe të Njeriut, *Zonja Verena Graf* (Lidhja Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë e popujve dhe dr. Zhan Zhak Kikirijan.

Prej 23 deri më 30 mars 1990 në Kosovë patën qëndruar anëtarët e Delegacionit të Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut me seli në Paris, ndër të cilët: *FABIEN - Leonar RUSO*, *ANTON GARAPON*, dr. *Bernard Benedet* toksikolog (që të tre nga

Parisi), pastaj dr. *Xhon Foran* (Britani e Madhe) e deleguar nga Shoqata për Popuj të Rrezikuar si dhe *Guajn Roberts* i deleguar i Shoqatës Ndërkombëtare për popujt e rrezikuar.

Zhan Zhak Kirikijarian (Lëvizja Kundër Racizmit dhe për Miqësinë mes Popujve) (shih faksimilin).

Jam i njohtuar me faktin se në laboratorët e Zagrebit janë bërë analizat e mostrave dhe se është hetuar prezenca e gazit helmues "Sarin" të të helmuarit në Kosovë. - Me sa di unë, amerikanët ia kanë dorëzuar raportet e tyre dhe videoincizimet e helmimit në Kosovë Komisionit ndërkombëtar të Hagës për luftë kimike dhe biologjike. - Pse nuk u dërgua në Kosovë një komision zyrtar i OKB-së i cili do ta shqyrtonte rastin e helmimeve. - Si ekin punët në pashkësi të ndërkombëtare, del se njëzëri mund të vriten me armë kimike e biologjike dhe pastaj del se nuk mund të bëhen një informata zyrtare lidhur me këtë çështje. - Mendoj se dosjet për helmim në Kosovë do të duhej të depërtonin në Komisionin e Hagës për luftë kimike dhe biologjike. Si dhe në Tribunalin e Hagës për krimet e luftës në Ish-Jugosllavi. - Tribunali i Hagës është krijuar për të dënuar krimet e luftës e unë mund të konstatoj se krimi i tillë është edhe përdorimi i helmit "Sarin" në Kosovë.

Ky komision mes tjerash konstaton se: «...edhe pse nuk kishin në dispozicion pajisjen toksikologjike, megjithatë, beson se materia toksike mund të ishte organofosfati. Ata vërejtën kundërmimin e uthullit dhe djegien në pjesët nazale».

Lidhur me natyrën e helmit A. Hendriks deklaroi:

«Jam i njohtuar me faktin se në laboratorët e Zagrebit janë bërë analizat e mostrave dhe se është hetuar prezenca e gazit helmues sarin të të helmuarit në Kosovë. Me sa di unë, amerikanët ia kanë dorëzuar raportet e tyre dhe videoincizimet e helmimit në Kosovë, Komisionit Ndërkombëtar të Hagës për luftë kimike dhe biologjike».

Teza e shqiptarëve etnikë të Kosovës, që ishte mbështetur me shumë dokumente dhe dëshmitarë dhe ish-informuar nga autoritetet kredibile, se nga fundi i marsit 1990 kundër nënxësve dhe punëtorëve, kryesisht me origjinë shqiptare, ishin përdorur elemente kimike duket më e pranueshme se cilado teze tjetër e kundërt.

Në këtë rast dhe asnjë kundërgargument i natyrës mjekësore që do të dëshmonte se helmimi ishte aktim apo në çfarëdo mënyre hipotetik.

Duke pasur parasysh një çështje të rëndësishme kaq të madhe, vetëm argumentimi dhe theksi shkencorë që do t'i kryenin profesionistëve të akredituar, do të mund të ishte i pranueshëm.

Për këtë arsye kërkohet që misioni i ekspertëve, nën autorizimin e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Nënkomisionit mbi Pengimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave të dërgohet në Kosovë për të shqyrtuar të gjitha elementet në dosjet dhe për t'i intervistuar të gjitha viktimat.

Faksimil: Raport i Komisionit Ndërkombëtar për helmimet në Kosovë, botuar në «Zëri»

Pse nuk u dërgua në Kosovë një komision zyrtar i OKB-së, i cili do të shqyrtonte rastin e helmimeve, si ecin punët në bashkësinë ndërkombëtare, del se njerëzit mund të vriten me armë kimike e biologjike dhe pastaj del se nuk mund të bëhet një informatë zyrtare lidhur me këtë çështje. Mendoj se dosjet për helmimin në Kosovë do të duhej të depërtonin në Komisionin e Hagës për luftën kimike dhe biologjike, si dhe në Tribunalin e Hagës për krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Tribunali i Hagës është krijuar për të dënuar krimet e luftës, e ne mund të konstatojmë se krim i tillë është edhe përdorimi i helmit sarin.

Dritë të re në natyrën e helmimeve hedh ish-kryetari i Kryesisë së ish Jugosllavisë, *Stipe Mesiq*, kurse tani lider i demokratëve të pavarur kroatë (DPK), i cili në vitin 1991 deklaroi dhe dëshmoi në Kongresin e SHBA-ve «...se pos armëve në Çekoslovakia u siguruan edhe sasi të mëdha të helmit të rrezikshëm që u shfrytëzua më parë kundër popullësisë shqiptare në Kosovë». Ky në këtë dëshmi deklaroi se fjala është për dy lloje të helmeve nervore (*Tabun*, *Soman* dhe *Sarin*) dhe ngulfatëse (*klorifozgen* dhe *difozgen*). Më vonë një deklaratë të tij që ia dha gazetës kroate «*Slobodna Dalmacia*» disa pjesë të së cilës i përcjell gazeta «*Bujku*» më 2. XII.1995, ky konfirmon faktin se Jugosllavia kishte *Sarinin* dhe vetë kjo e prodhonte këtë gaz. Ky këtë informacion e kishte marrë nga «një gjeneral i sotëm i ushtrisë kroate». Në raportin të cilin ky: «...fshehurazi ua dërgon amerikanëve në vitin 1991 dhe në të cilin konstaton se afër Mostarit Armata Popullore e Jugosllavisë...prodhonte gazin helmues sarin (shih faksimilin.) e konfirmon faktin se APJ, jo vetëm që e prodhonte këtë gaz të rrezikshëm, por kishte dorë në helmimin e qytetarëve të Kosovës, krejtësisht shqiptarë».

STIPE MESIĆ I DER EDPK SE NË "SLOBODNA DALMACIA"

Dokumentet për APJ-në i dërgova më 1991 në Pentagon

Ish-kryetari i Kryesisë së RSPJ-se pohon se informalën së APJ prodhon gazin helmues sarin dhe bashkëpunon me irakianët e dërgova në Pentagon ngaqë konsideroja se "aktiviteti i tillë ishte rrezik për mbare bashkësinë ndërkombëtare"

Lideri i Demokracisë të Paruar Kroate (DPK) dhe ish-kryetari i Kryesisë së RSPJ-së Stipe Mesić deklaroi se në vitin 1991 amerikaneve ishin urazur në ka dërguar dokumentet për aktivitetet e Armatës Popullore Jugosllave.

Mesić "Slobodna Dalmacija" i deklaroi se nga "një gjeneral i shtetit ushtarak kroat" ai i dërgoi informata se APJ në prodhimin e Mostarit prodhonte gazin helmues sarin e se me irakianët punonte rreth lansimit të tij në tokë. Stipitezova rastin të disa qerqe të ndërmarrës amerikane i informoi për rastin e tërësisht dhe ata menjëherë pas kësaj me organizuan transportin në SHBA. Këtu dërgova dokumentet nëpunëve të autorizuar të Pentagonit, tha Mesić. I cili mësoi ishte kryetari i Kryesisë së RSP të Jugosllavisë.

"Konsideroja se aktiviteti i tillë është rrezik jo vetëm për këtë rajon, por edhe thuhet me gjere për mbare bashkësinë ndërkombëtare, e ngaqë ishte e evidente se lufta do të shpërthehte tashmë të supozohet se përdorimi eventual i këtyre gazave do të mund të shkaktojë katastrofë në Kroaci", shtipjeqi Mesić.

At tash të edhe amerikanët me dehur ditëzimit të dërguar që në dërgoi ai, e de me dehur nëpërmjet kanalëve të caktuar të tërhoja vete të Serbisë, i as që vetejje parandaloj përdorimit të atyre helmëve. Mesić thotë se disa përjekje të prodhimit të gazave helmues) ka pasur në BH, por edhe të në (Kroaci) vetejje që ai dekjekturës, por disa më pak të rrezikshëm nëse mund të thuhet fare kështu!

Stipe Mesić dëshmon për prodhimin e gazit sarin nga Armatë Popullore e ish-Jugosllavisë.

Këtë konstatim të Stipe Mesićit do ta verifikojë më vonë edhe majori britanik *David Graig*, ekspert për helme ushtarake, i cili vizitoi fabrikën të cilën APJ-ja e kishte braktisur në janar të vitit 1992, para fillimit të agresionit në atë rajon, dhe pasi i kishte transferuar pajisjet industriale në Serbi. Në bazë të të dhënave që ky i ka mbledhur ka konstatuar se: «Në fabrikën ushtarake në Potoci, Jugosllavia e ka prodhuar dhe nga kjo fabrikë i kanë shkuar dërgesat *Sadam Hyseini* në Irak».

Një dallim i vogël që vërehet mes këtyre dy deklaratave të Stipe Mesićit, mund të jetë e mundshme që Jugosllavia të ketë blerë një

sasi të helmeve në Çekosllovakia, siç thotë ky, por kjo këtë e bën ose për t'i fshehur gjurmë ose për të prodhuar vetë substancën e këtille.

Pasiqë u dhanë argumente të mjaftueshme për gazin e përdorur kundër të rinjve kryesisht shqiptarë, është e domosdoshme t'i themi edhe disa fjalë për këtë gaz.

Sarini bën pjesë në helmet luftarake nervore, të familjes së *trilonit* ku bëjnë pjesë edhe *Tabuni* dhe *Somani*. *Sarini* (izopropil estri i acidit metil fluorofosforik, dhe *Somani* pinokoli estri i acidit metil fluorofosforik, si dhe *Tabuni* depërtojnë nëpër: lëkurë, mukozë, traktin respirativ e digjestativ dhe e frenojnë fermentimin (enzimin) e kolinesterazës. Pasojë e kësaj është grumbullimi acetyl kolinës në gjak, inde dhe organe, në sistemin nervor qendror, në sistemin nervor periferik, andaj dihet djegia e mukozës, bëhen shtrëngime, dhëmbje të mëdha të kokës, ngërçe, pengesa në frymëmarrje, stomak etj. Se fjala është për këto helme tregon edhe raporti i Klinikës së Kirurgjisë në Prishtinë ku thuhet se «... rezultate e analizave tregojnë ndryshime të dukshme të parametrave biokimikë, madje pikërisht të atyre parametrave të cilët rëndom pësojnë ndryshime të helmimit me agjense toksike. Bie fjala, përmes analizës së kalciumit tek 10 pacientë u pa se të gjithë kishte hiokallcemi, kurse përmes analizimit të aktivitetit të kolinesterazës, e cila bie tek disa lloje të helmimit me agjense toksike), analizë kjo që ku bë tek tre pacientë të trajtuar në këtë klinikë, në dy raste konstatohet vlera dukshëm e zvogëluar e saj. Po kështu tek 6 pacientë këtu, qenë bërë edhe analizat transaminazës të cilat sillen në kuadër të kufijve normalë.

Mirëpo, kur pas dy ditësh 3 pacientë nga këta gjashtë i qenë nënshtruar sërish kësaj analize qenë zbuluar tek dy prej tyre vlerat e transaminazës ishin dukshëm të të rritura» (3:6 «Bujku» dt. 26

mars 1996). Kur kihen parasysh simptomet e të helmuarve, me këto shpjegime teorike të natyrës së këtyre gazërave, si dhe kur e marrim për bazë studimin e bërë, por edhe konstatimin e ekspertëve me renome ndërkombëtare, është i pranueshëm dhe i pakontestueshëm konstatimi se fjala është për gazin *sarin*.

Cilat ishin simptomet e të helmuarve

Me qëllim që simptomatologjinë e manifestuar të të helmosurve ta prezentojmë në mënyrë sa më objektive, do t'u referohemi mendimeve të mjekëve shqiptarë, konsorciumit të mjekëve, të formuar nga dekani i Fakultetit të Mjekësisë të Prishtinës, simptomet e regjistruara në raportin e Komisionit ndërkombëtar si dhe me simptomet e regjistruara me rastin e studimit tonë në mostrën prej 300 - vetave - viktimave të helmeve kimike të luftës. Meqë, simptomet e evidencuara nga konsorciumi i mjekëve të Fakultetit të Mjekësisë, janë të parat dhe më zyrtare, ne do t'i prezentojmë ashtu siç figurojnë në raportin e dhënë më 23 mars 1990. Në raport thuhet: «*Pasqyra klinike është polimorfe, e përcjellur me të skuqur të fytyrës, me të skuqur të lehtë të konjektivës, ngërçe, (shtrëngime - H.H.) në stomak, me alivanosje dhe frymëmarrje të vështirësuar pa sindrom infektiv pa puçërrza nëpër trup*». Kështu thuhet në raportin e konsorciumit të mjekëve të përbërë, siç u theksua më parë, nga 6 mjekë, në mesin e të cilëve ishte edhe prof.dr. *Stevan Balosheviq*, i cili sërish këto ditë thekson se ishte ky një aktrim i madh kolektiv i shqiptarëve(1:8-10), më pastaj në këtë komision ishin edhe prof. dr. *Voja Trajkoviq* dhe prof. dr. *Sasha Dobriçanin*. Me qëllim të argumentimit të kundërthënieve në deklarata të prof.dr. *Stevan Balosheviqit*, në faksimilet e mëposhtme i prezentojmë mendimet kundërthënëse:

- Bio sam tada član jednog ekspertskeg tima, formiranog od nadležnih organa da ispitamo čitav slučaj. Posle svih pregleda i analiza, jasno i jednoglasno, a to je bio mešoviti sastav, zaključili smo da nije bilo nikakvih znakova trovanja, niti simptoma bolesti kod onih koji su dolazili na naše klinike. Ta međunarodna misija, da je htela prave podatke, došla bi kod nas.

Kontraverzat e prof. dr. Stevan Balosheviqit

Spec. dr. *Flora Brovina* në vërtetimin që ia lëshon së helmuarës *Hyre Ajeti*, shënon: «Në momentin e helmimit pacientja ishte në punë ku punon si mirëmbajtëse e higjienës në shkollën fillore «*Asim Vokshi*» në Prishtinë. Në shkollë helmimi është bërë më 28 mars 1990, në toalet dhe në korridorin afër toaletit të shkollës, ku mësonin fëmijët shqiptarë. Simptomet e para të sëmundjes ajo i ndien si të helmuarit e tjerë: një erë e rëndë djegëse në hundë dhe në organet e frymëmarrjes, kokëdhëmbje, marramendje, lotim, më vonë dridhje të tërë trupit...Ditën e parë të helmimit pacientja shtrohet në klinikën infektive në Prishtinë..."

Në raportin e Komisionit ndërkombëtar, të përbërë nga *Çarls Grejv*, *Verena Graf* dhe *Zhan Zhak Kirirjanu* thuhet: «Simptomet e sëmundjes së viktimave që i përshkruan këta punëtorë shëndetësorë ishin si vijojnë: (simptome të ngjashme përmenden në të

gjitha deklaratat mjekësore që na janë dorëzuar. (1) Konjuktivi, (2) bebëzat e zmadhuara, (3) vjellja, (4) tensioni kalimtar i lartë, (5) pavetëdija, (6) paaftësia për të ecur, (7) veshët e skuqur, (8) mukoza e thatë në buzë, (9) ngërçi dhe kontraksionet, (10) kokëdhëmbjet e mëdha, (11) humbja e të pamurit, (12) rrahja e shpejtuar e zembrës, (13) vajtimi». Po në këtë raport prezentohen edhe simptomet e një gruaje shqiptare nga Gjakova, e cila dëshmoi para këtij komisioni. Lidhur me këtë në raport thuhet: «Një punëtore e helmuar, një grua 25-vjeçe, dëshmoi para nesh. Ajo ndjeu kundërmimin në ora 10:30, disa punëtorë ranë në tokë, shumë të pafuqishëm.

Qëndruan në spitalin e Gjakovës pesë ditë. Pas 10 ditësh u kthyen në punë, por ajo u detyrua që të ndërprejë punën për shkak të ndjenjës së pafuqisë».

Për simptomet e sëmundjes ky komision merr të dhëna edhe nga mjekët e Prizrenit. Lidhur me këtë thuhet: «Të njëjtën ditë ekipi ynë vizitoi Spitalin e Prizrenit, ku intervistuaam urologun kryesor, ndihmësit e tij dhe një oftomolog. 240 viktimat e helmeve të 23 marsit ishin nga Prizreni dhe lokalitetet përreth dhe qenë vendosur në të gjitha pavijonet e spitalit. Mirëpo punëtorët shëndetësorë nuk dinin se çfarë ishte shkaktari i kësaj sëmundjeje. Zbuluam një sasi të parëndomtë të proteinës në urinën e viktimave. Mjekët serbë nuk deshën të flasin dhe deklaruan se kjo ishte një «komedi» e shqiptarëve. Simptomet ishin : 1) reagimi i bebëzave të syve, 2) tensioni i lartë, 3) konjuktivi, 4) vajtimi, 5) kokëdhëmbja, 6) dhëmbja e barkut, 7) vjellja" etj.

Lidhur me simptomet e sëmundjes *Halime Abazi*, nxënëse e shkollës së mesme «*Gjuro Gjakoviq*» në Podujevë, deklaroi: "*Pasi hyra në klasë hetova një erë që ma zinte frymën. Këtë e hetuan edhe shoqet dhe shokët e mi. Dalim në oborr të shkollës. Dynxënës u shtanguan në klasë, ndërsa 20 të tjerë në oborr. Në oborr më*

kapluan dridhjet, kokëdhembja dhe pata vështirësi në frymëmarrje. Pas 3-4 minutash kam humbur vetëdijen dhe më s'di çka ka ndodhur me mua". E helmuaara Shqipe Gashi lidhur me simptomet deklaroi: "Më 16.5.1990, në orën 15:10 nga oborri i shkollës ktheheshin nxënësit që kishin dalë në pushim të gjatë. Sapo hymë në klasë erdhën disa nxënës që po i mbanin në duar dy shoqe të klasës sonë. Dridheshin. Kishin shtrëngime në nofullën e poshtme, në këmbë dhe duar. Të nesërmen gjatë orës së dytë të mësimit një grup nxënësish filluam të qeshnim pa kurrfarë shkakut. Në mesin e tyre isha edhe unë. Pas mbarimit të orës së mësimit kisha lodhje. Kur dola në oborr të shkollës e humba vetëdijen, forca më kishte humbur, kisha dhëmbje në nofullën e poshtme". Hasime Nimanaj, nxënëse nga Peja, për simptomet deklaroi: "Kisha marramendje, dhëmbje në stomak, provoja t'i nxirrja gishtërinjtë etj". Të njëjtat simptome i përmend edhe Jalldyze Bunjaku, e cila deklaroi: «...e hetuam një duhmë, një erë të rëndë. Pas pak mua më filluan dhëmbjet në stomak dhe në kokë. Disa shoqe filluan të bijnë në dysheme, disa në korridor e disa në oborr. Më vonë humba vetëdijen".

Në gjurmimin e simptomeve kemi intervistuar 300 të helmuar. Në përpunimin statistikor të të gjithë kemi konstatuar simptomat të cilat edhe u përmendën këtu: dhëmbje të padurueshme në kokë, qafë, në nofullën e poshtme, në stomak, shpinë, ngërçe të mëdha, alivanosje, pengesa të mëdha në frymëmarrje, frikë dhe nervozë, humbjen e fuqisë, etj.

Simptomat më të shpeshta të manifestuara te të helmuarit

Studimi i simptomatologjisë nga aspekte të ndryshme dhe kënde të ndryshme si dhe nga subjektët e ndryshëm, pamëdyshje vërtetojnë për një kompaktësi të madhe të simptomeve të manifest-

tuara, të cilat ndikojnë që të hidhet hipoteza gjenerale e definuar në fillim të studimit dhe të pranimit si dhe të vërtetimit të hipotezës tjetër alternative se në Kosovë pati helmim me gazin kimik të luftës, të njohur me emrin «Sarin» të cilin e prodhonte Armata Popullore e ish-Jugosllavisë. Pjesën e parë të këtij konstatimi e vërteton edhe konsorciumi i mjekëve, simptomet e manifestuara të të helmuarve të krahasuara me njohjet e vërtetuara shkencore të etilogjisë mes helmeve luftarake dhe simptomeve të cilat shkaktohen tek njerëzit e atakuar me këto helme, kompaktësia e manifestuar tek të gjithë të helmuarit, pa marrë parasysh moshën. (Me këto bie poshtë teza për histeri dhe neurozë kolektive, apo histeri konvulzive), si dhe konstatimet e Komisionit ndërkombëtar ku thuhet: «*Sa u përket elementeve kimike që janë përdorur, është e mundshme plotësisht që kjo të ishte ndonjë organofosfat i ngjashëm me atë që ishte përdorur kundër kurdëve në kampet e refugjatëve në Turqi*» (9 shkurt 1990). Po ashtu, sipas indikacioneve të tjera, mbase ishte përdorur «CN» për kontrollimin e turmës. Në fund, duket se shteti i Serbisë kishte përdorur armë helmuese kundër shqiptarëve etnikë të Kosovës, sidomos kundër nxënësve dhe punëtorëve të fabrikave.

Kush ishin hedhësit e helmeve

Në këtë studim janë bërë përpjekje që të qitet sado pak dritë në hedhësit e mundshëm të helmit kimik të luftës. Gjatë studimit në i kemi regjistruar disa aspekte të këtij problemi, por nuk kemi mundur t'i vërtetojmë dhe t'i identifikojmë plotësisht ata të cilët ishin hedhësit e drejtpërdrejtë të helmeve. Në këtë studim, në bazë të fakteve relevante, është e pakontestueshme se bartëse e drejtpërdrejtë ishte ish-APJ, e cila, siç u konstatua së voni, ishte edhe

prodhuese e këtij gazi neurotik. Dëshmitë e *Stipe Mesiqit*, *David Greigut*, mostrat e gjetura, kanë bërë që konstatimi i dr. *Bernar Benedetit* se «*ky krim është bërë nga agjentët e Beogradit me siguri agjentë ushtarakë*» do të dalë i saktë. Këtë konstatim e vërtetojnë edhe disa konstatime të tjera si ai i shkollës fillore «*25 Maji*» në Ferizaj, ku thuhet se: «*...duke bërë veprime të dyshimta kanë parë një ushtar të pidentifikuar, dy herë të tjera policë, dy herë të tjera dy nxënës të nacionalitetit serb, një herë arsimtaren e gjuhës serbokroate dhe një herë shtëpiakun e shkollës - i nacionalitetit serb*».

Pak dritë, por që e vërteton mendimin se shteti ka qenë i përzier në këtë krim, jep edhe korrespondenti i «*Veçernji list*» të Zagrebit, gazetari *Shefki Ukaj*, i cili, lidhur me helmimin në Podujevë, mes tjerash, shkruan: «*Jozyrtarisht jemi informuar se në SPB të Podujevës janë arrestuar 7 njerëz, me dyshim se janë marrë me këtë punë të ndytë*». Në Podujevë i riu *Gani Babatinca* e zuri një të ri të nacionalitetit serb, ia dorëzoi policisë në Podujevë. Mirëpo, në vend se i dyshimti merret në hetuesi, Ganiu burgoset dhe keqtrajtohet brutalisht nga policia serbe dhe dënohet me 5 vjet burg me pretekst se ka rrahur të riun malazez. Pasi i mban tre vjet burg, lëshohet dhe ky pas burgut ikën jashtë.

Korrespondenti i «*Rilindjes*» nga Podujeva, në datën 23 mars 1990, u interesua për disa të dyshimtë, të cilët i zunë qytetarët e Podujevës dhe të cilët i dërguan në polici. Ky reporter, siç shkruan në «*Rilindjen*» e 23 marsit 1990, u interesua në SPB për të dhëna. Mirëpo, punëtorët e autorizuar i iknin insistimit tonë, duke i rrudhur supet se nuk mund të jipnin shënime!

Diç e ngjashme ndodhi edhe në oborrin e spitalit, kur një serb e kishte hedhur para derës së Klinikës së Kirurgjisë helmin. Nga ky helm i hedhur bie përtokë një kalimtar i rastit. Njerëzit të cilët

u gjenden pak më larg e rrethuan të dyshimtin. Ky ishte me veturën «Zastava 101», me ngjyrë të bardhë, me targë: *TM - 20-77* (*Mitrovica e Titos*, siç quhej dhunshëm atëherë Mitrovica). Roja e fakultetit mundohet ta ndalë, por ajo nuk ndalet derisa turma e njerëzve nuk e rrethoi. Vozitësi del nga vetura me automatik në dorë duke e sharë turmën dhe nënën shqiptare. Pasi e thërrasin policinë vozitësi futet brenda në veturë dhe «u dorëzohet»! Kështu shkruajnë reporterët e «*Botës së Re*» më datën 1 prill 1990. Duke gjuarmuar dhe studiuar e kemi gjetur edhe fotografinë e kësaj veture. Shih fotografinë!



Vetura me të cilën u hodh helm në Spitalin e Prishtinës.

Këto të dhëna tregojnë dhe vërtetojnë edhe më shumë faktin se në helmimin e të rinjve kryesisht shqiptarë jo vetëm që kishte dorë

ushtria, por kjo në këtë krim bashkëpunoi me policinë dhe me mjekët e nacionalitetit serb, me nxënës dhe arsimtarë. Represioni që ushtrohej mbi mjekët shqiptarë, mbi të helmuarit, mbi të gjithë ata që i ndihmonin të helmuarit, mbi komisionin ndërkombëtar, mbi të gjithë ata që gjurmonin dhe tentonin t'i kapnin dhe t'i identifikonin hedhësit e helmeve, jo vetëm që kishte për qëllim fshehjen e gjurmëve të helmit, por njëherit është dëshmi se vetë pushteti i atëhershëm jugosllav kishte dorë në këtë krim. Këtë argument e bën edhe më bindës dëbimi i Komisionit ndërkombëtar, prandaj në vazhdim do të flitet dhe analizohet sjellja e policisë serbe lidhur me helmimet.

Pse policia serbe bënte presion dhe pengonte shërimin e të helmuarve

Gjatë gjurmimit të fenomenit të helmimit, jemi nisur nga traditat dhe të arriturat civilizuese juridike ndërkombëtare, por edhe nga aspekti juridik i Kodit Penal (Ligjit Penal) të ish-Jugosllavisë. Si në të drejtën ndërkombëtare (Konventën për pengimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, të cilin ish-Jugosllavia e ka ratifikuar në vitin 1950), ashtu edhe në Ligjin Penal të Jugosllavisë helmimi (me të cilin qëllimisht bëhet shfarosja sistematike e grupeve të tëra nacionale dhe racore, etnike, gjuhësore dhe fetare përmes : a) vrasjes së anëtarëve të grupit, b) të shkakuarit të plagëve të rënda fizike dhe shpirtërore anëtarëve të grupit, c) imponimit të qëllimtë grupit, kushtet e pavolitshme për jetë me synim të shfarosjes së plotë apo të pjesërishtme të anëtarëve të grupit, ç) miratimit të masave për pengimin e lindjeve dhe d) transferimit me dhunë të fëmijëve prej një grupi në grupin tjetër), ashtu siç kemi thënë edhe më parë «aktkrimi është në kundërshtim

të plotë me frymën dhe qëllimet e KB dhe të civilizimit», prandaj organet e hetuesisë, të pushtetit dhe të sigurimit të ish-Jugosllavisë kanë pasur për detyrë që të organizojnë hetimet dhe kriminelët e këtij akti të marrin dënimin e merituar.

Kjo, tani pas shumë argumenteve që u prezentuan në këtë studim, e bën të qartë qëndrimin e pushtetit të atëhershëm të Jugosllavisë dhe të Serbisë. Jugosllavia dhe Serbia assesi nuk kanë mundur të ndjekin vetveten, përkundrazi, aparatit shtetëror e vejnë në shërbim të pengimit të gjurmimit të së vërtetës për helmim. Në rend të parë japin urdhër të pengojnë të gjithë të helmuarit që të vendosen në spitale dhe ambulanca shëndetësore. Për këtë qëllim në oborret e spitaleve, para ambulancave shëndetësore vihen kordone të shumta policore për dëbimin dhe pengimin e viktimave të helmimit që të hospitalizohen apo të marrin ndihmën e nevojshme mjekësore. Në ditët e para të helmimit, më 19,20,22 mars 1990, askujt nuk i shkonte mendja se policia do të pengonte ndihmën mjekësore, kush nuk mendonte se shteti dhe aparati i tij policor do t'i pengojë qytetarët e vet, të cilët pësuan një akt krimi, të kërkojnë dhe të pengohen që të marrin ndihmë nga mjekët dhe institucionet e tyre shëndetësore. Natyrisht, kur flasim për këtë nuk i kemi parasysh provokimet individuale të policisë, me të cilat shqiptarët ishin mësuar. Si në të gjitha rastet e tjera, edhe më rastin e helmimit, policia, rrinte afër, vëzhgonte dhe nuk reagoonte.

Mirëpo, kur prof. dr. Stevo Balosheviq helmimin e cilësoi si aktrim kolektiv të shqiptarëve (sipas të gjitha gjasave këtë vlerësim ky e mori nga instancat zyrtare shtetërore, sepse këtë vlerësim ky e dha pak kohë pasi e kishte nënshkruar raportin e Konsorciumit të mjekëve), intervenimet e policisë filluan të shpeshtohen pas 24 marsit të vitit 1990, për të marrë një intensitet më të theksuar në fillim të prillit e më tutje. Ishte kjo edhe një goditje e rëndë mbi

popullin shqiptar, andaj me të drejtë *Kristina Fon Kol* deklaroi: «*ishte kjo edhe një hedhje e zjarrit në varrën e hapur*». Policia për ditë e më tepër ishte më agresive. Kjo tani jo vetëm që pengonte shërimin e të helmuarve, por filloi t'i marrë në biseda informative arsimtarët, të cilët ofronin ndihmë. Me qëllim që të ushtrohet frika mbi shqiptarë burgosen dy mjekë shqiptarë dhe motra mjekësore. «*Policia u ishte kërcënuar punëtorëve shëndetësorë në Prizren, për shkak të dhënies së informatave. Të gjitha dosjet e viktimave ishin dërguar në stacionin e policisë dhe kurrë nuk ishin kthyer. Megjithatë, mostrat e gjakut ishin dërguar në Komisionin e pavarur të drejtuar nga dr. Dolenc në Zagreb. Në të gjitha rastet i kishte marrë në pyetje mjekët*». Në raportin e dr. *Çarls Grejvsit* etj., përmendet edhe rasti i një punëtoreshë të helmuar në Gjakovë, e cila «*...ishte ftuar pesë herë në polici, shpesh duhej të priste me orë të tëra para marrjes në pyetje*» (23:16-18).

Pasiqë numri i të helmuarve, pas 22 marsit në Kosovë filloi të shtohet pa masë, ndërsa policia serbe vendosi të pengojë hospitalizimin e të helmuarve nëpër ambulanca dhe spitale të Kosovës (p.sh. policia serbe e Ferizajt lejonte dërgimin e të helmuarve vetëm në Shkup) më 23 mars në Kishën Katolike në Ferizaj hapet një ambulancë e improvizuar me 27 shtretër. Kjo ambulancë u hap me lejen e dr. dom *Lush Gjergjit*, humanistit dhe atdhetarit të palodhur nga Ferizaj. E njëjta gjë u bë edhe në Kishën Katolike në Binçë të Vitisë.

Me përhapjen e lajmit për hapjen e këtyre ambulancave, policia tri herë bëri përpjekje për të hyrë brenda, por të tri herat kundërshtohet nga Dom Lush Gjergji, me arsyetim se frikësohen të sëmurët.

Këto dy kisha disa muaj rresht u ofronin ndihmë të helmuarve. Lidhur me ndihmën e ofruar motrat e nderit deklarojnë:

*«Në fillim e kishim jashtëzakonisht vështirë t'i përballonim vuajtjet e pacientëve gjatë dhënies së ndihmave, sepse më parë nuk kemi pasur rast të mjekojmë dikë nga ato sëmundje». Si të mos çmendesh kur në Evropën e civilizuar mund të ndodhë diç e tillë... do të ishte fat sikur kjo të ishte me të vërtetë simulim, thotë motra *Melanica*, që kishte ardhur nga Zagrebi enkas për t'u dhënë ndihmë të helmuarve. Vetëm në Kishën e Binçës, sipas deklaratave të motrave të nderit, ndihmë mjekësore dhe shërim kishin gjetur, «...rreth 3.000 veta. Në çdo kohë, ditë dhe natë motrat e nderit: *Jela Angjeliq, Mirijana Gojeviq, Dile Gega, Sofije Kola, Melanica Cvrtak dhe Dobroslava Eriq* ishin gjetur pranë të sëmurëve duke mos kursyer asnjëherë mundin dhe ndihmat për ta.*

Me qëllim që të helmuarve t'u ofrohej ndihma adekuate mjekësore, por jo vetëm këtyre, kapelani i Kishës Katolike në Ferizaj, zotëri dom Lucian Augustini nga Lucerni i Zvicrës, si dhuratë kishte sjellë një sasi barnash dedikuar varfnjakëve dhe të helmuarve. Policia serbe me të dëgjuar për arritjen e këtyre barnave një orë pas arritjes, pa autorizim, bën bastisjen e Kishës Katolike në Ferizaj dhe me atë rast konfiskon 206 barna dhe material tjetër sanitar». Importimi i barnave ishte bërë me lejen e Këshillit Ekzekutiv Federativ dhe ishte plotësisht legal. Pas kësaj bastisjeje fillon fushata e vërtetë kundër këtyre dy kishave. Në mjetet e informimit konstatohet se në këto kisha janë gjetur barna në sasi të mëdha dedikuar «separatistëve shqiptarë».

Kjo ishte arsye e mjaftueshme që ndaj kishave katolike në Ferizaj dhe në Binçë të merren masa drakonike shtetërore me qëllim që e vërteta për helmimet të fshihet dhe të maskohet para opinionit botëror. Në funksion të kësaj, më 9 gusht 1990, në bisedë informative në SPB në Ferizaj merret dr. dom *Lush Gjergji*, ndërsa në masmediumet serbe këto dy kisha fajësoheshin se e kanë bërë helmimin e nxënësve shqiptarë!

Kështu, gazeta «*Jedinstvo*» e Prishtinës, më 7 gusht 1990, pasi e pranon...se «*kishte helmime në Kosovë*», shton se «*fjalën kryesore e kishin pasur persona të caktuar klerikë të kishës katolike*».

Kjo qe arsyeja që ipeshkvi i Ipeshkvisë Shqiptare, imzot *Nikë Prela* t'u drejtohet të gjithë këshillave ekzekutive të republikave dhe të krahinave të ish-Jugosllavisë që këtyre t'u kthehen barnat e konfiskuara padrejtësisht, ndërsa fajtorët të merren në përgjegjësi dhe të dënohen.

Me të njëjtin ton reagon edhe kardinali *Franjo Kuhariq*, i cili veç tjerash, pyet: «*A thua ofrimi i ndihmës njerëzve të sëmurë është krim? A thua të bësh mirë do të thotë të bësh keq? Çfarë është atëherë ai civilizim dhe çfarë është ajo politikë që konfiskon barna e nuk lejon që të helmuarve t'ju jipet ndihmë?*» («*Glas koncila*», nr. 33 të datës 19 gusht 1990, Zagreb). Barnat kishin siguruar Frrok Kristaj dhe Shaban Bërbatovci (shih dokumentin).

Ambulancën e improvizuar në Ferizaj e kishte vizituar edhe Komisioni ndërkombëtar, i cili në raportin e tij pos tjerash shkruan: «*intervistuar tre mjekë në korridorin e kishës katolike, në krye të cilëve ishte dr. Safet Beqiri. Madje, edhe në lokalet e kishës policia kishte tentuar të pengonte trajtimin nga 30 mjekët e pranishëm*», pohonin ata. Atyre, po ashtu, u ishin kërcënuar me dënim. Policia tha se të gjithë pacientët do të duhej të dërgoheshin për shërim në Shkup, (Maqedoni). Sa u përket atyre që ishin dërguar në Prishtinë për shërim, sektori i neuropsikiatrisë, që i kishte shikuar atje, kishte pohuar se janë helmuar (23:18).

Policia serbe me qëllim të pengimit të shërimit të fëmijëve, nuk kishte nguruar t'i largonte barnat dhe t'i zbrazte barnatoret. Këtë fakt e konfirmon edhe Komisioni ndërkombëtar, i cili të njëjtën ditë, kur e vizitoi kishën katolike në Ferizaj, pasdite vizioti edhe barnatoren e shtëpisë së shëndetit «*Jeremie Zherajiq*» në Ferizaj. Për këtë rast deklaroi: «*Pamë se si autoritetet serbe i kishin zbrazur të gjitha barnat dhe nuk kishin furnizuar me mall...*». Në barnatore, anëtarët e misionit arrestohen nga policia dhe këtej e tutje nis një sërë marrjesh në pyetje që zgjati dy ditë deri në largimin tonë nga Kosova.

Në këtë raport më pastaj thuhet: «Gjatë marrjes në pyetje të grupit tonë, autoritetet serbe pyetnin nëse kishim lexuar raportin zyrtar shtetëror mbi incidentin me helmimin. Ata pohonin se ky ishte një mashtrim i popullatës etnike shqiptare. Por pas asaj që kishim parë e dëgjuar, kjo ishte e papranueshme për misionin tonë».

Janë këto dëshmi të cilat në mënyrë të pakontestueshme tregojnë se autoritetet serbe përmes ushtrimit të frikës kishin për qëllim të pengonin që të mos zbulohet e vërteta për helmimet në Kosovë. Mirëpo, kjo sjellje e policisë, jo që arriti të fshehtë të vërtetën, por përkundrazi me veprimet e veta faktorin ndërkombëtar e bindi se kjo vetë ka gisht në këtë akt të krimit, andaj me të drejtë konstatohet se nuk ishte fjala për aktrim filmik të llojit të vet, siç shkruante këto ditë revista «Telegraf» në bisedën që bën *Milosh Antiqi* me mjekët: prof. dr. *Stevo Balosheviqin*, dr. *Rade Katiniqin* dhe dr. *Rade Gërbiqin*, por një helmim gjigant (*shih faksimilin*).

■ RAPORT I KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR HELMIMET NË KOSOVË NË VITIN 1990

Nuk ishte një komedi gjigante, por helmim!

“ZËRI” boton për herë të parë raportin e Komisionit ndërkombëtar të përbërë prej dr. Çarlis Grejvs (Komisioni Ndërkombëtar i Punëtorëve Shëndetësor për të Drejtat Shëndetësore dhe të Njeriut), Zorja Verena Graf (Udhëja Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liri të Popujve) dhe dr. Zhan-Zhak Kirkljarlan (Lëvizja Kundër Racizmit dhe për Miqësinë mes Popujve), të cilët vizituan Kosovën në korrik të vitit 1990. Në raportin e këtij misioni, midis tjerash, konstatohet: Ndodh që helmimi në Kosovë të ketë qenë rezultat i ndonjë gabimi, mirëpo është sigurisht e pamundshme të besohet (si pohonin serbët) se helmimet ishin një komedi gjigante që e luante grupi etnik shqiptar. Nuk është dhënë asnjë kundërgjykitim i natyrës mjekësore që do të dëshmonte se helmimi ishte aktrim apo në çfarëdo mënyre hipotetik.

Dëshmi nga raporti i Komisionit Ndërkombëtar për helmimet në Kosovë

S U M M A R Y

The Study «The Truth about the Poisoning (Intoxication) in Kosova», sets forth the facts about this crime. This study is the result of an empirical research and of a lot of documents and of competent opinion of experts of different fields (medical experts, toxicologists, etc).

Relying on a systematic approach from the aspect of the general theory of systems, we have tried, through the information and arguments, to enlighten as much as it is possible, this genocidal act directed, in the first place, against the Albanian youth of Kosova. Since we wanted an objective reseaxh we started from the general hipothesis defined this way: there was no intoxication of children, school children, students and of other citizens mainly Albanian in Kosova during the period 1989-1990.

In order to verify this hypothesis, it has been a standard scientific methodology in which main topics were the following:

a) To define the cause of the study (the ascertainment of the truth about the intoxication in Kosova during this period).

b) The determination of research goals (the study of the medical documentation, the identification of the number of the victims of intoxication, among which were those who died from the effects of intoxication: the study of the structure of the people who were intoxicated; the age aspect, ethnical and, educational aspect and

professional level in the study of the calendar of intoxication different estimations about the intoxication, the identification and the study of the places included in intoxication, the motives of intoxication as well as the hypothetical reconstruction of the intoxication, etc.

The study and the discovery of the main actors of this phenomena, the reasons that made them do this antihuman and uncivilized act, which is in opposition to the principles of the United Nations, are among the aims of this research.

Methods and procedures that guarantee a high-level scientific objectivity (historical and causal methods, the method of description etc.) have been applied in this research.

In the course of our work we have applied this procedure and these techniques as well: the study of the health documentation, the study of the opinions and estimations of experts, toxicologists, doctors, patients, citizens and the victims' parents; a lot of victims have been interviewed, the secondary documentation has been studied - the decisions for the application of segregation have been analyzed through the study; different juridical and political aspects of the situation that prevailed then in Kosova, as well as the chief publications edited until now concerning the theme «Intoxication in Kosova», have been taken into account. Besides the study of the documentation and numerous reports, the techniques of interviews observations, etc., have been applied likewise.

The gathered material has been elaborated from the statistical aspect, and relying on this procedure and on the analyzed facts and arguments it was found out many times, that general (zero) hypothesis is related as unfounded. Instead of it, it is accepted the alternative hypothesis, wich is defined this way: During the period 1987-1990, the organized intoxication of the children, school -

children, students, workers and of the mainly Albanian citizens' carried out in Kosova. Besides the general hypothesis, other partial sub hypothesis with a lot of proofs, declarations, medical testimonies and authentic documents were either verified or denied.

The arguments and the facts presented in this study are accompanied by photos, tables, diagrams, maps, medical testimonies and interviewes, as well as other evidences.

Relying on the research we ascertained that in Kosova, before the massive intoxication that happened during the March, 19 th 1990, and December, 1996, three experimental tests of intoxication, were carried out in three different cities of Kosova. The first intoxication was made in March, 1987, in the primary school «*Abaz Ajeti*» in Gjilan when 28 children and two teachers were attacked by an unknown gas. Twenty one school-children of this school were admitted in the hospital of Prishtina. Among them were their teachers, too. The authorities of that time like those professionally competent as well as the others, did neither give any incompetent declaration nor any relevant professional opinion about the origin of the disease. The results, blood and urine samples were sent to The Toxicological Institute in Novi Sad. The results of the analyses however, were never published.

- The second experimental test was made in March 1989 as well (after two years, it is possible that they had a reason for making a pause), in the Secondary School «*Luigj Gurakuqi*» in Klina, where many pupils were intoxicated while 33 of them were admitted in the Prishtina hospital again. The clinical review remained undefined again. In the same year, on 16 th of December, 15 schoolchildren and one teacher of the Secondary Medical School «*Boro and Ramizi*», in Prizren, were intoxicated by n

unknocin gas. Just like in the two previous cases, nobody thought that, they were poisoned by chemical gases. Some samples were sent to Hygienic Institution, but analyses and results were not published. In a hard political atmosphere, in a situation of repression over the Albanian population (the lessons in schools were held in the presence of Serbian police in school yards, in school floor, in corridors, in school entrances, etc) on political and educational scene came out the demands of Serbian and Montenegrin school-children and students to separate the lessons according to the shifts and floors. There were other more radical demands such as to exclude the Albanians from school buildings so that the lessons would be held only in Serbian language. This demand was realized in the village of Prilluzha, municipality of Vushtria in 1989 where all the Albanian pupils were excluded from the school. This was the first case of the practical implementation of apartheid in Kosova. There were more demands of separation and discrimination on the national basis in 1989, especially from January, 1990. In order to achieve this demand, the Serbian and Montenegrin pupils and students organized a boycott in January 1990.

- Serbian and Montenegrin protestants signed a petition by which they demanded separation of the lessons on the language basis, and to deliver lectures in separate buildings, floors and shifts. This demand was incomprehensible and astounding to the Albanians because the Serbians had talked and demanded all the time to live in coexistence, unity and toleration and the Albanians were against this kind of separation; but after a big pressure, the Communist League decided and made the authorities of Kosova to admit the separation and to approve segregation. As March was approaching the pressure grew bigger and bigger. To make the final separation, Serbian and Montenegrin students left the stu-

dents' dormitories in Prishtina and went to Fushë-Kosova. The school children of the Medical Secondary School «9 Maj» in Prishtina in March, travelled to Belgrade with the demand that they won't learn the same shift with Albanian pupils. Serbian and Montenegrin pupils and students and their parents as well as the people who attended the populist meetings, argued this separation with the pretext of being endangered by the Albanian students and pupils. This pressure was exaggerated and propagated by Serbian mass-medias and they made false films (which are shown in this study) for the Serbian opinion. They fabricated lies according to which Albanian children raped Serbian and Montenegrin school girls (the analyses done by the Serbians on this topic, shown in this study too, proves that this was not true because Kosova was the area with the smallest number of such cases in Yugoslavia, during the period 1987-1990).

- This pressure as it is argued with facts, served for the application and to justification' of the segregation and the apartheid in the educational field in Kosova, where as the introduction of apartheid was the part of the first phasis of the authorities for the application of intoxication, the «quiet» ethnical cleansing in Kosova, respectively for the expatriation of the Albanians from Kosova (in reference to this, in our study is presented the connection between the prohibition of delivering the lessons in primary schools in Serbian enclaves and the ethnical cleansing, compare the map N.1)

